



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 19

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.9014
datë 20.2.2003

Për ratifikimin e “Traktatit për ndalimin e plotë të
provave bërthamore”.....

Faqe

537

L I G J
Nr.9014, datë 20.2.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “TRAKTATIT PËR NDALIMIN E PLOTË
TË PROVAVE BËRTHAMORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Traktati për ndalimin e plotë të provave bërthamore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3738, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

TRAKTATI
PËR NDALIMIN E PLOTË TË PROVAVE BËRTHAMORE

Hyrje

Shtetet Pale ne kete traktat (ketej e tutje te permendura si "Shtetet Palë"), duke mirepritur marreveshjet nderkombetare dhe masat e tjera pozitive te viteve te fundit ne fushen e carmatimit berthamor, perfshire reduktimin e arsenalit te armeve berthamore, si dhe ne fushen e ndalimit te perhapjes se armeve berthamore ne te gjitha aspektet, duke nenvizuar rendesine e zbatimit te plote dhe te menjehershme te ketyre marreveshjeve dhe masave,

te bindur se situata e tanishme nderkombetare siguron nje mundesi per te marre masa te metejshme efektive lidhur me carmatimin nderkombetar dhe kunder perhapjes se armeve berthamore ne te gjitha aspektet dhe duke deklaruar qellimin e tyre per te ndermarre masa te tilla,

duke theksuar nevojën per te vazhduar perpjekjet sistematike dhe progresive per te reduktuar nga pikepamja globale armet berthamore, me qellimin e vetem per te eliminuar keto arme dhe per te realizuar carmatimin e plote dhe te pergjithshem nen kontrollin rigoroz dhe efektiv nderkombetar,

duke njohur faktin se pushimi i te gjitha shperthimeve prove te armeve berthamore dhe i te gjitha shperthimeve te tjera berthamore, nepermjet kufizimit te zhvillimit dhe permiresimit cilesor te armeve berthamore dhe dhenies fund te zhvillimit te tipeve te reja e te avancuara te armeve berthamore, perben nje mase efektive te carmatimit berthamor dhe te mos-perhapjes se ketyre armeve ne te gjitha aspektet,

per me teper, duke njohur se dhenia fund e ketyre shperthimeve do te perbeje nje hap kuptimplote ne realizimin e nje procesi sistematik per arritjen e carmatimit berthamor,

te bindur se menyra me efektive per t'i dhene fund provave berthamore eshte permes arritjes se nje traktati te plote universal, nderkombetar dhe efektivisht te verifikueshem per ndalimin e provave berthamore, i cili ka qene per nje kohe te gjate nje nga objektivat me prioritare te komunitetit

nderkombetar ne fushen e carmatimit dhe te mos-perhapjes se armeve,

duke vene ne dukje aspiratat e shprehura nga Palet e Traktatit te vitit 1963 per Ndalimin e Provave te Armeveve Berthamore ne Atmosfere, Hapesiren pertej Atmosferes dhe nen Uje per te ndaluar pergjithmone vazhdimin e te gjitha shperthimeve prove te armeve berthamore,

duke vene ne dukje gjithashtu pikepamjet e shprehura se ky Traktat mund te kontribuojë ne mbrojtjen e mjedisit.

Neni 1

Detyrimet themelore

1. Secili nga Shtetet Pale zotohet qe te mos kryejë shperthime prove te armeve berthamore apo ndonje shperthim tjeter berthamor dhe te ndaloje e parandaloje çdo shperthim te tille berthamor ne vendet nen juridiksionin ose kontrollin e tij.

2. Secili nga Shtetet Pale zotohet gjithashtu, qe te mos shkaktojë, nxise ose te mos marre pjese ne asnje rast ne kryerjen e ndonje shperthimi prove te armeve berthamore ose te ndonje shperthimi tjeter te kesaj natyre.

Neni 2

Organizmi

A. Dispozita të Përgjithshme

1. Shtetet Pale themelojne per kete qellim Organizaten e Traktatit per Ndalimin e Plote te Provave Berthamore (permendur ketëj e tutje si "Organizata"), per te siguruar zbatimin e dispozitave te tij, perfshire ato per verifikimin nderkombetar te perbushjes se detyrimeve qe rrjedhin prej tij dhe per te siguruar nje forum per konsultimet dhe bashkepunimin ndermjet Shteteve Pale.

2. Te gjitha Shtetet Pale jane anetare te Organizates. Asnje Shtet Pale nuk do te privohet nga te qenit anetar i Organizates.

3. Selia e Organizates do te jete ne Vjene, Republika e Austrise.

4. Për funksionimin e rregullt të sistemit krijohen si organe te Organizates: Konferenca e Shteteve Pale, Keshilli Ekzekutiv dhe Sekretariati Teknik, i cili do te perfshije Qendren Nderkombetare te te Dhenave.

5. Secili Shtet Pale do te bashkepusoje me Organizaten ne ushtrimin e funksioneve te tij ne kuadrin e ketij Traktati. Shtetet Pale duhet te konsultohen ndermjet tyre drejtperdrejt ose permes Organizates ose procedurave te tjera nderkombetare, perfshire procedurat ne kuadrin e Kombeve te Bashkuara dhe ne perputhje me Karten e saj, ne lidhje me çdo çështje qe ka te beje me objektin dhe qellimin ose zbatimin e dispozitave te ketij Traktati.

6. Organizata duhet te kryejë aktivitetin e saj te verifikimit te parashikuar ne kete Traktat ne nje menyre sa me pak nderhyrese dhe ne perputhje me permbushjen ne kohe e ne menyre efikase te objektivave te tyre. Ajo do te kerkoje vetem informacionet dhe te dhenat e nevojshme per te permbushur pergjegjesite e saj ne baze te ketij Traktati. Ajo duhet te marre çdo mase paraprake per te mbrojtur sekretin e informacionit mbi aktivitetet dhe godinat civile e ushtarake, me te cilin njihet gjate zbatimit te ketij Traktati dhe, ne veçanti, t'i permbahet dispozitave qe lidhen me ruajtjen e sekretit, te parashikuara ne kete Traktat.

7. Secili Shtet Pale duhet te trajtojë si konfidencial dhe do t'i kushtojë kujdes te posaçem informacionit dhe te dhenave qe ai merr me mirëbesim nga Organizata ne lidhje me zbatimin e ketij Traktati. Ajo duhet te trajtojë kete informacion dhe keto te dhenat vetem ne lidhje me te drejtat dhe detyrimet e saj ne baze te ketij Traktati.

8. Organizata, si nje strukture e pavarur, duhet te perpiqet te shfrytëzojë, ateherë kur eshte e nevojshme, ekspertizen dhe lehtesite ekzistuese dhe te maksimizojë efektivitetin e shpenzimeve permes marreveshjeve te bashkepunimit me organizata te tjera nderkombetare si Agjencia Nderkombetare e Energjise Atomike. Keto marreveshje, perjashtuar ato te nje natyre te thjeshte dhe normale tregtare ose kontraktore, duhet te perfshihen ne marreveshjet qe do t'i paraqiten per miratim Konferences se Shteteve Pale.

9. Shpenzimet e aktiviteve te Organizates duhet te mbulohen çdo vit nga ana e Shteteve Pale ne perputhje me shkallen e vleresimit te kontributeve ne buxhetin e Kombeve te Bashkuara te

pershtatura ne pajtim me ndryshimet ne anetaresim ndermjet Kombeve te Bashkuara dhe Organizates.

10. Kontributet financiare te Shteteve Pale ne komisionin pergatitor do te zbriten ne menyren e duhur nga kontributet e tyre ne buxhetin e rregullt.

11. Nje anetar i Organizates, i cili ka pagesa te prapambetura te kontributeve te tij ne buxhetin e Organizates, nuk do te kete te drejten e votes ne Organizate, nese vlera totale e ketyre pagesave eshte e barabarte ose e tejkalon vleren e kontributit te tij per dy vitet e fundit te plota kalendarike. Megjithate, Konferenca e Shteteve Pale, mund te lejoje kete anetar te votoje, nese ajo eshte e bindur se prapambetja ne pagesa eshte per shkaqe qe jane jashte kontrollit te anetarit.

B. Konferenca e Shteteve Pale

Perberja, Procedurat dhe Vendimmarrja

12. Konferenca e Shteteve Pale (ketej e tutje "Konferenca"), do te perbehet nga te gjitha Shtetet Pale. Çdo Shtet Pale do te kete nje perfaqesues ne Konferencen, i cili mund te shoqerohet nga zevendesat dhe keshilltaret.

13. Sesioni i pare i Konferences do te thirret nga depozituesi jo me vone se 30 dite pas hyrjes ne fuqi te ketij Traktati.

14. Konferenca do te mblidhet ne sesione te rregullta, te cilat do te jene te pervitshme, me perjashtim te rasteve kur ajo vendos ndryshe.

15. Nje sesion i posaçem i Konferences do te thirret:

a) kur vendoset nga Konferenca;

b) kur kerkohet nga Keshilli Ekzekutiv;

c) Kur kerkohet nga ndonje Shtet Pale dhe qe mbeshtetet nga shumica e Shteteve Pale.

Sesioni i posaçem do te thirret jo me vone se 30 dite pas vendimit te Konferences, kerkeses se Keshillit Ekzekutiv, ose arrijtes se mbeshtetjes se nevojshme, me perjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe ne vendim ose kerkese.

16. Konferenca mund te mblidhet dhe ne formen e nje Konference Amendamentesh, ne perputhje me nenin 7.

17. Gjithashtu, Konferenca mund te mblidhet ne formen e nje Konference Rishikuese, ne perputhje me nenin 8.

18. Sesionet do te mblidhen ne seline e Organizates, me perjashtim te rasteve kur Konferenca vendos ndryshe.

19. Konferenca do te miratoje rregullat e saj te procedures. Ne fillim te çdo sesioni ajo do te zgjedhe Presidentin e saj dhe te gjithë zyrtaret qe nevojiten. Ata do te mbajne postin deri ne zgjedhjen e Presidentit te ri dhe zyrtareve te tjere ne sesionin e ardhshem.

20. Nje shumice e caktuar e Shteteve Pale do te perbeje kuorumin.

21. Çdo Shtet Pale do te kete te drejten e nje vote.

22. Konferenca do te marre vendimet mbi çështjet procedurale duke pasur shumicen e anetaresve te pranishem dhe shumicen e votave. Vendimet per çështjet thelbesore do te merren sa te jete e mundur me ane te konsensusit. Nese nuk arrihet konsensusi per nje çështje qe paraqitet per vendim, Presidenti i Konferences do te shtyje afatin e votimit me 24 ore dhe gjate kesaj periudhe ai do te beje te gjitha perpjekjet per te bere te mundur arritjen e konsensusit dhe do t'i raportoje Konferencen perpara skadimit te ketij afati per kete qellim.

Ne qofte se konsensusi nuk arrihet edhe me kalimin e afatit prej 24 oresh, Konferenca do te marre vendim me shumicen e dy te tretave te anetaresve te pranishem dhe qe votojne, me perjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe ne kete Traktat. Fakti nese çështja eshte thelbesore ose jo, ajo do te trajtohet si çështje thelbesore me perjashtim te rasteve kur vendoset ndryshe nga shumica e kerkuar per vendimet qe lidhen me çështjet thelbesore.

23. Kur ushtron funksionet e saj ne perputhje me paragrafin 26 (k), Konferenca duhet te marre nje vendim per te shtuar ndonje Shtet ne listen e Shteteve qe perfshihen ne shtojcen 1 te ketij Traktati ne perputhje me proceduren per vendimet mbi çështjet thelbesore te parashikuara ne paragrafin 22. Pavaresisht nga paragrafi 22, Konferenca duhet te marre vendimet mbi çdo ndryshim tjeter ne shtojcen 1 te ketij Traktati me ane te konsensusit.

Pushtetet dhe funksionet

24. Konferenca do te jete organi themelor i Organizates. Ajo do te shqyrtoje çështjet ose

problemet brenda fushes se veprimit te ketij Traktati, perfshire ato qe kane te bejne me pushtetet dhe funksionet e Keshillit Ekzekutiv dhe te Sekretariatit Teknik, ne perputhje me kete Traktat. Konferenca mund te beje rekomandime dhe te marre vendime mbi cheshtjet dhe problemet brenda sferes se ketij Traktati, te cilat ngrihen nga ndonje Shtet Pale ose qe i paraqiten per shqyrtim nga Keshilli Ekzekutiv.

25. Konferenca do te mbikqyre zbatimin e ketij Traktati, rishikojte permbushjen e detyrimeve te tij dhe do te veproje per te mbeshtetur objektin ose qellimin e tij. Gjithashtu, ajo do te mbikqyre veprimtarite e Keshillit Ekzekutiv dhe te Sekretariatit Teknik dhe mund te nxjerre udhezime per secilin nga keto organe lidhur me ushtrimin e funksioneve te tyre.

26. Konferenca do te:

a) Shqyrtoje dhe miratoje raportin e Organizates mbi zbatimin e ketij Traktati, si dhe programin vjetor dhe buxhetin e Organizates te paraqitura nga Keshilli Ekzekutiv, si dhe cdo raport tjeter.

b) Vendose per masen e kontributeve financiare qe duhet te paguhen nga Shtetet Pale ne perputhje me paragrafin 9.

c) Zgjedhe anetaret e Keshillit Ekzekutiv.

d) Emeroje Drejtorin e Pergjithshem te Sekretariatit Teknik (ketu permendur si "Drejtori i Pergjithshem").

e) Shqyrtoje dhe aprovoje rregullat procedurale te Keshillit Ekzekutiv te paraqitura nga ky i fundit.

f) Shqyrtoje dhe rishikojte zhvillimet shkencore dhe teknologjike te cilat mund te ndikojne ne veprimin e ketij Traktati. Ne kete kontekst, Konferenca mund t'i kerkoje Drejtorit te Pergjithshem qe te krijojte nje Keshill Konsultativ Shkencor, per t'i dhene mundesi Atij ose Asaj, qe ne permbushjen e funksioneve te Tij/Saj, t'i jape keshilla te specializuara Konferences, Keshillit Ekzekutiv ose Shteteve Pale, ne fushat e shkences dhe te teknologjise qe lidhen me kete Traktat. Ne kete rast, Keshilli Konsultativ Shkencor do te perbehet nga eksperte te pavarur qe sherbejne me aftesine e tyre personale dhe qe caktohen ne perputhje me kushtet e vendosura nga Konferenca, ne baze te specializimit dhe eksperiences se tyre ne fushat shkencore perkatese qe kane te bejne me zbatimin e ketij Traktati.

g) Marre masat e nevojshme per te siguruar zbatimin ne perputhje me dispozitat e ketij Traktati dhe per te ndrequr e zgjidhur cdo suate qe bie ne kundërshtim me dispozitat e ketij Traktati, ne perputhje me nenin 5;

h) Shqyrtoje dhe miratoje ne sesionin e pare te gjitha projektmarreveshjet, rregulloret, dispozitat, procedurat, manualet operacionale, udhezuesit dhe dokumentet e tjera te perpiluara dhe te rekomanduara nga Komisioni Pergatitor.

i) Shqyrtoje dhe aprovoje marreveshje apo rregulla te vendosura nepermjet bisedimeve ndermjet Sekretariatit Teknik dhe Shteteve Pale, Shteteve te tjera dhe organizatave nderkombetare qe do te lidhen nga Keshilli Ekzekutiv ne emer te Organizates, siç e parashikon paragrafi 38 (h).

j) Krijojte organe ndihmese aq sa te jete e nevojshme, per ushtrimin e funksioneve te saj ne perputhje me kete Traktat.

k) Rinovojte Shtojcen I te ketij Traktati, ne perputhje me paragrafin 23.

C. Keshilli Ekzekutiv

Perberja, procedurat, dhe vendimarrja

Keshilli Ekzekutiv do te perbehet nga 51 anetare. Sipas dispozitave te ketij neni, cdo Shtet Pale do te kete te drejten per te sherbyer ne Keshillin Ekzekutiv.

27. Duke marre parasysh nevojën per nje shperndarje sa me te drejte gjeografike, Keshilli Ekzekutiv do te perfshije:

a) dhjete Shtete Pale nga Afrika;

b) shtate Shtete Pale nga Europa Lindore;

c) nente Shtete Pale nga Amerika Latine dhe Karaibet;

d) shtate Shtete Pale nga Lindja e Mesme dhe Azia Jugore;

e) dhjete Shtete Pale nga Amerika e Veriut dhe Europa Perendimore;

f) tete Shtete Pale nga Azia Jug-Lindore, Paqesori dhe Lindja e Larget.

Te gjitha Shtetet sipas shperndarjes gjeografike te lartpermendur jane te listuara ne shtojcen I te ketij Traktati. Kjo shtojce do te rinovohet, ne menyren e duhur, nga Konferenca ne perputhje me paragrafet 23 dhe 26 (k). Ajo nuk do te jete subjekt amendamentesh ose ndryshimesh ne baze te

procedurave qe perfshihen ne nenin 5.

29. Anetaret e Keshillit Ekzekutiv do te zgjidhen nga Konferenca. Lidhur me kete, çdo rajon gjeografik do te percaktoje Shtetet Pale qe i perkasin atij rajoni per te qene anetare te Keshillit Ekzekutiv si me poshte:

a) Te pakten nje e treta e vendeve te caktuara per secilin rajon gjeografik do te plotesohet, duke marre paraysh interesat politike dhe te sigurimit nga ana e Shteteve Pale te atij rajoni te caktuar ne baze te kapaciteteve berthamore te lidhura me kete Traktat, siç percaktohet nga te dhenat nderkombetare, si dhe ne baze te nje ose te gjithë kriterëve te meposhtëm treguese te renditura sipas prioritetit te vendosura nga çdo rajon:

i.numri i strukturave monitoruese te Sistemit Nderkombetar Monitorues;

ii.specializimi dhe eksperienca ne teknologjine monitoruese;

iii.kontributi ne buxhetin vjetor te Organizates.

b) Nje nga vendet e caktuara per secilin rajon gjeografik do te plotesohet mbi baza rotacioni nga Shteti Pale, i cili eshte i pari sipas rendit alfabetik anglez ndermjet Shteteve te atij rajoni qe nuk kane sherbyer si anetare te Keshillit Ekzekutiv per periudhen me te gjate qe nga koha kur jane anëtarësuar ose qe nga mandati i tyre i fundit, cilado qofte periudha me e shkurter. Nje Shtet Pale i caktuar mbi kete baze mund te refuzoje vendin e tij. Ne kete rast, ky Shtet Pale duhet t'i paraqese nje leter doreheqjeje Drejtorit te Pergjithshem dhe vendi do te plotesohet nga Shteti Pale qe vjen pas tij ne perputhje me kete nenparagraf;

c) Vendet e mbetura qe i perkasin secilit rajon gjeografik do te mbushen nga Shtetet Pale te caktuara ndermjet te gjithë Shteteve Pale te atij rajoni me ane te rotacionit ose zgjedhjeve.

30. Çdo anetar i Keshillit Ekzekutiv do te kete nje perfaqesues ne Keshillin Ekzekutiv, i cili mund te shoqerohet nga zevendes dhe keshilltare.

31. Çdo anetar i Keshillit Ekzekutiv do te mbaje postin qe nga fundi i sesionit te Konferences ne te cilen ai eshte zgjedhur si i tille e deri ne fund sesionit te dyte te rregullt vjetor te Konferences e ne vazhdim, me perjashtim te zgjedhjeve te para te Keshillit Ekzekutiv, ku 26 anetaret do te zgjidhen per te mbajtur postin deri ne fund te sesionit te trete te rregullt vjetor te Konferences, duke pasur parasysh raportet numerike te parashikuara ne paragrafin 28.

32. Keshilli Ekzekutiv do te perpunoje rregullat e tij procedurale te cilat do t'ia paraqese Konferences per aprovim.

33. Keshilli Ekzekutiv do te zgjedhe Kryetarin e tij nga radhet e antareve.

34. Keshilli Ekzekutiv do te mblidhet ne sesione te rregullta. Ndermjet sesioneve ai do te mblidhet aq here sa te kerkohet per permbushjen e kompetencave dhe funksioneve te tij.

35. Çdo anetar i Keshillit Ekzekutiv ka te drejten e nje vote.

36. Keshilli Ekzekutiv do te marre vendime per çeshtjet procedurale me ane te shumices se te gjithë antareve te tij. Keshilli Ekzekutiv do te marre vendime per çeshtjet thelbesore me ane te shumices se dy te tretave te te gjithë anëtareve, me perjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe ne kete Traktat. Kur lindin probleme rreth nje çeshtjeje nese eshte thelbesore ose jo, ajo do te trajtohet si nje çeshtje thelbesore me perjashtim te rasteve kur vendoset ndryshe nga shumica e kerkuar per vendimet qe lidhen me çeshtjet thelbesore.

Kompetencat dhe funksionet

37. Keshilli Ekzekutiv do te jete organi ekzekutiv i Organizates. Ai do te jete pergjegjes per Konferencen dhe do te realizoje kompetencat dhe funksionet qe i jane dhene nga ky Traktat. Ne kete proces, ai do te veproje ne perputhje me rekomandimet, vendimet, dhe udhezimet e Konferences dhe do te siguroje zbatimin ne vijimesi dhe ne menyren e duhur te tyre.

38. Keshilli Ekzekutiv do te:

a) Nxise zbatimin efektiv te ketij Traktati dhe ne pajtim te plote me të.

b) Mbikëqyre aktivitetet e Sekretariatit Teknik.

c) Beje rekomandime per Konferencen, sa here te jete e nevojshme, per shqyrtimin e propozimeve te metejshme per te mbeshtetur objektivat dhe qellimet e ketij Traktati.

d) Bashkepunoje me Autoritetin Kombetar te secilit Shtet Pale.

e) Shqyrtoje dhe t'i paraqese Konferences projektprogramin vjetor dhe buxhetin e Organizates, projektraportin e Organizates lidhur me zbatimin e ketij Traktati, raportin mbi permbushjen e

aktiviteteve te saj dhe raporte te tjera qe ai i gjykon te nevojshme ose qe mund t'i kerkoje Konferenca.

f) Hartoje rregullat e nevojshme per sesionet e Konferences, perfshire pergatitjen e projektprogramit.

g) Shqyrtoje propozimet per ndryshime, per ceshtjet e nje natyre administrative ose teknike, ne Protokoll ose ne shtojcat, ne pajtim me nenin VII dhe t'i beje rekomandime Shteteve Pale lidhur me miratimin e tyre.

h) Lidhe marreveshje me Shtetet Pale, shtetet e tjera dhe organizatat nderkombetare ne emer te Organizates, duke marre paraprakisht pelqimin e Konferences dhe mbikëqyre zbatimin e tyre, me perjashtim te marreveshjeve dhe rregullave te permendura ne nenparagrafin (i).

(i) Aprovoje dhe mbikëqyre veprimin e marreveshjeve ose rregullave qe lidhen me kryerjen e aktiviteteteve te verifikimit me Shtetet Pale dhe shtetet e tjera.

(j) Aprovoje çdo manual operacional dhe çdo ndryshim ne manualet operacionale ekzistues qe mund te propozohet nga Sekretariati Teknik.

39. Keshilli Ekzekutiv mund te kerkoje mbledhjen e nje sesioni te posaçem te Konferences.

40. Keshilli Ekzekutiv do te:

a) Lehtesoje bashkepunimin ndermjet Shteteve Pale, dhe ndermjet Shteteve Pale e Sekretariatit Teknik, lidhur me zbatimin e ketij Traktati permes shkembimeve te informacionit.

b) Lehtesoje keshillimet dhe sqarimet ndermjet Shteteve Pale ne perputhje me nenin 4.

c) Pranoje, shqyrtoje dhe veproje ne lidhje me kerkesat per inspektime dhe raportime ne terren ne perputhje me nenin 4.

41. Keshilli Ekzekutiv do te shqyrtoje çdo shqetesim te ngritur nga nje Shtet Pale rreth mospermbushjes se mundshme te dispozitave te ketij Traktati dhe shperdorimit te te drejtave qe burojne nga ky Traktat. Per kete, Keshilli Ekzekutiv do te konsultohet me Shtetet Pale te perfshire dhe, kur eshte e nevojshme, do t'i kerkoje nje Shtet Pale qe te marre masa per te rregulluar situaten, brenda nje kohe te caktuar. Ne masen qe Keshilli Ekzekutiv e konsideron si te nevojshme kryerjen veprimeve të metejshme, ai do te ndermarre nje ose me teper nga masat e meposhtme:

a) Te njoftoje te gjitha Shtetet Pale per ceshtjen ose problemin;

b) T'ia paraqese ceshtjen ose problemin Konferences;

c) T'i beje rekomandime Konferences ose te ndermarre veprime, kur eshte e nevojshme, qe lidhen me masat per te zgjidhur situaten dhe per te siguruar permbushjen e nenit 5.

D. Sekretariati Teknik

42. Sekretariati Teknik do te ndihmoje Shtetet Pale ne zbatimin e ketij Traktati, si dhe Konferencen dhe Keshillin Ekzekutiv ne permbushjen e funksioneve te tyre. Sekretariati Teknik do te kryeje verifikimin dhe funksionet e tjera qe i besohen atij nga ky Traktat, si dhe funksionet qe i ngarkohen nga Konferenca dhe Keshilli Ekzekutiv ne perputhje me Traktatin. Sekretariati Teknik do te perfshije, si nje pjese integrale, Qendren Nderkombetare te te Dhenave.

43. Ne perputhje me nenin 4 dhe protokollin, funksionet e Sekretariatit Teknik ne lidhje me verifikimin e permbushjes se këtij traktati, do te perfshijne nder te tjera:

a) Mbajtjen e pergjegjesise per mbikëqyrjen dhe koordinimin e operacioneve te Sistemit Nderkombetar Monitorues.

b) Funksionimin e Qendres Nderkombetare te te Dhenave.

c) Pranimin, perpunimin, analizimin dhe raportimin e vazhdueshem te te Dhenave te Sistemit Nderkombetar Monitorues.

d) Pergatitjen e asistences teknike dhe mbeshtetjen per instalimin dhe funksionimin e qendrave te monitorimit.

e) Dhenien e ndihmes per Keshillin Ekzekutiv ne lehtesimin e konsultimeve dhe sqarimeve ndermjet Shteteve Pale.

f) Marrjen e kerkesave per inspektimet ne terren dhe perpunimin e tyre, lehtesimin e shqyrtimit nga ana e Keshillit Ekzekutiv te kerkesave te tilla, kryerjen e pergatitjeve dhe sigurimin e mbeshtetjes teknike gjate inspektimeve ne terren dhe raportimin para Keshillit Ekzekutiv.

g) Negocimin e marreveshjeve ose rregullave me Shtetet Pale, shtetet e tjera dhe organizatat nderkombetare dhe lidhjen, duke ia nenshtruar miratimit nga Keshilli Ekzekutiv, te marreveshjeve dhe rregullave mbi aktivitetet verifikuese me Shtetet Pale ose shtetet e tjera.

h) Dhenien e ndihmes per Shtetet Pale permes Autoriteteve Kombetare te tyre per ceshtjet e

tjera te verifikimit ne kuadrin e ketij Traktati.

44. Sekretariati Teknik do te zhvilloje dhe ruaje, duke ia nenshtruar miratimit te Keshillit Ekzekutiv, manualet operacionale per te rregulluar funksionimin e komponenteve te ndryshem te regjimit te verifikimit, ne perputhje me nenin 4 dhe protokollin. Keto manuale nuk do te jene pjese integrale e ketij Traktati ose e protokollit dhe mund te ndryshohen nga Sekretariati Teknik pas miratimit nga Keshilli Ekzekutiv. Sekretariati Teknik do te informoje menjehere Shtetet Pale per ndonje ndryshim ne manualet operacionale.

45. Funksionet e Sekretariatit Teknik ne lidhje me ceshtjet administrative do te perfshijne:

a) Hartimin dhe paraqitjen para Keshillit Ekzekutiv te projektprogramit dhe buxhetit te Organizates.

b) Hartimin dhe paraqitjen para Keshillit Ekzekutiv te projektraportit te Organizates mbi zbatimin e ketij Traktati dhe te raporteve te tjera qe mund te kerkoje Konferenca dhe Keshilli Ekzekutiv.

c) Sigurimin e mbeshtetjes administrative dhe teknike per Konferencen, Keshillin Ekzekutiv dhe organet e tjera ndihmese.

d) Adresimin dhe marrjen e komunikimeve ne emer te Organizates ne lidhje me zbatimin e ketij Traktati.

e) Kryerjen apo zbatimin e pergjegjesive administrative lidhur me cdo marreveshje ndermjet Organizates dhe organizatave te tjera nderkombetare.

46. Te gjitha kerkesat dhe verejtjet nga ana e Shteteve Pale drejtuar Organizates do te transmetohen nepermjet Autoriteteve Kombetare te tyre per tek Drejtori i Pergjithshem. Kerkesat dhe verejtjet do te behen ne nje nga gjuhet zyrtare te ketij Traktati. Ne pergjigje, Drejtori i Pergjithshem do te perdore te njejten gjuhe me ate te transmetimit te kerkeses apo verejtjes.

47. Per sa i perket pergjegjesive te Sekretariatit Teknik per hartimin dhe paraqitjen para Keshillit Ekzekutiv te projektprogramit dhe buxhetit te Organizates, Sekretariati Teknik do te percaktojte dhe mbaje nje llogari te sakte te te gjitha shpenzimeve per cdo srukture te krijuar si pjese e Sistemit Nderkombetar Monitorues. Nje trajtim i ngjashem do t'i akordohet ne projektprogram dhe buxhet te gjitha aktiviteteve te tjera te Organizates.

48. Sekretariati Teknik do te informoje menjehere Keshillin Ekzekutiv per cdo problem qe ka lindur ne lidhje me plotesimin e funksioneve te tij, me te cilin eshte njohur gjate permbushjes se aktiviteteve te tij dhe qe nuk ka pasur mundesi qe ta zgjidhur nepermjet konsultimeve me Shtetin Pale te interesuar.

49. Sekretariati Teknik do te kete nje Drejtor te Pergjithshem, i cili do te jete kreu i tij dhe zyrtari me i larte administrativ, dhe qe punonjes shkencore teknike dhe personel tjetër sa mund te kerkohet. Drejtori i pare i Pergjithshem do te zgjidhet nga Konferenca mbi baze te rekomandimit te Keshillit Ekzekutiv per nje periudhe prej kater vjetesh, te rinovueshme per nje mandat te dyte, por jo me teper. Drejtori i pare i Pergjithshem do te zgjidhet nga Konferenca ne Sesionin e pare te saj ne baze te rekomandimeve te Komisionit Pergatitor.

50. Drejtori i Pergjithshem do te jete pergjegjes para Konferences dhe Keshillit Ekzekutiv per caktimin e stafit dhe per organizimin e funksionimin e Sekretariatit Teknik. Vleresimi i larte ne punesimin e stafit dhe percaktimi i kushteve te sherbimit do te jete nje domosdoshmeri per sigurimin e standardeve te larta te specializimit profesional, eksperiencës, veprimit efektiv, kompetences dhe integritetit. Vetem shtetasit e Shteteve Pale duhet te sherbejne ne funksionin e Drejtorit te Pergjithshem, si inspektore ose si anetare te stafit profesional ose sekretarial. Nje kujdesi i vecante duhet t'i kushtohet rendesise se rekrutimit te stafit mbi baza sa me te gjera gjeografike qe te jete e mundur. Rekrutimi do te udhëhiqet nga parimi qe stafi do te mbahet ne nje minimum te nevojshem per plotesimin e duhur te pergjegjesive te Sekretariatit Teknik.

51. Pas konsultimeve me Keshillin Ekzekutiv, Drejtori i Pergjithshem mund te krijojte grupe te perkoheshme pune ekspertesh teknike per te pergatitur rekomandimet per ceshtjet specifike.

52. Ne permbushjen e detyrave te tyre, Drejtori i Pergjithshem, inspektoret, asistentet e inspektimit dhe anetaret e stafit nuk do te kerkojne ose marrin instruksione nga asnje Qeveri ose burim tjetër jashte Organizates. Ato nuk do te kryejne veprime qe mund te rezultojne si te papershtatshme per pozicionin e tyre si zyrtare nderkombetare me pergjegjesi vetem perpara Organizates. Drejtori i Pergjithshem do te marre persiper pergjegjesine per aktivitetet e nje skuadre inspektimi.

53. Cdo Shtet Pale duhet te respektojte karakterin ekskluziv nderkombetar te pergjegjesive te

Drejtorit të Pergjithshëm, inspektoreve, asistentëve të inspektoreve dhe të anetareve të stafit, dhe nuk duhet të influencojë në ushtrimin e pergjegjesive të tyre.

E.Privilegjet dhe imunitetet

54. Organizata do të gëzojë në territorin dhe në çdo vend tjetër që është nën juridiksionin ose kontrollin e një Shteti Pale, zotesinë ligjore dhe ato privilegje e imunitete që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj.

55. Delegatet e Shteteve Pale, së bashku me zëvendësit dhe këshilltarët e tyre, përfaqësuesit e anetareve të zgjedhur në Këshillin Ekzekutiv, së bashku me zëvendësit dhe këshilltarët e tyre, Drejtori i Pergjithshëm, inspektorët, asistentët e inspektimit dhe anetarët e stafit të Organizatës, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e nevojshme në ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në lidhje me Organizatën.

56.Zotesia ligjore, privilegjet dhe imunitetet që përmenden në këte nën do të përcaktohen në marrëveshjet ndërmjet Organizatës dhe Shteteve Pale, si dhe në marrëveshjet ndërmjet Organizatës dhe Shtetit, në të cilin Organizata ka selinë. Këto marrëveshje do të shqyrtohen dhe aprovohen në përputhje me paragrafin 26 pikat (h) dhe (i).

57. Pavarësisht nga paragrafet 54 dhe 55, privilegjet dhe imunitetet që gëzojnë Drejtori i Pergjithshëm, inspektorët, asistentët e inspektimit dhe anetarët e stafit të Sekretariatit Teknik, gjatë drejtimit të aktiviteteve të verifikimit, do të jenë ato të parashikuara në Protokoll.

Neni 3

Masat Kombëtare të Zbatimit të Konventës

1. Çdo Shtet Pale, në përputhje me proceset e tij kushtetuese, duhet të marrë masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky Traktat. Në mënyrë të veçantë ai do të marrë cdo masë të nevojshme:

a) Për të ndaluar personat fizikë dhe juridikë që ndodhen në territorin e tij ose në ndonjë vend tjetër që ndodhet nën juridiksionin e tij të njohur nga e drejta ndërkombëtare, që të ndërmarrin ndonjë aktivitet të ndaluar për Shtetet Pale në bazë të këtij Traktati.

b) Të ndalojë personat fizikë dhe juridikë që të kryejnë ndonjë aktivitet të ndaluar në cdo vend që është nën kontrollin e tij.

c) Të ndalojë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, personat fizikë që kanë shtetësinë e tij nga kryerja e ndonjë aktiviteti të tillë.

2. Çdo Shtet Pale duhet të bashkëpunojë me Shtetet e tjera Pale dhe do të ofrojë ndihmën e duhur ligjore për të lehtësuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga paragrafi 1.

3. Çdo Shtet Pale do të informojë Organizatën mbi masat e marra në pajtim me këte nën.

4. Me qëllim që të përmbushë detyrimet e tij që rrjedhin nga ky Traktat, çdo Shtet Pale duhet të caktojë ose krijojë një Autoritet Kombëtar dhe do të informojë për këte Organizatën me hyrjen në fuqi të Traktatit për të. Autoriteti Kombëtar do të shërbejë si pika qendrore kombëtare për ndërmjetësimin midis Organizatës dhe Shteteve të tjera Pale.

Neni 4

Verifikimi

A. Dispozitat e Pergjithshme

1.Me qëllim që të verifikohet përmbushja e këtij Traktati, do të krijohet një regjim verifikimi i cili do të përbehet nga elementet e mëposhtme:

- a) një Sistem Nderkombëtar Monitorues;
- b) konsultimet dhe sqarimet;
- c) inspektimet apo verifikimet në vend;
- d) Masat e krijimit të mirebesimit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Traktati, regjimi i verifikimit do të jetë në gjendje të plotësojë kërkesat e verifikimit të këtij Traktati.

2. Aktivitetet e verifikimit do të bazohen në informacionin objektiv, do të përqendrohen në lenden e këtij Traktati, dhe do të kryhen në bazë të respektimit të plote të sovranitetit të Shteteve Pale

dhe ne menyren sa me pak nderhyrese te mundshme qe eshte ne perputhje me permbushjen me efektivitet dhe ne kohe te objektivave te tyre. Çdo Shtet Pale nuk do te abuzojë me te drejten per verifikim.

3. Ne perputhje me kete Traktat, çdo Shtet Pale angazhohet te bashkepunoje nepermjet Autoritetit te tij Kombetar, te krijuar ne baze te nenit 3, paragrafi 4, me Organizaten dhe me Shtetet e tjera Pale per te lehtesuar verifikimin per permbushjen e ketij Traktati, nder te tjera, me ane:

a) krijimit te strukturave te domosdoshme per te marre pjese ne masat e verifikimit dhe krijimit te komunikimit te nevojshem;

b) sigurimit te te dhenave nga stacionet kombetare qe jane pjese e Sistemit Nderkombetar Monitorues;

c) pjesëmarrjet, ne proceset e konsultimit dhe sqarimit;

d) lejimi i kontrollit te inspektimeve ne terren;

e) pjesëmarrjet ne masat e krijimit te mirebesimit.

4. Te gjitha Shtetet Pale, pavaresisht nga kapacitetet e tyre teknike dhe financiare, do te gezojne te drejta te barabarta lidhur me verifikimin dhe do te kene nje detyrim te barabarte per ta pranuar ate.

5. Lidhur me qellimet e ketij Traktati, asnje Shtet Pale nuk do te pengohet qe te perdore informacionin e perfituar nga mjetet kombetare teknike te verifikimit ne nje menyre qe eshte ne perputhje me parimet pergjithesisht te njohura te se drejtes nderkombetare, duke perfshire ato te respektimit te sovranitetit te shteteve.

6. Pa cenuar te drejten e Shteteve Pale per te mbrojtur instalimet e ndjeshme, veprimtarite ose vendndodhjet qe nuk kane te bejne me kete Traktat, Shtetet Pale nuk duhet te nderhyjne me elemente te regjimit te verifikimit te ketij Traktati ose me mjetet kombetare teknike te verifikimit qe operojne ne perputhje me paragrafin 5.

7. Çdo Shtet Pale do te kete te drejten te marre masa per te mbrojtur instalimet e ndjeshme dhe per te parandaluar zbulimin e informacionit sekret dhe te te dhenave qe nuk kane lidhje me kete Traktat.

8. Gjithashtu, do te merren te gjitha masat e nevojshme per te mbrojtur fshehtesine e cdo informacioni qe lidhet me aktivitetet dhe instalimet civile dhe ushtarake te marre gjate aktiviteteve verifikuese.

9. Mbeshtetur ne paragrafin 8, informacioni i marre nga ana e Organizates permes regjimit te verifikimit te krijuar nga ky Traktat, do t'u vihet ne dispozicion të gjitha Shteteve Pale ne perputhje me dispozitat perkatese te ketij Traktati dhe te protokollit.

10. Dispozitat e ketij Traktati nuk do te interpretohen se kufizojne shkembimet nderkombetare te te dhenave per qellime teknike.

11. Çdo Shtet Pale merr persiper te bashkepunoje me Organizaten dhe me Shtetet e tjera Pale per permiresimin e regjimit te verifikimit dhe ne ekzaminimin e potencialit verifikues te teknologjive shtese monitoruese si p.sh. monitorimi me impulse elektromagnetike ose monitorimi me satelit, me qellim zhvillimin e masave te veçanta per te intensifikuar verifikimet efikase dhe me kosto te favorshme te ketij Traktati. Kur bihet dakord, masa te tilla do te perfshihen ne dispozitat ekzistuese te ketij Traktati, protokollit, ose do te jene si seksione shtese te protokollit, ne perputhje me nenin 7, ose te jene te pasqyruara ne manualet operacionale ne pajtim me nenin 2, paragrafi 44, nese shihet e pershtatshme.

12. Shtetet Pale marrin persiper qe te nxisin bashkepunimin ndermjet tyre per te lehtesuar dhe marre pjese ne shkembimin me te plote te mundshem qe lidhet me teknologjite e perdorura ne verifikimin e ketij Traktati, me qellim qe t'i jepet mundesia te gjitha Shteteve Pale per te forcuar zbatimin ne nivel kombetar te masave te verifikimit dhe per te perfituar nga aplikimi i teknologjive te tilla per qellime paqesore.

13. Dispozitat e ketij Traktati do te zbatohen ne nje menyre te tille qe te mos pengohet zhvillimi ekonomik dhe teknologjik i Shteteve Pale per zhvillimin e metejshem te shfrytezimit te energjise berthamore per qellime paqesore.

Pergjegjesite e verifikimit nga ana e Sekretariatit Teknik

14. Ne permbushjen e pergjegjesive te tij ne drejtim te verifikimit te specifikuar ne kete Traktat dhe protokoll, ne bashkepunim me Shtetet Pale dhe per qellimin e ketij Traktati, Sekretariati Teknik:

a) Do të bëjë rregullimet e duhura për të marrë dhe shpërndarë të dhënat dhe raportimet që lidhen me verifikimin e këtij Traktati në përputhje me dispozitat e tij dhe për të mbajtur një infrastrukturë të përgjithshme komunikimesh të përshtatshme për këto detyra.

b) Në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet Qendres së tij Nderkombëtare të të Dhenave, e cila do të jetë në parim pika qendrore brenda Sekretariatit Teknik për depozitimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre:

i. Do të marrë dhe nisë kërkesat për të dhëna nga Sistemi Nderkombëtar Monitorues.

ii. Do të marrë të dhëna që dalin nga procesi i konsultimit dhe sqarimit, nga inspektimet në terren dhe nga masat e krijimit të mirebesimit.

iii. Do të marrë të dhëna të tjera perkatese nga Shtetet Pale dhe organizatat nderkombëtare në përputhje me këto Traktat dhe Protokoll.

c) Do të mbikëqyrë, koordinojë dhe sigurojë veprimtarinë e Sistemit Nderkombëtar Monitorues dhe të elementeve të tij përberes dhe të Qendres Nderkombëtare të të Dhenave në përputhje me manualët perkatese operacionale.

d) Do të procedojë, analizojë dhe raportojë në mënyrë të vazhdueshme mbi të dhënat e Sistemit Nderkombëtar Monitorues në pajtim me procedurat e rena dakord, për të lejuar verifikimin efektiv nderkombëtar të këtij Traktati dhe për të kontribuar në zgjidhjen sa më të shpejtë të çështjeve që lidhen me përmbushjen e tij.

e) Do të verë në dispozicion të gjitha të dhënat, si ato të papërpunuara dhe ato në proces, dhe rezultatet e përmbledhura përfundimtare për të gjithë Shtetet Pale, që marrin përgjegjësinë për përdorimin e të dhënave të Sistemit Nderkombëtar Monitorues në përputhje me nenin 2, paragrafi 7, dhe me paragrafet 8 dhe 13 të këtij neni.

f) Do t'u njohtë të gjitha Shtetet Pale, në mënyrë të barabartë, të hapur, të përshtatshme dhe në kohë të shpejtë, me të gjitha të dhënat e depozituara.

g) Do të ruajë të gjitha të dhënat, si ato të papërpunuara ashtu edhe ato në proces, si dhe raportet përfundimtare.

h) Do të koordinojë dhe lehtësojë kërkesat për të dhëna shtese nga Sistemi Nderkombëtar Monitorues.

i) Do të koordinojë kërkesat për të dhëna shtese nga një Shtet Pale tek një tjetër Shtet Pale.

j) Do të sigurojë asistencën teknike dhe mbështetjen për instalimin dhe funksionimin e strukturave monitoruese dhe mjeteve perkatese të komunikimit, në rastet kur një asistencë dhe mbështetje e tillë kërkohej nga ana e Shtetit të interesuar.

k) Do të verë në dispozicion të çdo Shteti Pale, mbi bazën e kërkesës së tij, teknikat e përdorura nga Sekretariati Teknik dhe Qendra e tij Nderkombëtare e të Dhenave në mbledhjen, depozitimin, përpunimin, analizimin dhe raportimin mbi të dhënat nga regjimi i verifikimit.

l) Do të monitorojë, vlerësojë dhe raportojë mbi veprimtarinë e përgjithshme të Sistemit Nderkombëtar Monitorues dhe të Qendres Nderkombëtare të të Dhenave.

15. Procedurat e rena dakord, që do të përdoren nga Sekretariati Teknik në përmbushjen e përgjegjësisë të verifikimit që përmenden në paragrafin 14 dhe të detajuara në protokoll, do të jenë të shtjelluara në manualët perkatese operacionale.

B. Sistemi Nderkombëtar Monitorues

16. Sistemi Nderkombëtar Monitorues do të përfshijë strukturat për monitorimin sizmologjik, monitorimin radiobërthamor duke përfshirë labororet e certifikuar, monitorimin hidroakustik, monitorimin me infratinguj dhe mjetet respektive të komunikimit dhe do të mbështetet nga Qendra Nderkombëtare e të Dhenave të Sekretariatit Teknik.

17. Sistemi Nderkombëtar i monitorimit do të vendoset nën autoritetin e Sekretariatit Teknik. Të gjitha komplekset e monitorimit të Sistemit Nderkombëtar Monitorues do të zotërohen dhe vihen në funksionim nga shtetet ku janë vendosur ose që kanë përgjegjësinë për to në përputhje me këto protokoll.

18. Çdo Shtet Pale do të ketë të drejtën për të marrë pjesë në shkëmbimin nderkombëtar të të dhënave dhe për t'u njohur me të dhënat të vena në dispozicion të Qendres Nderkombëtare të të Dhenave. Çdo Shtet Pale do të bashkëpunojë me Qendrën Nderkombëtare të të Dhenave nëpërmjet autoritetit të tij kombëtar.

Financimi i Sistemit Nderkombëtar Monitorues

19. Per strukturat qe bejne pjese ne Sistemin Nderkombetar Monitorues dhe te specifikuar ne tabelat 1-A, 2-A, 3 dhe 4 te shtojces I te protokollit, dhe per funksionimin e tyre, ne masen qe keto sisteme jane pranuar nga Shteti perkates dhe Organizata per te siguruar te dhena per Qendren Nderkombetare te te Dhenave, ne perputhje me kerkesat teknike te protokollit dhe te manualeve perkatese operacionale, Organizata, siç specifikohet ne marreveshjet dhe rregullat ne pajtim me pjesen I, paragrafi 4 te protokollit, do te perballoje shpenzimet e:

a) Krijimit te sistemeve te reja dhe permiresimit te sistemeve ekzistuese me perjashtim te rasteve kur Shteti pergjegjes i perballon vete shpenzimet per keto struktura.

b) Funksionimit dhe mirembajtjes se strukturave te Sistemit Nderkombetar Monitorues, duke perfshire sigurimin fizik te tyre, nese eshte e nevojshme, dhe zbatimin e procedurave te pranuar per autenticitetin e te dhenave.

c) Transmetimit te te dhenave te Sistemit Nderkombetar Monitorues (te paperpunuara dhe ato ne proces), per ne Qendren Nderkombetare te te Dhenave me mjetet me te shpejta e me pak te kushtueshme te mundshme, duke perfshire, nese eshte e nevojshme, transmetimin nepermjet nyjeve te pershtatshme te komunikimit, nga stacionet e monitorimit, labororet, sistemet analitike ose nga qendrat kombetare te te dhenave; ose te dhenave te strukturave laboratorike dhe analitike nga stacionet e monitorimit (perfshire kampionet kur shihet e arsyeshme).

d) Analizimit te provave ne emer te Organizates.

20. Per stacionet e rrjeteve ndihmese sizmike te specifikuar ne tabelen 1-B te shtojces I, Organizata, siç percaktohet ne marreveshjet dhe rregullat ne perputhje me pjesen I, paragrafi 4 te Protokollit, do te perballoje shpenzimet vetem per:

a) Percjelljen e te dhenave per ne Qendren Nderkombetare te te Dhenave.

b) Vertetimin e te dhenave nga keto stacione.

c) Modernizimin e stacioneve ne standardet e kerkuara teknike, me perjashtim te rasteve kur Shteti pergjegjes i perballon vete shpenzimet per keto sistme te reja.

d) Krijimin e stacioneve te reja per qellimet e ketij Traktati aty ku keto struktura nuk kane qene me pare, me perjashtim te rasteve kur Shteti pergjegjes i perballon vete shpenzimet per keto struktura te reja;

e) Çdo shpenzim tjeter qe lidhet me sigurimin e te dhenave nga ana e Organizates ne menyren e percaktuar ne manualet perkatese operacionale.

21. Organizata do te perballoje gjithashtu shpenzimet per t'i siguruar secilit Shtet Pale seleksionimin e kerkuar prej tij, nga niveli standard i raporteve perfundimtare dhe sherbimeve te Qendres Nderkombetare te te Dhenave, siç specifikohet ne pjesen I, seksioni F te protokollit. Shpenzimet e pergatitjes dhe transmetimit te çdo te dhene ose rezultati shtese do te perballohen nga Shteti Pale qe ka bere kerkesen.

22. Marreveshjet dhe rregullat e vendosura me Shtetet Pale ose Shtetet ftuese apo qe marrin pergjegjesine per strukturat e Sistemit Nderkombetar Monitorues, do te permbajne dispozita te vecanta per perballimin e ketyre shpenzimeve. Keto dispozita mund te perfshijne modalitetet me ane te te cilave nje Shtet Pale do te perballoje ndonje prej shpenzimeve qe paraqiten ne paragrafet 19(a) dhe 20(c) e (d), per strukturat e vendosura ne te ose per te cilat eshte pergjegjes dhe qe kompensohet nga nje reduktim i pershtatshem ne kontributet financiare te caktuara per Organizaten. Nje reduktim i tille nuk do te kaloje masen 50% te kontributeve vjetore financiare te percaktuara per nje Shtet Pale, por qe mund te shperndahet ne kontributet e viteve e te mevoneshme. Nje Shtet Pale mund te ndaje nje reduktim te tille me nje Shtet tjeter Pale ne marreveshje me te dhe me pelqimin e Keshillit Ekzekutiv. Marreveshjet ose rregullat e permendura ne kete paragraf do te aprovohen ne perputhje me nenin 2, paragrafi 26(h) dhe 38(i).

Ndryshimet ne Sistemin Nderkombetar Monitorues

23. Kur bihet dakord, çdonje nga masat e permendura ne paragrafin 11, qe prek Sistemin Nderkombetar Monitorues me ane te shtimit ose heqjes se nje teknologjie monitoruese do te jete pjese perberese e ketij Traktati dhe protokollit ne pajtim me nenin 7, paragrafet 1 deri 6.

24. Duke marre pelqimin e shteteve qe preken direkt, ndryshimet e meposhtme ne Sistemin Nderkombetar Monitorues do te konsiderohen si çeshtje te nje natyre administrative ose teknike ne pajtim me nenin 7, paragrafet 7 dhe 8:

a) Ndryshimet ne numrin e strukturave te specifikuar ne protokoll per nje teknologji te dhene monitorimi;

b) Ndryshimet ne detajet e tjera per struktura te veçanta ne menyren e pasqyruar ne tabelat e shtojces I te protokollit (duke perfshire, nder te tjera, Shtetin pergjegjes per strukturen, vendndodhjen, emrin dhe tipin e strukture dhe ngarkimin e nje strukture ndermjet rrjeteve primare dhe sekondare sizmike).

Nese Keshilli Ekzekutiv rekomandon, ne pajtim me nenin 7, paragrafi 8(d), qe te miratohen ndryshime te tilla, si rregull ai do te rekomandoje, ne pajtim me nenin 7, paragrafi 8(g), qe keto ndryshime te hyjne ne fuqi mbi bazen e njoftimit nga ana e Drejtorit te Pergjithshem per aprovimin e tyre.

25. Drejtori i Pergjithshem, kur paraqet perpara Keshillit Ekzekutiv dhe Shteteve Pale informacionin dhe vleresimin ne perputhje me nenin 7, paragrafi 8(b), ai do te perfshije ne rastin e cdo propozimi te bere ne pajtim me paragrafin 24:

- a) nje vleresim teknik te propozimit;
- b) nje deklarate mbi ndikimin administrativ dhe financiar te propozimit;
- c) nje raport mbi konsultimet me shtetet qe preken direkt nga propozimi duke perfshire paraqitjen e marreveshjes se tyre.

Marreveshjet e perkohshme

26. Ne rastet e nje demtimi te rendesishem e te pandreqshem te nje strukture monitorimi te specifikuar ne tabelat e shtojces I te protokollit, ose me qellimin qe te mbulohen reduktime te tjera te perkoheshme te mbulimit me monitorim, Drejtori i Pergjithshem, ne konsultim dhe marreveshje me Shtetet qe preken direkt dhe me aprovimin e Keshillit Ekzekutiv, do te beje rregullime te perkohshme me nje kohezgjatje jo me shume se njevjecare, te rinovueshme edhe per nje vit tjeter nese eshte e nevojshme. Me pelqimin e Keshillit Ekzekutiv dhe te Shteteve te prekura direkt keto rregullime nuk do te bejne qe numri i sistemeve operacionale te Sistemit Nderkombetar Monitorues te tejkalojne numrin e specifikuar per rrjetin perkates; ato do te perballojne sa me shume te jete e mundur kerkesat teknike dhe operacionale te specifikuar ne manualet operacionale per rrjetin perkates; dhe do kryhen brenda buxhetit te Organizates. Drejtori i Pergjithshem do te ndermarre hapat e metejshme per te ndrequr situaten dhe do te beje propozimet per zgjidhjen e saj te perhershme. Drejtori i Pergjithshem do te vere ne dijeni te gjitha Shtetet Pale per cdo vendim te marre ne pajtim me kete paragraf.

Strukturat kombetare te bashkepunimit

27. Shtetet Pale mund te krijojne ne menyre te vecuar marredhenie bashkepunimi me Organizaten, me qellim qe t'i vene ne dispozicion Qendres Nderkombetare te te Dhenave, te dhena shtese nga stacionet kombetare te monitorimit te cilat nuk jane formalisht pjese e Sistemit Nderkombetar Monitorues.

28. Marredhenie te tilla bashkepunimi mund te krijohen si me poshte:

a) Mbi bazen e kerkeses se bere nga ndonje Shtet Pale dhe per llogari te atij Shteti, Sekretariati Teknik do te ndermarre hapat e nevojshem per te vertetuar nese nje strukture monitorimi e caktuar permblush kerkesat teknike dhe operacionale te specifikuar ne manualet perkatese operacionale te nje strukture te Sistemit Nderkombetar Monitorues, dhe ben rregullimet e nevojshme per vertetimin e te dhenave te saj. Duke marre pelqimin e Keshillit Ekzekutiv, Sekretariati Teknik ne kete menyre do te caktojte nje strukture te tilla si strukturen kombetare te bashkepunimit. Sekretariati Teknik do te ndermarre hapat e duhura per te rivleresuar vertetimin e tij kur eshte e nevojshme.

b) Sekretariati Teknik do te mbaje nje liste te rinovuar te strukturave kombetare te bashkepunimit dhe do t'ua shperndaje ate te gjitha Shteteve Pale.

c) Qendra Nderkombetare e te Dhenave do t'i kerkoje te dhena strukturave kombetare te bashkepunimit, nese kjo kerkohet nga nje Shtet Pale me qellim per te lehtesuar konsultimet, sqarimet si dhe vleresimin e kerkesave per inspektime ne terren, ku shpenzimet e transmetimit te te dhenave do te mbulohen nga ai Shtet Pale.

Kushtet ne baze te te cilave vihen ne dispozicion te dhenat shtese nga keto struktura, dhe ne baze te te cilave Qendra Nderkombetare e te Dhenave mund te kerkoje raportime ose sqarime te metejshme ose te shpejta, do te jene te shtjelluara ne manualet operacionale per rrjetet perkatese monitoruese.

C. Konsultimet dhe sqarimet

29. Pa cenuar te drejten e ndonje Shteti Pale per te kerkuar inspektime ne terren, Shtetet Pale, kurdohere qe eshte e mundur, duhet te bejne se pari te gjitha perpjekjet per te qartesuar dhe zgjidhur

midis tyre ose nepermjet Organizates, çdo çeshtje qe mund te shkaktoje probleme rreth mospermbushjes se mundshme te detyrimeve baze te ketij Traktati.

30. Nje Shtet Pale, i cili merr nje kerkese ne pajtim me paragrafin 29 direkt nga nje Shtet tjetër Pale, duhet te pergatise sa me shpejt te jete e mundur sqarimin per Shtetin Pale kerkues, por ne çdo rast, jo me vone se 48 ore pas berjes se kerkeses. Shtetet Pale kerkuese dhe te kerkuara mund te informojne Keshillin Ekzekutiv dhe Drejtorin e Pergjithshem rreth kerkeses dhe pergjigjes.

31. Nje Shtet Pale do te kete te drejten qe t'i kerkoje Drejtorit te Pergjithshem qe te asistojë ne sqarimin e ndonje çeshtjeje, e cila mund te sjelle probleme lidhur me mospermbushjen e mundshme te detyrimeve baze te ketij Traktati. Drejtori i Pergjithshem do te jape informacionin e duhur qe posedon Sekretariati Teknik dhe qe ka te beje me kete çeshtje. Drejtori i Pergjithshem do te informoje Keshillin Ekzekutiv mbi kerkesen dhe per informacionin e vene ne dispozicion ne pergjigje te kesaj, nese kjo gje kerkohet nga Shteti Pale qe ka bere kerkesen.

32. Nje Shtet Pale do te kete te drejten qe t'i kerkoje Keshillit Ekzekutiv qe te marre sqarime nga nje Shtet tjetër Pale per çdo çeshtje qe mund te perbeje problem lidhur me mospermbushjen e mundshme te detyrimeve baze te ketij Traktati. Ne nje rast te tille do te zbatohen pikat e meposhtme:

a) Keshilli Ekzekutiv do te paraqese kerkesen per sqarimin ne Shtetin Pale te kerkuar nepermjet Drejtorit te Pergjithshem jo me vone se 24 ore pas marrjes se kerkeses nga ana e tij;

b) Shteti Pale i kerkuar duhet te pergatise sqarimet per Keshillin Ekzekutiv sa me shpejt te jete e mundur, por jo me vone se 48 ore pas marrjes se kerkeses.

c) Keshilli Ekzekutiv do te mbaje shenim lidhur me sqarimin dhe do t'ia paraqese ate Shtetit Pale kerkues jo me vone se 24 ore pas marrjes se tij.

d) Nese Shteti Pale kerkues gjykon se sqarimi eshte i pamjaftueshem, ai ka te drejten t'i kerkoje Keshillit Ekzekutiv qe te marre sqarime te metejshme nga Shteti Pale qe merr kerkesen.

Keshilli Ekzekutiv do te informoje pa vonese te gjitha shtetet e tjera rreth çdo kerkese per sqarim ne pajtim me kete paragraf, si dhe per çdo pergjigje te pergatitur nga ana e Shtetit Pale te kerkuar.

33. Nese Shteti Pale kerkues vlereson se sqarimet e marra ne paragrafin 32(d) jane te pakenaqshme, ai do te kete te drejten te kerkoje nje mbledhje te Keshillit Ekzekutiv ne te cilen Shteteve Pale te perfshira, qe nuk jane anetare te Keshillit Ekzekutiv, do t'u jepet e drejta per te marre pjese. Ne kete mbledhje, Keshilli Ekzekutiv do te shqyrtoje problemin ne fjale dhe mund te rekomandoje masa ne perputhje me nenin 5.

B. Inspektimet në Terren

Kerkesa per inspektime ne terren

34. Çdo Shtet Pale do te kete te drejten te kerkoje inspektime ne terren ne perputhje me dispozitat e ketij neni dhe te pjeses II te protokollit, ne territorin ose ne ndonje vend tjetër qe ndodhet nen juridiksionin ose kontrollin e ndonje Shteti Pale, ose ne çdo zone qe ndodhet jashte juridiksionit ose kontrollit te ndonje shteti.

35. Qellimi i vetem i inspektimeve ne terren do te jete per te sqaruar nese nje shperthim prove i armes berthamore ose ndonje shperthim tjetër berthamor eshte kryer ne nenit 1 dhe, ne masen me te madhe te mundshme, per te mbledhur fakte qe mund te ndihmojne ne identifikimin e ndonje shkelesi te mundshem.

36. Shteti Pale qe ben kerkesen do te jete i detyruar qe ta mbaje kerkesen per inspektim ne terren brenda kuadrit te ketij Traktati dhe per te parashikuar ne kerkese informacionin ne perputhje me paragrafin 37. Shteti Pale kerkues nuk do te beje kerkesa per inspektime te pabazuara dhe abuzive.

37. Kerkesa per inspektim ne terren do te bazohet ne informacionin e mbledhur nga Sistemi Nderkombetar Monitorues, ose ne çdo informacion teknik perkates te marre nga mjetet kombetare teknike te verifikimit ne nje menyre qe eshte ne perputhje me parimet pergjithesisht te njohura te se drejtes nderkombetare ose nje kombinim te tyre.

38. Shteti Pale kerkues duhe te paraqese kerkesen per inspektime ne terren para Keshillit Ekzekutiv dhe njekohesisht para Drejtorit te Pergjithshem per te filluar menjehere procesin lidhur me kete kerkese

Hapat pas paraqitjes se kerkeses per inspektime ne terren.

39. Keshilli Ekzekutiv do te filloje shqyrtimin e tij menjehere pas marrjes se kerkeses per inspektimin ne terren.

40. Drejtori i Pergjithshem, pas marrjes se kerkeses per inspektim ne terren, do te njoftoje per marrjen e saj Shtetin Pale kerkues brenda dy oreve dhe do t'ia komunikoj kerkesen Shtetit Pale qe kerkohet te inspektohet brenda gjashte oreve. Drejtori i Pergjithshem duhet te sigurohet nese kerkesa i permbush kushtet e specifikuara ne pjesen II, paragrafi 41 te protokollit dhe, nese eshte e nevojshme, duhet te ndihmoje Shtetin Pale kerkues ne hartimin ne menyre te pershtatshme te kerkeses. Ai do t'ia komunikoj kerkesen Keshillit Ekzekutiv dhe te gjitha Shteteve te tjera Pale brenda 24 oreve.

41. Kur kerkesa per inspektim permbush kushtet e specifikuara me lart, Sekretariati Teknik do te filloje pa vonese pergatitjet per inspektim ne terren.

42. Drejtori i Pergjithshem, me te marre nje kerkese per inspektim ne terren qe i referohet nje zone inspektimi qe eshte nen juridiksionin ose kontrollin e nje Shteti Pale, do te kerkoje menjehere sqarime nga Shteti Pale qe kerkohet te inspektohet me qellimin per te sqaruar dhe zgjidhur problemin e ngritur ne kerkese.

43. Nje Shtet Pale qe merr nje kerkese per sqarim ne pajtim me paragrafin 42, duhet t'i jape Drejtorit te Pergjithshem spjegimet dhe informacionin tjetër te vlefshem qe ka lidhje me kerkesen, sa me shpejt te jete e mundur, por jo me vone se 72 ore pas marrjes se kerkeses per sqarim.

44. Drejtori i Pergjithshem, perpara se Keshilli Ekzekutiv te marre nje vendim mbi kerkesen per inspektim ne terren, do t'i transmetoj menjehere Keshillit Ekzekutiv çdo informacion shtese te vlefshem nga Sistemi Nderkombetar Monitorues ose te siguar nga ndonje Shtet Pale per rastin e specifikuar ne kerkese, duke perfshire çdo sqarim te parashikuar në paragrafet 42 dhe 43, si edhe çdo informacion tjetër nga Sekretariati Teknik qe Drejtori i Pergjithshem e gjykon se eshte i pershtatshem ose qe kerkohet nga Keshilli Ekzekutiv.

45. Me perjashtim te rasteve kur Shteti Pale kerkues e vlereson problemin qe ngrihet ne kerkesen per inspektim ne terren se do te zgjidhet dhe e terheq kerkesen, Keshilli Ekzekutiv do te marre nje vendim per ate kerkese ne perputhje me paragrafin 46.

Vendimet e Keshillit Ekzekutiv

46. Keshilli Ekzekutiv do te marre vendimin mbi kerkesen per inspektim ne terren jo me vone se 96 ore pas marrjes se kerkeses nga ana e Shtetit Pale kerkues. Vendimi per te aprovuar inspektimin ne terren do te arrihet me te pakten 30 vota pro te anetareve te Keshillit Ekzekutiv. Ne qofte se Keshilli Ekzekutiv nuk e aprovon inspektimin, pergatitjet do te nderpriten dhe nuk do te ndermerret asnje veprim i metejshem lidhur me kerkesen.

47. Jo me vone se 25 dite pas aprovimit te inspektimit ne terren ne perputhje me paragrafin 46, skuadra e inspektimit do t'i transmetoj Keshillit Ekzekutiv, nepermjet Drejtorit te Pergjithshem, nje progres-raport te inspektimit. Vazhdimi i inspektimit do te konsiderohet si i aprovuar me perjashtim te rastit kur Keshilli Ekzekutiv, jo me vone se 72 ore pas marrjes se progresraportit te inspektimit, vendos me ane te shumices se anetareve te tij per te mos vazhduar inspektimin. Nese Keshilli Ekzekutiv vendos per te mos vazhduar inspektimin, ai do te nderpritet perfundimisht dhe skuadra e inspektimit do te largohet nga zona qe inspektohet dhe territori i Shtetit Pale qe inspektohet, sa me shpejt te jete e mundur, ne perputhje me pjesen II, paragrafet 109 dhe 110 te protokollit.

48. Gjate inspektimit ne terren, skuadra e inspektimit mund t'i paraqese Keshillit Ekzekutiv, nepermjet Drejtorit te Pergjithshem, nje propozim per te kryer shpime per marrjen e kampioneve. Keshilli Ekzekutiv do te marre vendimin per kete propozim jo me vone se 72 ore pas marrjes se tij. Vendimi per te aprovuar kryerjen e shpimeve do te merret me ane te shumices se te gjitha anetareve te Keshillit Ekzekutiv.

49. Skuadra e inspektimit mund t'i kerkoje Keshillit Ekzekutiv, nepermjet Drejtorit te Pergjithshem, qe te zgjase inspektimin per nje periudhe maksimale prej 70 ditesh mbi harkun kohor te 60 diteve te percaktuar ne pjesen II, paragrafin 4, te protokollit, ne qofte se skuadra e inspektimit vlereson se zgjatja e afatit eshte e domosdoshme per te bere qe skuadra e inspektimit te permbush mandatin e saj. Skuadra e inspektimit do te tregoj ne kerkesen e saj se cilin nga aktivitetet dhe teknikat e listuara ne pjesen II, paragrafi 69 te protokollit ka per qellim qe te kryeje gjate zgjatjes se afatit. Keshilli Ekzekutiv do te marre nje vendim lidhur me kerkesen per zgjatjen e afatit kohor jo me vone se 72 ore pas marrjes se kerkeses. Vendimi per te aprovuar nje zgjatje te tille te inspektimit do te merret me shumicen e te gjitha anetareve te Keshillit Ekzekutiv.

50. Ne çdo kohe pas aprovimit te vazhdimi te inspektimit ne terren ne perputhje me paragrafin 47, skuadra e inspektimit mund t'i paraqese Keshillit Ekzekutiv, nepermjet Drejtorit te Pergjithshem, rekomandimin per te perfunduar inspektimin. Ky rekomandim do te konsiderohet i

aprovuar me perjashtim te rasteve kur Keshilli Ekzekutiv, jo me vone se 72 ore pas marrjes se rekomandimit, vendos me shumice prej 2/3 te te gjitha anetareve te tij per te mos aprovuar perfundimin e inspektimit. Ne rastin e perfundimit te inspektimit, skuadra e inspektimit duhet te largohet nga zona qe inspektohet dhe territori i Shtetit Pale qe inspektohet, sa me shpejt qe te jete e mundur ne perputhje me pjesen II, paragrafet 109 dhe 110 te protokollit.

51. Shteti Pale kerkues dhe Shteti Pale qe kerkohet te inspektohet mund te marrin pjese pa te drejte vote gjate marrjes se vendimeve te Keshillit Ekzekutiv mbi kerkesen per inspektim ne terren. Shteti Pale kerkues dhe Shteti Pale qe inspektohet mund te marrin pjese pa votuar ne ndonje shqyrtim te mevonshem nga Keshilli Ekzekutiv lidhur me inspektimin.

52. Drejtori i Pergjithshem do te njoftoje te gjitha Shtetet Pale brenda 24 oreve rreth çdo vendimi per inspekte ne terren dhe per raportet propozimet, kerkesat dhe rekomandimet qe i paraqiten Keshillit Ekzekutiv ne pajtim me paragrafet 46 deri 50.

Ecuria pas Aprovimit te Keshillit Ekzekutiv per nje Inspektim ne Terren

53. Nje inspektim ne terren i aprovuar nga Keshilli Ekzekutiv duhet te kryhet pa vonese nga nje skuader inspektimi e caktuar nga Drejtori i Pergjithshem dhe ne perputhje me dispozitat e ketij Traktati dhe protokollit. Skuadra e inspektimit duhet te arrije ne piken e hyrjes jo me vone se gjashte dite pas marrjes nga ana e Keshillit Ekzekutiv te kerkeses per inspektim ne terren nga ana e Shtetit Pale kerkues.

54. Drejtori i Pergjithshem do te leshoje nje mandat inspektimi per kryerjen e inspektimit ne terren. Mandati i inspektimit do te permbaje informacionin e specifikuar ne pjesen II, paragrafi 42 te protokollit.

55. Drejtori i Pergjithshem do te njoftoje Shtetin Pale qe inspektohet rreth inspektimit jo me vone se 24 ore perpara mberritjes se planifikuar te skuadres se inspektimit ne piken e hyrjes, ne perputhje me Pjesen II, paragrafi 43 te Protokollit.

Kryerja e Inspektimit ne Terren

56. Çdo Shtet Pale do te lejoje Organizaten qe te kryeje nje inspektim ne terren ne territorin e tij ose ne zonat qe jane nen juridiksionin ose kontrollin e tij ne perputhje me dispozitat e ketij Traktati dhe te protokollit. Megjithate, asnje Shtet Pale nuk duhet te pranoje inspekte te dubluara ne territorin e tij ose ne zonat qe jane nen juridiksionin ose kontrollin e tij.

57. Ne perputhje me dispozitat e ketij Traktati dhe te protokollit, Shteti Pale qe inspektohet do te kete:

a) Te drejten dhe detyrimin per te bere çdo perpjekje te arsyeshme per te treguar permbushjen prej tij te ketij Traktati dhe, per pasoje, t'i mundesoje skuadres se inspektimit permbushjen e mandatit te saj.

b) Te drejten per te marre masat qe ai i gjykon te domosdoshme per te mbrojtur interesat e sigurise kombetare dhe per te parandaluar zbulimin e informacionit sekret qe nuk ka te beje me qellimin e inspektimit.

c) Detyrimin per te siguruar hyrjen brenda ne zonen qe inspektohet per qellimin e vetem te percaktimit te fakteve qe kane lidhje me synimin e inspektimit, duke marre parasysh nenparagrafin (b) dhe detyrimet kushtetuese qe ai mund te kete ne lidhje me te drejtat e pronesise, kontrollet dhe konfiskimet.

d) Detyrimin per te mos shfrytezuar kete paragraf ose pjesen II, paragrafi 88 i protokollit, per te fshehur ndonje shkelje te detyrimeve te tij qe rrjedhin nga neni.

e) Detyrimin per te mos penguar kompetencat e nje skuadre inspektimi per te levizur brenda zones qe inspektohet dhe per te kryer veprimtari inspektimi ne perputhje me kete Traktat dhe protokollin.

Hyrje, ne kuptimin e inspektimit ne terren, nenkupton si pranine fizike te skuadres se inspektimit dhe te pajisjeve perkatese ne terren, ashtu edhe kryerjen e veprimtarive te inspektimit brenda zones qe inspektohet.

58. Inspektimet ne terren do te kontrollohen ne menyren sa me pak nderhyrese te mundshme, ne perputhje me permbushjen me efektivitet dhe ne kohe te mandatit te inspektimit dhe ne perputhje me procedurat e bera te njohura ne protokoll. Sa here te jete e mundur, skuadra e inspektimit duhet te filloje procedurat me pak nderhyrese dhe pastaj duhet te vazhdoje te veproje me procedura me

nderhyrese vetem nese e gjykon te nevojshme per te mbledhur informacion te mjaftueshem per te sqaruar çeshtjen rreth mospermbushjes se mundshme te ketij Traktati. Inspektuesit duhet te kerkojne vetem informacionin dhe te dhena te nevojshme per qellimet e inspektimit dhe duhet te kerkojne te minimizojë nderhyrjen ne operacionet e zakonshme te Shtetit Pale qe inspektohet.

59. Shteti Pale qe inspektohet do te ndihmoje skuadren e inspektimit gjate gjithë inspektimit ne terren dhe do te lehtësoje detyrat e tij.

60. Nese Shteti Pale qe inspektohet, duke vepruar ne perputhje me pjesen II, paragrafet 86 deri 96 te protokollit, kufizon hyrjen brenda ne zonen qe inspektohet, ai duhet te beje çdo perpjekje te arsyeshme ne konsultim me skuadren e inspektimit, per te demonstruar nepermjet mjeteve alternative permbushjen prej tij te ketij Traktati

Vezhguesi

61. Ne lidhje me nje vezhgues, do te zbatohen pikat e meposhtme:

a) Shteti Pale kerkues, me miratimin e Shtetit Pale qe inspektohet, mund te dergoje nje perfaqesues, i cili mund te jete perfaqesues kombetar i Shtetit Pale kerkues ose i nje Shteti te trete Pale, per te vezhguar kryerjen ose drejtimin e inspektimeve ne terren.

b) Shteti Pale qe inspektohet duhet te njoftoje per pranimin ose mospranimin e vezhguesit te propozuar, Drejtorin e Pergjithshem brenda 12 oreve pas aprovimit te inspektimeve ne terren nga ana e Keshillit Ekzekutiv.

c) Ne rast te pranimit, Shteti Pale qe inspektohet duhet t'i garantoje hyrjen vezhguesit ne perputhje me protokollin;

d) Si rregull, Shteti Pale qe inspektohet duhet te pranoje vezhguesin e propozuar, por ne qofte se ky shtet refuzon, ky fakt do te shenohet ne raportin e inspektimit.

Nuk do te kete me shume se tre vezhgues nga nje teresi Shtetesh Pale qe bejne kerkese.

Raportet mbi inspektimet ne terren

62. Raportet e inspektimit duhet te permbajne:

a) nje pershkrim te aktiviteteve te zhvilluara nga skuadra e inspektimit;

b) perfundimet faktike te grupit te inspektimit ne lidhje me qellimin e inspektimit;

c) nje vleresim te bashkepunimit te ofruar gjate inspektimit ne terren;

d) nje pershkrim faktik i mases se hyrjes, duke perfshire mjetet e kombinuara te siguruara per skuadren e inspektimit gjate inspektimit ne terren;

e) çdo detaj tjeter qe ka te beje me qellimin e inspektimit.

Vezhgemet e ndryshme te bera nga inspektuesit mund t'i bashkengjiten raportit.

63. Drejtori i Pergjithshem mund te perpiroje projektraporte inspektimi ne dispozicion te Shtetit Pale qe inspektohet. Ky i fundit do te kete te drejten t'i paraqese Drejtorit te Pergjithshem, brenda 48 oreve, komentet dhe shpjegimet e tij dhe te identifikojë çdo informacion dhe te dhena te cilat, ne pikepamjen e tij, nuk kane lidhje me qellimin e inspektimit dhe nuk duhet te qarkullonin jashte Sekretariatit Teknik. Drejtori i Pergjithshem do te shqyrtojë propozimet per ndryshime te projektraportit te inspektimit te bera nga Shteti Pale qe inspektohet dhe do t'i bashkoje ato ne nje te vetme. Gjithashtu, Drejtori i Pergjithshem do te bashkengjise komentet dhe shpjegimet e përgatitura nga Shteti Pale qe inspektohet ne raportin e inspektimit.

64. Drejtori i Pergjithshem do t'i transmetojë menjehere raportin e inspektimit Shtetit Pale kerkues, Keshillit Ekzekutiv dhe te gjitha Shteteve Pale. Drejtori i Pergjithshem gjithashtu do t'i transmetojë menjehere Keshillit Ekzekutiv dhe te gjitha Shteteve Pale rezultatet e analizave te provave te marra ne labororet e ngritura per kete qellim ne pajtim me pjesen II, paragrafi 104 te protokollit, te dhenat perkatese nga Sistemi Nderkombetar Monitorues, vleresimet e Shteteve Pale kerkuese dhe qe inspektohen, si dhe cdo informacion tjeter qe Drejtori i Pergjithshem e gjykon te pershtatshem. Ne rastin e nje progresraporti mbi inspektimet e permendur, ne paragrafin 47, Drejtori i Pergjithshem do t'ia percjelle raportin Keshillit Ekzekutiv brenda afatit kohor te percaktuar ne ate paragraf.

65. Keshilli Ekzekutiv ne perputhje me kompetencat dhe funksionet e tij, do te rishikojë raportin e inspektimit, si dhe çdo material te parashikuar ne pajtim me paragrafin 47, dhe do te paraqese çdo interesim nese p.sh:

a) ka ndodhur ndonje mospermbushje e ketij Traktati;

b) është abuzuar me te drejten per te kerkuar inspektim ne terren.

66. Ne qofte se Keshilli Ekzekutiv, gjate ushtrimit te kompetencave dhe funksioneve, arrin ne

konkluzionin se veprimi i metejshe mund të jete i domosdoshem në lidhje me paragrafin 65, ai do të marrë masat e duhura në përputhje me nenin 5.

Kerkesat e panevojshme ose abuzive për Inspektim në terren

67. Nëse Këshilli Ekzekutiv nuk aprovon inspektimin në terren për shkak se kërkesa përkatëse është e panevojshme ose abuzive, ose nëse inspektimi ndërpritet për të njëjtat arsye, Këshilli Ekzekutiv do të shqyrtojë dhe vendosë për përdorimin e masave të përshtatshme për të ndrequr situatën, duke përfshirë sa më poshtë:

a) Duke i kërkuar Shtetit Pale që ben kërkesë për të përballuar shpenzimet lidhur me përparatjet e bërë nga ana e Sekretariatit Teknik.

b) Duke pezulluar të drejtën e Shtetit Pale kerkues për të kërkuar inspektim në terren për një periudhë të caktuar kohë, siç përcaktohet nga Këshilli Ekzekutiv.

c) Duke pezulluar të drejtën e Shtetit Pale kerkues për të shërbyer në Këshillin Ekzekutiv për një periudhë kohë.

Masat për krijimin e besueshmërisë

68. Me qëllim që:

a) Të kontribuojnë në zgjidhjen në kohë të çdo problemi që lidhet me keqinterpretimin e mundshëm të të dhënave verifikuese për shpërthimet kimike.

b) Të asistojnë në standardizimin e stacioneve të cilat janë pjesë e rrjeteve përberëse të Sistemit Nderkombëtar Monitorues, çdo Shtet Pale merr përsipër të bashkëpunojë me Organizatën dhe me Shtetet tjera Pale në përdorimin e masave përkatëse, që parashikohen në pjesën III të protokollit.

Neni 5

Masat për të zgjidhur situatën dhe për të siguruar përmbushjen e Traktatit, duke përfshirë sanksionet

1. Konferenca duke marrë parasysh, ndër të tjera, rekomandimet e Këshillit Ekzekutiv do të marrë masat e nevojshme, ashtu siç përcaktohet në paragrafet 2 dhe 3, për të siguruar përmbushjen e këtij Traktati dhe për të ndrequr ose rregulluar çdo situatë, e cila bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Traktati.

2. Në rastet kur një Shtet Pale i është kërkuar nga Konferenca ose Këshilli Ekzekutiv që të ndreqë një situatë që ka sjellë probleme lidhur me përmbushjen e detyrimeve të saj dhe deshton në plotësimin e kërkesës brenda kohës së përcaktuar, Konferenca mund të vendosë të kufizojë ose të pezullojë Shtetin Pale nga ushtrimi i të drejtave dhe privilegjeve të tij, që rrjedhin nga ky Traktat deri sa Konferenca të vendosë ndryshe.

3. Në rastet kur demtimi i objektit dhe qëllimit të këtij Traktati mund të vijë si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve bazë të këtij Traktati, Konferenca mund t'i rekomandojë Shteteve Pale masa kolektive që janë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

4. Në mënyrë të alternuar Konferenca ose, në rast se çështja është urgjente, Këshilli Ekzekutiv mund t'ia paraqesë çështjen për shqyrtim, përfshirë informacionin dhe konkluzionet përkatëse Kombeve të Bashkuara.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij Traktati do të zgjidhen në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Traktati dhe në pajtim me dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

2. Kur lind një mosmarrëveshje midis dy ose me shumë Shteteve Pale, ose midis një ose me shumë Shtete Pale dhe Organizatës, rreth zbatimit ose interpretimit të këtij Traktati, palet përkatëse do të konsultohen së bashku për të zgjidhur sa më shpejt mosmarrëveshjen me anë të negociimit ose mënyrave të tjera paqësore të zgjedhura prej tyre, duke përfshirë ndihmën e organeve përkatëse të këtij Traktati dhe, me miratim të ndërsjellë, t'i drejtohen Gjykatës Nderkombëtare të Drejtësisë në pajtim me statutin e saj. Palet e përfshira duhet të informojnë Këshillin Ekzekutiv për veprimet që ndërmerren.

3. Këshilli Ekzekutiv mund të kontribuojë në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që mund të

linde, ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e ketij Traktati, me çfarëdo lloj menyre qe ta gjykoje te pershtatshme, duke perfshire sherbimin e tij me qellim te mire, per t'i bere thirrje Shteteve Pale ne mosmarreveshjeje qe te kerkojne nje zgjidhje nepermjet nje procesi te zgjedhur nga vete ata, duke ia paraqitur çeshtjen per shqyrtim Konferences dhe duke i rekomanduar nje afat kohor per çdo procedure te rene dakord.

4. Konferenca do te shqyrtoje çeshtjet qe lidhen me mosmarreveshjet qe lindin nga Shtetet Pale ose qe i dergohen per shqyrtim nga ana e Keshillit Ekzekutiv. Konferenca, nese e vlereson te arsyeshme, do te krijojë organe ose t'i ngarkojë atyre detyra per zgjidhjen e ketyre mosmarreveshjeve ne pajtim me nenin 2, paragrafi 26(j).

5. Konferenca dhe Keshilli Ekzekutiv jane perkatesisht te plotfuqishme, duke marre autorizimin e Asamblese se Pergjithshme te Kombeve te Bashkuara, per t'i kerkuar Gjykates Nderkombetare te Drejtësisë qe te jape nje mendim keshillimor per çdo ceshtje ligjore qe lind brenda sferes se veprimtarive te Organizates. Per kete qellim, midis Organizates dhe Kombeve te Bashkuara duhet te arrihet nje marreveshje ne pajtim me Nenin II, paragrafi 38(h).

6. Ky nen nuk cenon nenet 4 dhe 5.

Neni 7

Amendamentet

1. Ne cdo kohe pas hyrjes ne fuqi te ketij Traktati, çdo Shtet Pale mund te propozojë amendamente per Traktatin, protokollin, ose shtojcat e protokollit. Gjithashtu, çdo Shtet Pale mund te propozojë, ne pajtim me paragrafin 7, ndryshime ne Protokoll ose ne shtojcat perkatese. Propozimet per amendamente do t'i nenshtrohen procedurave qe jepen ne paragrafet 2 deri 6. Propozimet per ndryshime, ne perputhje me paragrafin 7, do t'i nenshtrohen procedurave qe jepen ne paragrafin 8.

2. Amendamenti i propozuar do te shqyrtohet dhe do te miratohet vetem nga nje Konference Amendamentesh.

3. Çdo propozim per amendament do t'i komunikohet Drejtorit te Pergjithshem, i cili do ta shperndaje ate ne te, gjitha Shtetet Pale dhe tek Depozituesi dhe do te kerkoje pikëpamjet e Shteteve Pale nese do te thirret nje Konference Amendamentesh per te shqyrtuar propozimet. Ne qofte se shumica e Shteteve Pale njofton Drejtorin e Pergjithshem jo me vone se 30 dite pas shperndarjes se propozimit se ato mbeshtesin shqyrtimin e metejshe me te tij, Drejtori i Pergjithshem do te therrase nje Konference Amendamentesh ne te cilen do te ftohen te gjitha Shtetet Pale.

4. Konferenca e Amendamenteve do te mbahet menjehere duke pasuar nje sesion te rregullt te saj, me perjashtim kur Shtetet Pale qe perkrahin mbledhjen e kesaj Konference kerkojne qe ajo te mblidhet me shpejt. Ne asnje rast nje Konference Amendamentesh nuk do te mbahet me shpejt se 60 dite pas shperndarjes se amendamentit te propozuar.

5. Amendamentet do te pranohen nga Konferenca e Amendamenteve me nje votim pro te shumices se Shteteve Pale dhe duke mos pasur asnje Shtet Pale, kunder.

6. Amendamentet do te hyjne ne fuqi per te gjitha Shtetet Pale 30 dite pas depozitimit te instrumenteve te ratifikimit dhe pranimit nga ana e te gjitha Shteteve Pale qe kane votuar pro ne Konferencen e Amendamenteve.

7. Me qellimin per te siguruar vijueshmerine dhe efektivitetin e ketij Traktati, pjeset I dhe III te protokollit dhe shtojcat 1 dhe 2 te tij do t'u nenshtrohen ndryshimeve ne perputhje me paragrafin 8, ne qofte se ndryshimet e propozuara kane te bejne vetem me çeshtjet e nje natyre teknike ose administrative. Gjithashtu, te gjitha dispozitat e tjera te protokollit dhe te shtojcave nuk do te jene subjekt ndryshimesh ne perputhje me paragrafin 8.

8. Ndryshimet e propozuara te permendura ne paragrafin 7 do te behen ne perputhje me procedurat e meposhtme:

a) Teksti i ndryshimeve te propozuara, se bashku me informacionin e nevojshem, duhet t'i transmetohet Drejtorit te Pergjithshem. Informacioni shtese per vleresimin e propozimit mund te pergatitet nga çdo Shtet Pale dhe Drejtori i Pergjithshem. Ky i fundit do t'ua komunikojë menjehere keto propozime dhe informacione te gjitha Shteteve Pale, Keshillit Ekzekutiv dhe Depozituesit.

b) Jo me vone se 60 dite pas marrjes nga ana e tij, Drejtori i Pergjithshem do te shqyrtojë propozimin per te percaktuar te gjitha pasojat e mundshme per dispozitat e ketij Traktati dhe zbatimin e tij dhe do t'i komunikojë nje informacion te tille te gjitha Shteteve Pale dhe Keshillit Ekzekutiv.

c) Keshilli Ekzekutiv do te shqyrtoje propozimin bazuar ne informacionin e vlefshem qe ka ne dispozicion, duke perfshire faktin nese propozimi i permbush kerkesat e paragrafit

7. Jo me vone se 90 dite pas marrjes nga ana e tij, Keshilli Ekzekutiv do t'ua njoftoje rekomandimet e tij, me shpjegimet perkatese, te gjitha Shteteve Pale per t'i shqyrtuar. Shtetet Pale duhet te bejne te ditur marrjen e njoftimit brenda 10 diteve.

d) Ne qofte se Keshilli Ekzekutiv u rekomandon te gjitha Shteteve Pale qe propozimi te pranohet, ai do te konsiderohet i aprovuar, nese asnje Shtet Pale nuk e kundershkon ate brenda 90 diteve pas marrjes se rekomandimit. Nese Keshilli Ekzekutiv sugjeron qe propozimi te hidhet poshte, ai do te konsiderohet si i tille nese asnje Shtet Pale nuk e kundershkon mospranimin brenda 90 diteve pas marrjes se rekomandimit.

e) Nese nje rekomandim i Keshillit Ekzekutiv nuk merr miratimin e kerkuar qe rrjedh nga paragrafi (d), vendimi per propozimin, duke perfshire vendimin, nese propozimi permbush sqarimet e paragrafit 7, do te merret si ceshtje substanciale nga ana e Konferences ne sesionin e saj te ardhshem.

f) Drejtori i Pergjithshem do te njoftoje te gjitha Shtetet Pale dhe Depozituesin per çdo vendim qe rrjedh nga ky paragraf.

g) Ndryshimet, e aprovuara sipas kesaj procedure, do te hyjne ne fuqi per te gjitha Shtetet Pale 180 dite pas dates se shpalljes nga ana e Drejtorit te Pergjithshem te aprovimit te tyre, me perjashtim kur eshte rekomanduar nje afat tjeter nga Keshilli Ekzekutiv ose kjo eshte vendosur nga Konferenca.

Neni 8

Rishikimi i Traktatit

1. Me perjashtim kur vendoset ndryshe nga shumica e Shteteve Pale, dhjete vjet pas hyrjes ne fuqi te ketij Traktati do te mblidhet nje Konferenca e Shteteve Pale per te rishikuar funksionimin dhe efektivitetin e ketij Traktati, me synim per te siguruar nese objektivat dhe qellimet ne hyrjen dhe ne dispozitat e ketij Traktati jane realizuar. Ky rishikim do te marre ne shqyrtim zhvillimet e reja shkencore dhe teknologjike qe kane te bejne me kete Traktat. Ne baze te nje kerkeses nga ana e ndonje Shteti Pale, Konferenca e Rishikimit do te shqyrtoje mundesine e lejimit te kryerjes se shperthimeve te nendheshme berthamore per qellime paqesore. Ne qofte se Konferenca e Rishikimit vendos me konsensus se mund te lejohen shperthime te tilla berthamore, ajo do te nise pa vonese punen me synimin per t'u rekomanduar Shteteve Pale nje amendament te pershtatshem per kete Traktat, qe do te parandaloje perfitime ushtarake nga shperthime te tilla berthamore. Çdo amendament i tille, i propozuar do t'i komunikohet Drejtorit te Pergjithshem nga çdo Shtet Pale dhe do te trajtohet ne perputhje me dispozitat e nenit 7.

2. Ne periudha te mevoneshme 10 vjeçare, mund te mblidhen Konferenca te tjera Rishikuese per te njejtin qellim, nese kjo vendoset ne vitin paraardhes nga Konferenca si nje ceshtje procedurale. Konferenca te tilla mund te mblidhen pas nje intervali prej me pak se dhjete vjetesh, nese kjo vendoset nga Konferenca si nje ceshtje thelbesore.

3. Normalisht, çdo Konferenca Rishikimi do te mbahet menjehere pas sesionit te rregullt vjetor te Konferences, te parashikuar ne nenin 2.

Neni 9

Kohëzgjatja dhe Terheqja

1. Ky Traktat do te kete nje kohezgjatje te pakufizuar.

2. Çdo Shtet Pale, ne ushrimin e sovranitetit te tij kombetar, do te kete te drejten te terhiqet nga ky Traktat, nese ai vendos se ngjarje te jashtezakonshme, qe lidhen me lenden e ketij Traktati, kane vene ne rrezik interesat e tij madhore.

3. Terheqja do te jete e efektshme duke njoftuar gjashte muaj me pare te gjitha Shtetet e tjera Pale, Keshillin Ekzekutiv, Depozituesin dhe Keshillin e Sigurimit te Kombeve te Bashkuara. Njoftimi per terheqje duhet te permbaje nje deklarate mbi ngjarjen ose ngjarjet e jashtezakonshme qe Shteti Pale konsideron se kane vene ne rrezik interesat e tij madhore.

Neni 10
Statusi i protokollit dhe shtojcave

Shtojcat e Traktatit, protokollit dhe shtojcat e protokollit jane pjese integrale te Traktatit. Çdo referim tek ky Traktat perfshin shtojcat e Traktatit, protokollin dhe shtojcat e protokollit.

Neni 11
Nënshkrimi

Ky Traktat do te jete i hapur per te gjitha Shtetet per t'u nenshkruar perpara hyrjes se tij ne fuqi.

Neni 12
Ratifikimi

Ky Traktat do t'i nenshtrohet ratifikimit nga Shtetet nenshkruese ne pajtim me proceset e tyre kushtetuese perkatese konstitucionale.

Neni 13
Aderimi

Çdo Shtet, i cili nuk e nenshkruan kete Traktat perpara hyrjes ne fuqi te tij, mund te aderoje ne te ne nje kohe te mevonshme.

Neni 14
Hyrja ne fuqi

1. Ky Traktat do te hyje ne fuqi 180 dite pas dates se depozitimit te instrumenteve te ratifikimit nga te gjitha Shtetet e listuara ne shtojcen 2 te ketij Traktati, por ne asnje rast me perpara se dy vjet pas hapjes per nenshkrim.

2. Ne qofte se ky Traktat nuk ka hyre ne fuqi tre vjet pas dates se pervjetorit te hapjes se tij per nenshkrim, Depozituesi do te thërrese nje Konference te Shteteve qe kane depozituar instrumentet e ratifikimit mbi bazen e kerkeses se shumices se ketyre Shteteve. Konferenca do te shqyrtoje masen, ne te cilen jane plotesuar kerkesat e paragrafit 1 dhe do te shqyrtoje e vendose me konsensus per masat qe mund te ndermerren, ne perputhje me te drejten nderkombetare, per të shpejtuar procesin e ratifikimit, me qellimin per ta lehtesuar hyrjen sa me pare ne fuqi te ketij Traktati.

3. Me perjashtim te rasteve kur vendoset ndryshe nga Konferenca, e permendur ne paragrafin 2 ose nga Konferenca te tjera te ketij lloji, ky proces do te perseritet ne pervjetoret qe vijojne te hapjes per nenshkrim te ketij Traktati, deri ne hyrjen e tij ne fuqi.

4. Te gjitha Shtetet nenshkruese do te ftohen te ndjekin Konferencen, e permendur ne paragrafin 2 dhe çdo konference te mevonshme qe permendet ne paragrafin 3, si vezhgues.

5. Per Shtetet, instrumentet e ratifikimit ose aderimit te te cileve jane depozituar me vone nga hyrja ne fuqi e ketij Traktati, ky i fundit do te hyje ne fuqi ne ditën e tridhjetë pas dates se depozitimit te instrumenteve te tyre te ratifikimit ose aderimit.

Neni 15
Rezervat

Nenet dhe shtojcat e ketij Traktati nuk do te jene subjekt per rezerva. Dispozitat e protokollit te ketij Traktati dhe shtojcat e protokollit nuk do te jene subjekt per rezerva qe nuk perputhen me objektin dhe qellimin e ketij Traktati.

Neni 16
Depozituesi

1. Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara do te jete Depozituesi i ketij Traktati dhe do te marre nenshkrimet, instrumentet e ratifikimit dhe te aderimit.

2. Depozituesi do te informoje menjehere te gjitha Shtetet Nenshkruese dhe Shtetet aderuese per daten e çdo nenshkrimi, daten e depozitimit te çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi, daten e hyrjes ne fuqi te Traktatit dhe te amendamenteve dhe ndryshimeve te metejshme, dhe marrjen e njoftimeve te tjera.

3. Depozituesi do t'u dergoje kopje te certifikuara ne menyren e duhur te ketij Traktati qeverive te shteteve nenshkruese dhe te atyre aderuese;

4. Ky Traktat do te rregjistrohet nga Depozituesi ne pajtim me Nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara.

Neni 17 **Tekstet autentike**

Ky Traktat, tekstet e te cilit jane ne gjuhen arabe, kineze, angleze, franceze, ruse, dhe spanjolle jane njesoje autentike dhe do te depozitohet tek Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara.

SHTOJCA 1 E TRAKTATIT

Lista e shteteve ne pajtim me nenin 2, paragrafi 28.

Afrika

Algjeria, Angola, Benini, Botsvana, Burkina Faso, Burundi, Kameruni, Kepi i Gjeller, Republika e Afrikes Qendrore, Cadi, Komoros, Kongo, Bregu i Fildishte, Xhibuti, Egjipti, Guinea Ekuatoriale, Eritrea, Etiopia, Gaboni, Gambia, Gana, Guinea, Guinea-Bisau, Kenia, Lesoto, Liberia, Xhamahiria Arabe Libiane, Madagaskari, Malavi, Mali, Mauritania, Mauritiusi, Maroku, Mozambiku, Namibia, Nigëri, Nigeria, Ruanda, Sao Tome & Principe, Senegali, Seishellet, Sierra Leone, Somalia, Afrika e Jugut, Sudani, Svazilendi, Togo, Tunizia, Uganda, Republika e Bashkuar e Tanzanise, Zairea, Zambia, Zimbabve.

Europa Lindore

Shqiperia, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Ceke, Estonia, Gjeorgjia, Hungaria, Latvia, Lituania, Polonia, Republika e Moldoves, Rumania, Federata Ruse, Sllovakia, Sllovenia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonise, Ukraina, Jugosllavia.

Amerika Latine dhe Karaibet

Antigua dhe Barbuda, Argjentina, Bahamas, Barbadosi, Belize, Bolivia, Brazili, Kili, Kolumbia, Kosta Rika, Kuba, Dominika, Republika Domenikane, Ekuadori, El Salvadori, Grenada, Guatemala, Guajana, Haiti, Hondurasi, Xhamajka, Meksika, Nikaragua, Panamaja, Paraguai, Peruja, Santa Kits dhe Nevis, Santa Lucia, Sant Vinsent dhe Grenadinet, Surinami, Trinidad e Tabago, Uruguai, Venezuela.

Lindja e Mesme dhe Azia Jugore

Afganistani, Bahreini, Bangladeshi, Bhutani, India, Republika Islamike e Iranit, Iraku, Izraeli, Jordania, Kazakistani, Kuvajti, Kirgistani, Lebanoni, Maldives, Omani, Nepali, Pakistani, Katari, Arabia Saudite, Sri Lanka, Republika Arabe Siriane, Taxhikistani, Turkmenistani, Emiratet e Bashkuara Arabe, Uzbekistani, Jemeni.

Amerika Veriore dhe Europa Perendimore

Andora, Austria, Belgjika, Kanadaja, Qipro, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Selia e Shenjte (akt.Vatikani), Islanda, Irlanda, Italia, Liehtenshteini, Luksemburgu, Malta, Monako, Hollanda, Norvegjia, Portugalia, San Marino, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Mbreteria e Bashkuar e Britanise se Madhe dhe Irlanda e Veriut, Shtetet e Bashkuara te Amerikes.

Azia Juglindore, Paqesori dhe Lindja e Larget

Australia, Brunei, Daresalam, Kamboxhia, Kina, Ishujt Kuk, Republika Demokratike Popullore e Korese, Fixhi, Indonezia, Japonia, Kiribati, Republika Popullore Demokratike e Laosit, Malajzia, Ishujt Marshall, Shtetet Federative te Mikronezise, Mongolia, Mianmari, Nauru, Zelanda e Re, Niue, Palau, Guinea e Re Papua, Filipinet, Republika e Korese, Samoa, Singapor, Ishujt Solomon, Tailanda, Tonga, Tuvalu, Vanuatu, Vietnami.

SHTOJCA 2 E TRAKTATIT

Lista e shteteve sipas nenit 14

Lista e shteteve anetare te Konferences mbi çarmatimin e mbajtur me 18 Qershor 1996, te cilet formalisht moren pjese ne punimin e sesionit te vitit 1996 te Konferences dhe te cilët jane ne tabelen 1 te botimit te Agjencise Nderkombetare te Energjise Berthamore, prill 1996, me titull "Reaktoret e Energjise Berthamore ne Bote" dhe te shteteve anetare te Konferences mbi çarmatimin e mbajtur me 18 qershor 1996, te cilet formalisht moren pjese ne punimin e sesionit e vitit 1996 te Konferences dhe qe jane ne tabelen 1 te botimit te Agjensise Nderkombetare te Energjise Atomike dhjetor 1995 me titull "Reaktoret e Kerkimit Berthamor ne Bote": Algjeria, Argjentina, Australia, Austria, Bangladeshi, Belgjika, Brazili, Bullgaria, Kanadaja, Kili, Kina, Kolumbia, Republika Demokratike Popullore e Korese, Egjipti, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, India, Indonezia, Republika Islamike e Iranit, Izraeli, Italia, Japonia, Meksika, Hollanda, Norvegjia, Pakistani, Peruja, Polonia, Rumania, Republika e Korese, Federata Ruse, Sllovakia, Afrika e Jugut, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Ukraina, Mbreteria e Bashkuar e Britanise se Madhe dhe Irlanda e Veriut, Shtete e Bashkuara te Amerikes, Vietnami, Zaireja.

PROTOKOLLI

I TRAKTATIT TË PLOTË PËR NDALIMIN E PROVAVE BËRTHAMORE

PJESA I

FUNKSIONET E SISTEMIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT DHE QENDRËS NDËRKOMBËTARE TË TË DHENAVE

Dispozita te pergjithshme

1. Sistemi Nderkombetar Monitorues do te perfshije strukturat e monitorimit te percaktuara ne nenin 4, paragrafi 16, si dhe mjetet perkatese te komunikimit.

2. Strukturat e monitorimit qe bejne pjese ne Sistemin Nderkombetar Monitorues do te perbehen nga sistemet e specifikuara ne shtojcen 1 te ketij protokolli. Sistemi Nderkombetar Monitorues do te permbush kerkesat teknike dhe operacionale te percaktuara ne manualet perkatese operacionale.

3. Nese e gjykon te pershtatshme, Organizata, ne perputhje me nenin 2, ne bashkepunim dhe duke u konsultuar me Shtetet Pale, shtete te tjera dhe me organizatat nderkombetare, do te vendose dhe koordinoje funksionimin dhe mbeshtetjen, dhe per çdo ndryshim ose zhvillim te mevonshem te Sistemit Nderkombetar Monitorues per te cilin mund te bihet dakord.

4. Ne perputhje me marreveshjet ose rregulloret dhe procedurat perkatese, nje Shtet Pale ose shtet tjetër, qe mirepret ose merr pergjegjesine per strukturat e Sistemit Nderkombetar Monitorues dhe Sekretariatit Teknik, do te bjere dakord dhe do te bashkepushte per krijimin, funksionimin, permiresimin, financimin dhe mirembajtjen e strukturave monitoruese, laboratoreve perkates te certifikuar dhe mjeteve perkatese te komunikimit brenda hapësirave qe jane nen juridiksionin ose

kontrollin e tij ose diku tjetër, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Një bashkëpunim i tillë do të jetë në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe të autenticitetit dhe specifikimet teknike që ndodhen në manualët përkatës operacionale. Ky Shtet do t'i japë Sekretariatit Teknik autoritetin për të hyrë në një strukturë monitoruese, për të kontrolluar pajisjet dhe lidhjet e komunikimit dhe do të bëjë dakord për të bërë ndryshimet e nevojshme në pajisjet dhe procedurat operacionale për të plotësuar kërkesat e rena dakord. Sekretariati Teknik do t'u sigurojë këtyre Shteteve asistencën e duhur teknike, nëse gjykohet nga Këshilli Ekzekutiv, asistencë e cila kërkohej për funksionimin e duhur të sistemit si pjesë e Sistemit Ndërkombëtar Monitorues.

5. Modalitetet për një bashkëpunim të tillë midis Organizatës dhe Shteteve Pale ose shteteve pritese ose atyre që marrin përgjegjësinë për strukturat e Sistemit Ndërkombëtar Monitorues do të përcaktohen në marrëveshjet dhe rregulloret që janë të përshatshme në secilin rast.

Monitorimi Sizmik

6. Çdo Shtet Pale merr përsipër që të bashkëpunojë në shkëmbimin në shkallë ndërkombëtare të të dhënave sizmike, për të asistuar në verifikimin e përmbushjes së këtij Traktati. Ky bashkëpunim do të përfshijë krijimin dhe funksionimin e një rrjeti global të stacioneve monitoruese sizmike kryesore dhe ndihmëse. Këto stacione do t'i japin të dhëna Qendres Ndërkombëtare të të Dhënave në përputhje me procedurat e rena dakord.

7. Rrjetet e stacioneve kryesore do të përbehen nga 50 stacione të specifikuara në tabelën 1-A të shtojcës 1 të këtij protokolli. Këto stacione do të plotësojnë kërkesat teknike dhe operacionale të specifikuara në Manualët Operacionale për Monitorimin Sizmik dhe Shkëmbimin Ndërkombëtar të të Dhënave Sizmike. Të dhënat e vazhdueshme nga stacionet kryesore do të transmetohen direkt ose nepermjet një qendre kombëtare të dhënash, që është e lidhur me Qendrën Ndërkombëtare të të Dhënave.

8. Për të plotësuar rrjetet kryesore, një rrjet ndihmës prej 120 stacionesh do të japë informacion në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nepermjet një qendre kombëtare të dhënash për Qendrën Ndërkombëtare të të Dhënave, në bazë të kërkesës. Stacionet ndihmëse që do të përdoren janë të listuara në tabelën 1-B të shtojcës 1 të këtij protokolli. Stacionet ndihmëse do të përmbushin kërkesat teknike dhe operacionale të specifikuara në Manualin Operacional për Monitorimin Sizmiologjik dhe Shkëmbimin Ndërkombëtar të të Dhënave Sizmike. Të dhënat nga stacionet ndihmëse mund të kërkojnë në çdo kohë nga Qendra Ndërkombëtare e të Dhënave dhe do të jenë menjëherë të disponueshme nepermjet rrjeteve kompjuterike në funksionim.

C. Monitorimi i radiobërthamave

9. Çdo Shtet Pale angazhohet të bashkëpunojë në shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave lidhur me et në atmosfere për të ndihmuar në verifikimin e përmbushjes së këtij Traktati. Ky bashkëpunim do të përfshijë krijimin dhe funksionimin e një rrjeti global të stacioneve që monitorojnë radiobërthamat dhe të laboratoreve të certifikuar. Rrjeti do të sigurojë të dhëna në përputhje me procedurat e rena dakord për Qendrën Ndërkombëtare të të Dhënave.

10. Rrjeti i stacioneve që masin radiobërthamat në atmosfere do të përfshijë një sistem të plote të përbërë prej 80 stacionesh, të specifikuara në tabelën 2-A të shtojcës së këtij protokolli. Të gjitha stacionet do të jenë të afta për të dedektuar praninë e lëndës radioaktive në atmosfere. Dyzet prej këtyre stacioneve do të jenë gjithashtu të afta edhe për monitorimin e pranisë së gazit inert, që lidhet me hyrjen në fuqi të këtij Traktati. Për këtë qëllim, Konferenca, në sesionin e parë të saj, do të aprovojë një rekomandim të bërë nga ana e komisionit përgatitës lidhur me faktin se cili nga dyzet stacionet e tabelës 2-A të shtojcës së këtij protokolli do të jetë i aftë për monitorimin e pranisë së gazeve inerte në momentin e hyrjes në fuqi të këtij traktati. Në sesionin e saj të parë të rregullt vjetor, Konferenca do të shqyrtojë dhe vendosë mbi një plan për aftësinë monitoruese të përdorimit të gazit inert në të gjitha rrjetet. Drejtori i Përgjithshëm do të përgatisë një raport për Konferencën mbi modalitetet e këtij përdorimi. Të gjitha stacionet monitoruese duhet të plotësojnë kërkesat teknike dhe operacionale të specifikuara në Manualin Operacional për Monitorimin e Radiobërthamave dhe Shkëmbimin Ndërkombëtar të të Dhënave për Radiobërthamat.

11. Rrjeti i stacioneve për monitorimin e radiobërthamave do të mbështetet nga laboratorët, të cilët do të jenë të certifikuar nga ana e Sekretariatit Teknik në përputhje me manualin përkatës operacional, për kryerjen, mbi bazën e kontratës me Organizatën dhe mbi bazën e shpërblimit për punën, të analizimeve të kampioneve që jepen nga stacionet që monitorojnë radiobërthamat.

Laboraret e specifikuar ne Tabelen 2-B te shtojces 1 te ketij protokolli, te pajisur ne menyren e duhur, do te shfrytezohen, nese kerkohet, nga Sekretariati Teknik per te kryer analiza shtese te kampioneve te marra nga stacionet monitoruese per radioberthamat. Me pelqimin e Keshillit Ekzekutiv, mund te certifikohen nje numer me i madh laboratoresh nga ana e Sekretariatit Teknik per te kryer analizat e pandërprera te provave nga stacionet monitoruese, qe marrin kampione kur eshte e nevojshme. Te gjithë laboraret e certifikuar do te pergatisin rezultatet e ketyre analizave per Qendren Nderkombetare te te Dhenave dhe ne realizimin e kesaj duhet te plotesojne kerkesat teknike dhe operacionale qe specifikohen ne Manualin Operacional mbi Monitorimin e Radioberthamave dhe Shkembimin Nderkombetar te te Dhenave mbi Radioberthamat.

D. Monitorimi hidroakustik

12. Çdo Shtet Pale merr persiper te bashkepunoje ne shkembimin nderkombetar te te dhenave hidroakustike per te asistuar ne verifikimin e permbushjes se ketij Traktati. Ky bashkepunim do te perfshije krijimin dhe funksionimin e nje rrjeti global stacionesh per monitorimin hidroakustik. Keto stacione do te sigurojne te dhena per Qendren Nderkombetare te te Dhenave, ne perputhje me procedurat e rena dakord.

13. Rrjeti i stacioneve hidroakustike do te perbehet nga stacionet e specifikuar ne Tabelen 3 te shtojces 1 te ketij protokolli dhe do te perfshije nje rrjet te pergjithshem prej gjashte stacionesh hidrofone dhe pese stacionesh te dedektimit te fazave-T. Keto stacione duhet te plotesojne kerkesat teknike dhe operacionale te specifikuar ne Manualin Operacional per Monitorimin Hidroakustik dhe Shkembimin Nderkombetar te te Dhenave Hidroakustike.

E. Monitorimi i infratingujve

14. Çdo Shtet Pale merr persiper te bashkepunoje ne shkembimin nderkombetar te te dhenave per infratingujt per te ndihmuar ne verifikimin e permbushjes se ketij Traktati. Ky bashkepunim do te perfshije krijimin dhe funksionimin e nje rrjeti global te stacioneve monitoruese te infratingujve. Keto stacione do te sigurojne te dhena ne perputhje me proceduren e rene dakord nga Qendra Nderkombetare e te Dhenave.

15. Rrjeti i stacioneve per infratingujt do te perbehet nga stacionet e specifikuar ne tabelen 3 te shtojces 1 te ketij protokolli dhe do te permbaje nje rrjet te plote prej gjashtedhete stacionesh. Keto stacione duhet te plotesojne kerkesat teknike dhe operacionale te specifikuar ne Manualin Operacional per Monitorimin e Infratingujve dhe Shkembimin Nderkombetar te te Dhenave per Infratingujt.

F. Funksionet e Qendres Nderkombetare te te Dhenave

16. Qendra Nderkombetare e te Dhenave do te marre, grumbulloje, perpunojë, analizoje, pergatise raportet dhe arkivoje te dhenat e marra nga strukturat e Sistemit Nderkombetar te te Dhenave, duke perfshire rezultatet e analizave te kryera ne laboraret e certifikuar.

17. Procedurat dhe kriteret e paraqitjes se rasteve standarde qe tregojne kriteret per t'u perdorur nga Qendra Nderkombetare e te Dhenave ne kryerjen e funksioneve te saj per te cilat eshte rene dakord, veçanerisht per hartimin e rezultateve standarde perfundimtare dhe per kryerjen e nje shkalle standarde te sherbimeve per Shtetet Pale, do te jene te shtjelluara ne Manualin Operacional per Qendren Nderkombetare te te Dhenave dhe do te zhvillohen progresivisht. Procedurat dhe kriteret e zhvilluara fillimisht nga ana e komisionit pergatitor do te aprovohen nga ana e Konferencës ne sesionin e saj te pare.

Rezultatet standarde te Qendres Nderkombetare te te Dhenave

18. Qendra Nderkombetare e te Dhenave do te zbatoje ne menyre rutine metodat e perpunimit automatik dhe analizat bashkevepruese njerezore per te dhenat e paperpunuara te Sistemit Nderkombetar Monitorues me qellimin per te nxjerre dhe arkivuar rezultate standarde te Qendres Nderkombetare te te Dhenave ne emer te te gjitha Shteteve Pale. Keto rezultate do te sigurohen pa shpenzim per Shtetet Pale dhe nuk do te cenojne gjykimin perfundimtar ne lidhje me natyren e çdo ngjarje, e cila do te mbetet ne pergjegjesine e Shteteve Pale dhe qe do te perfshije:

a) Listat e integruara te te gjitha sinjaleve te zbuluara nga ana e Sistemit Nderkombetar Monitorues, si edhe listat e ngjarjeve standarde dhe buletinet, duke perfshire vlerat dhe pasigurite shoqeruese, qe llogariten per çdo rast te lokalizuara nga Qendra Nderkombetare e te Dhenave, bazuar ne nje grup parametrash standarde.

b) Buletinet e rasteve standarde te paraqitur qe rezultojne nga zbatimi per çdo rast nga Qendra Nderkombetare e te Dhenave i kriterëve te paraqitjes se rasteve standarde, duke perdorur parametrat karakterizuese te specifikuara ne shtojcen 2 te ketij protokollit, me objektivin per te karakterizuar, vene ne dukje ne buletinet e rasteve standarde dhe per te shfaqur rastet qe jane ne perputhje me fenomenet natyrore ose jo berthamore dhe fenomenet artificiale. Buletini i rasteve standarde do te tregojë ne menyre numerike per çdo rast shkallen ne te cilen ai rast ploteson ose nuk ploteson kriteret e rasteve qe shfaqen. Ne zbatimin e rasteve standarde qe shfaqen, Qendra Nderkombetare e te Dhenave do te perdore si kriteret globale, ashtu edhe kriteret shtese te shfaqjes, per te marre parasysh ndryshimet rajonale. Qendra Nderkombetare e te Dhenave do te rrisë ne menyre progresive aftësitë e saj teknike me fitimin e eksperiences ne funksionimin e Sistemit Nderkombetar Monitorues.

c) Permblledhjet ekzekutive, te cilat permblledhin te dhenat e marra dhe te arkivuara nga Qendra Nderkombetare e te Dhenave, rezultatet e Qendres Nderkombetare te te Dhenave dhe funksionimin e statusin operacional te Sistemit Nderkombetar Monitorues dhe Qendres Nderkombetare te te Dhenave.

d) Fragmentet ose pjeset e veçuara te rezultateve standarde te Qendres Nderkombetare te te Dhenave te specifikuara ne nenparagrafet (a) deri (c) te zgjedhura ne pajtim me kërkesen e nje Shteti Pale te veçante.

19. Qendra Nderkombetare e te Dhenave do te kryejë, pa shpenzimet e Shteteve Pale, studime te veçanta, per te siguruar rishikime teknike me ane te analizimeve profesionale te te Dhenave te Sistemit Nderkombetar Monitorues, nese kjo kerkohet nga ana e Organizates ose nga nje Shtet Pale per te permiresuar vlerat e llogaritura per shenjat standarde dhe parametrat e rasteve.

Sherbimet e Qendres Nderkombetare te te Dhenave per Shtetet Pale

20. Qendra Nderkombetare e te Dhenave do t'i sigurojë Shteteve Pale njohjen ne menyre te hapur, te barabarte, ne kohe dhe te pershtatshme me te gjitha te dhenat e Sistemit Nderkombetar Monitorues, te paperpunuara ose te perpunuara, te gjitha rezultatet e Qendres Nderkombetare te te Dhenave, dhe te gjitha te dhenat e tjera te Sistemit Nderkombetar Monitorues qe ndodhen ne arkivin e Qendres Nderkombetare te te Dhenave, ose permes Qendres Nderkombetare te te Dhenave, te strukturave qe perbejne Sistemin Nderkombetar Monitorues. Metodot per mbeshtetjen e hyrjes tek te dhenat dhe sigurimin e te dhenave do te perfshijne sherbimet e meposhtme:

a) Percjelljen ne menyre te menjehershme dhe te rregullt tek nje Shtet Pale te rezultateve te Qendres Nderkombetare te te Dhenave ose zgjedhjen e tyre nga Shteti Pale dhe, nese kerkohet, zgjedhjen nga ana e Shtetit Pale te te dhenave te Sistemit Nderkombetar Monitorues.

b) Sigurimin e te dhenave ose rezultateve te dala ne pergjigje te kërkesave ad hoc nga ana e Shteteve Pale per riparimin nga strukturat arkivore te Qendres Nderkombetare te te Dhenave dhe te Sistemit Nderkombetar Monitorues te te dhenave dhe rezultateve, duke perfshire hyrjen ne menyre elektronike ne te dhenat e Qendres Nderkombetare te te Dhenave.

c) Dhenien e asistences per Shtetet Pale te caktuar, me kërkesen e tyre dhe pa asnje shpenzim, nepermjet analizimeve te specializuara te te dhenave te Sistemit Nderkombetar Monitorues dhe te dhenave te tjera perkatese te siguruara nga Shteti Pale kerkues, me qellim per te ndihmuar Shtetin Pale ne fjale per te identifikuar burimin e rasteve specifike. Dalja e analizave te tilla teknike do te konsiderohet nje rezultat i Shtetit Pale kerkues, por ato do te jene te vlefshme per te gjitha Shtetet Pale.

Sherbimet e Qendres Nderkombetare te te Dhenave te specifikuara ne nenparagrafet (a) dhe (b) do te vihen ne dispozicion pa shpenzime per çdo Shtet Pale. Volumet dhe formatet e te dhenave do te vendosen ne Manualin Operacional per Qendren Nderkombetare te te Dhenave.

Paraqitja e ngjarjeve kombetare

21. Qendra Nderkombetare e te Dhenave, nese kerkohet nga nje Shtet Pale, do te zbatojë ndaj çdo rezultati te saj standard, mbi baza te rregullta dhe ne menyre te vetvetishme, kriteret per paraqitjen e ngjarjeve kombetare te vendosura nga ai Shtet Pale dhe t'i jape rezultatet e ketyre analizave atij Shteti Pale. Ky sherbim do te ndermerret pa shpenzim per Shtetin Pale kerkues. Rezultati i ketyre proceseve te paraqitjes se rasteve kombetare do te konsiderohet nje rezultat i Shtetit Pale kerkues.

Asistenca teknike

22. Qendra Nderkombetare e te Dhenave do te ofrojë, kur kerkohet, asistencen teknike per Shtetet Pale te veçante;

a) Ne formulimin e kërkesave te tyre per zgjedhjen dhe paraqitjen e te dhenave dhe rezultateve.

b) Me ane te instalimit ne Qendren Nderkombetare te te Dhenave, pa shpenzim nga ana e Shtetit Pale kerkues, te algoritmeve kompjuterike ose software-ve te siguruara nga ana e atij Shteti Pale per te kompjuterizuar parametrat e sinjaleve dhe te rasteve te reja, te cilat nuk jane perfshire ne Manualin Operacional per Qendren Nderkombetare te te Dhenave, rezultati do te konsiderohet si rezultat i Shtetit Pale kerkues.

c) Me ane te dhenies se asistences per Shtetet Pale ne zhvillimin e aftesise per te marre, perpunuar dhe analizuar te dhenat e Sistemit Nderkombetar Monitorues ne nje qender kombetare te dhenash.

23. Qendra Nderkombetare e te Dhenave do te monitoroje dhe do te raportoje ne menyre te vazhdueshme mbi statusin e funksionimit te strukturave qe perbejne Sistemin Nderkombetar Monitorues, te lidhjeve te komunikimit dhe te sistemeve te saj te perpunimit te te dhenave. Ajo do te beje njoftimet e nevojshme per ata qe jane pergjegjes, nese funksionimi i ndonje komponenti nuk do te plotesoje nivelet e pranuar te percaktuara ne manualin operacional perkates.

PJESA II INSPEKTIMET NË TERREN

A. Dispozitat e pergjithshme

1. Procedurat ne kete pjese do te zbatohen ne pajtim me dispozitat per inspektimet ne terren te percaktuara ne nenin 4.

2. Inspektimet ne terren do te kryhen ne zonen ku ka ndodhur ngjarja qe ka bere te domosdoshem inspektimin ne terren.

3. Zona e nje inspektimi ne terren do te jete e panderprere dhe madhesia e saj nuk do t'i kaloje 100 km². Nuk do te kete distance ne gjatesi lineare me te madhe se 50 kilometra ne çdo lloj drejtimi.

4. Kohezgjatja e inspektimeve ne terren nuk do t'i kaloje 60 dite nga dita e aprovimit te kerkeses per inspektim ne terren ne perputhje me nenin 4, paragrafi 46, por ajo mund te zgjatet deri ne nje maksimum prej 70 ditesh ne perputhje me nenin 4, paragrafi 49.

5. Ne qofte se zona e inspektimit qe specifikohet ne mandatin perkates shtrihet ne territorin ose vendet e tjera qe ndodhen nen juridiksionin ose kontrollin e me teper se nje Shteti Pale, dispozitat per inspektime ne terren do te zbatohen, nese gjykohet e pershtatshme, per secilin Shtet Pale, ne territorin e te cilit shtrihet zona qe inspektohet.

6. Ne rastet ku zona qe inspektohet eshte nen juridiksionin ose kontrollin e Shtetit Pale qe inspektohet, por qe ndodhet ne territorin e nje tjeter Shteti Pale ose ne rastet kur hyrja nga pika e hyrjes per ne zonen qe inspektohet kerkon kalimin tranzit permes territorit te nje Shteti Pale tjeter, pervec Shtetit Pale qe inspektohet, Shteti ne fjale do te ushtroje te drejtat dhe permbushe detyrimet qe kane te bejne me inspektimet ne perputhje me kete protokoll. Ne kete rast, Shteti Pale ne territorin e te cilit ndodhet zona qe inspektohet, duhet te lehtesoje inspektimin dhe te siguroje mbeshtetjen e nevojshme per t'i mundesuar skuadres se inspektimit qe te kryeje detyrat e saj ne kohe dhe ne menyre efektive. Shtetet Pale, ne territorin e te cileve kerkohet te behet kalimi tranzit, per te arritur ne zonen qe inspektohet, do te lehtesojne kete kalim tranzit.

7. Ne rastet kur zona qe inspektohet eshte nen juridiksionin ose kontrollin e Shtetit Pale qe inspektohet, por ndodhet ne territorin e nje Shteti jo Pale ne kete Traktat, Shteti Pale qe inspektohet duhet te marre te gjitha masat e nevojshme per te siguruar qe inspektimi te kryhet sipas ketij protokolli. Nje Shtet Pale, i cili ka nen juridiksionin ose kontrollin e tij nje ose me teper zona ne territorin e nje Shteti jo Pale ne kete Traktat, ai duhet te marre te gjitha masat e nevojshme per te siguruar lejimin nga ana e Shtetit ku ndodhet zona qe inspektohet, te inspektoreve dhe te asistenteve te inspektimit te caktuar per ate Shtet Pale. Nese nje Shtet Pale qe inspektohet nuk mund te siguroje lejimin, ai duhet te demonstroje se ka marre te gjitha masat e nevojshme per te bere nje gje te tille.

8. Ne rastet ku zona qe inspektohet ndodhet ne territorin e nje Shteti Pale, por eshte nen juridiksionin ose kontrollin e nje Shteti jo Pale ne kete Traktat, Shteti Pale do te marre te gjitha masat e nevojshme te kerkuara per nje Shtet Pale qe inspektohet dhe nje Shtet Pale ne territorin e te cilit ndodhet zona qe inspektohet, pa cenuar rregullat dhe praktikat e te drejtes nderkombetare, per te siguruar qe inspektimet ne terren mund te kryhen ne perputhje me kete protokoll. Nese nje Shtet Pale qe inspektohet nuk mund te siguroje lejimin per te hyre ne zonen qe inspektohet, ai duhet te demonstroje se ka marre te gjitha masat e nevojshme per te siguruar hyrjen pa cenuar rregullat dhe

praktikat e se drejtes nderkombetare.

9. Madhesia e skuadres se inspektimit do te mbahet ne minimumin e nevojshem per permbushjen ne menyren e duhur te mandatit te inspektimit. Numri i pergjithshem i anetareve te skuadres se inspektimit qe eshte i pranishem ne territorin e Shtetit Pale qe inspektohet ne çdo kohe te caktuar, me perjashtim gjate periudhes se trajnimit, nuk duhet te kaloje te 40 personat. Asnje shtetas i Shtetit Pale kerkues ose i Shtetit Pale qe inspektohet nuk duhet te jete anetar i skuadres te inspektimit.

10. Drejtori i Pergjithshem do te percaktoje madhesine e skuadres te inspektimit dhe do te zgjedhe anetaret e saj nga lista e inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit, duke marre parasysh rrethanat qe lidhen me nje kerkese te veçante.

11. Shteti Pale qe inspektohet duhet te siguroje ose rregulloje ndihmen e nevojshme per skuadren e inspektimit siç jane: menytrat e komunikimit, sherbimet e perkthimit, transportimi, hapësira e punes, sistemimi dhe kujdesi shendetesor.

12. Shteti Pale qe inspektohet do te shperblehet ne te holla nga Organizata, ne nje periudhe kohe te shkurter te arsyeshme pas arritjes se rezultateve te inspektimit, per te gjitha shpenzimet, perfshire ato te permendura ne paragrafet 11 dhe 49, qe kane te bejne qendrimin dhe aktivitetet funksionale te skuadres se inspektimit ne territorin e Shtetit Pale qe inspektohet.

13. Procedurat per zbatimin e inspektimeve ne terren do te detajohen ne Manualin Operacional per Inspektimet ne Terren.

B. Rregullat e perhershme

Caktimi i inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit

14. Nje grup inspektimi mund te perbehet nga inspektore dhe asistente inspektimi. Nje inspektim ne terren do te kryhet vetem nga inspektore te kualifikuar te caktuar posaçerisht per kete funksion. Ata mund te ndihmohen nga asistente te caktuar posaçerisht per inspektim, te tille si personeli teknik dhe administrativ, ekuipazhi i avioneve dhe perkthyesit.

15. Inspektoret dhe asistentet e inspektimit do te caktohen si kandidate per t'u emeruar ne detyre nga ana e Shteteve Pale ose nga ana e Drejtorit te Pergjithshem ne rastin e stafit te Sekretariatit Teknik, ne baze te specializimit dhe eksperiencës se tyre qe ka te beje me qellimin dhe funksionet e inspektimeve ne terren. Kandidatet do te aprovohen paraprakisht nga ana e Shteteve Pale ne perputhje me paragrafin 18.

16. Secili Shtet Pale, jo me vone se 30 dite pas hyrjes ne fuqi te ketij Traktati per te, duhet te njoftoje Drejtorin e Pergjithshem per emrat, datat e lindjes, seksin, rangjet, kualifikimet dhe eksperiencen profesionale te personave te propozuar nga Shteti Pale, per te sherbyer si inspektore dhe asistente inspektimi.

17. Jo me vone se 60 dite pas hyrjes ne fuqi te ketij Traktati, Sekretariati Teknik duhet t'i komunikojë me shkrim te gjitha Shteteve Pale nje liste fillestare te emrave, kombesive, dateve te lindjes, seksit dhe rangjeve te inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit te propozuar per te kryer keto funksione nga Drejtori i Pergjithshem dhe Shtetet Pale, si edhe nje pershkrim te kualifikimit dhe eksperiencës se tyre profesionale.

18. Çdo Shtet Pale duhet te njoftoje menjehere marrjen e listes fillestare te inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit te propozuar per keto funksione. Çdo inspektor ose asistent inspektimi qe perfshihet ne kete liste do te konsiderohet si i pranuar, me perjashtim te rasteve kur nje Shtet Pale, jo me vone se 30 dite pas njoftimit te marrjes se listes, deklaroi me shkrim mospranimin e tij. Shteti Pale mund të perfshije arsyen per kundërshtimin e tij. Ne rast te mospranimit, inspektori ose asistenti i inspektimit i propozuar nuk do te marre persiper ose te marre pjese ne aktivitetet e inspektimit ne terren ne ate territor ose vend tjetër qe eshte nen juridiksionin apo kontrollin e Shtetit Pale, qe ka deklaruar mospranimin nga ana e tij.

19. Sa here qe propozohen shitesa ose ndryshime ne listen e inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit nga ana e Drejtorit te Pergjithshem ose nga nje Shtet Pale, zevendesimi i inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit do te behet ne te njejten menyre qe eshte parashikuar per listen fillestare. Çdo Shtet Pale duhet te njoftoje menjehere Sekretariatin Teknik nese nje inspektor ose asistent inspektimi i emeruar prej tij nuk mund te permbushë me detyrat e inspektorit ose asistentit te inspektimit.

20. Sekretariati Teknik do te mbaje te rinovuar listen e inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit dhe do te njoftoje Shtetet Pale per shitesat ose ndryshimet ne liste.

21. Nje Shtet Pale qe kerkon inspektim ne terren mund te propozoje qe nje inspektor, nga lista e inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit, te sherbeje si vëzhgues i tij ne perputhje me nenin 4, paragrafi 61.

22. Ne baze te paragrafit 23, nje Shtet Pale do te kete te drejten qe ne çdo kohe te shfaqë kundërshtime per çdo inspektor ose asistent inspektimi, i cili është pranuar tashme. Ky Shtet Pale duhet te njoftoje me shkrim Sekretariatit Teknik per kundërshtimin e tij dhe mund te përfshijë arsyen e kundërshtimit. Nje kundërshtim i tille do te behet i efektshëm 30 dite pas marrjes se njoftimit nga ana e Sekretariatit Teknik. Ky i fundit do te konfirmoje menjehere marrjen e njoftimit per kundërshtimin dhe do te informoje Shtetet Pale qe bëjnë kundërshtimin dhe emerimin per daten ne te cilen inspektoret dhe asistentet e inspektimit nuk do te caktohen me per ate Shtet Pale.

23. Nje Shtet Pale qe është njoftuar per nje inspektim nuk do te kerkoje heqjen nga skuadra e inspektimit te ndonjerit nga inspektoret ose asistenteve te inspektimit qe u është dhënë mandati i inspektimit.

24. Numri i inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit te pranuar nga nje Shtet Pale duhet te jete i mjaftueshëm per te lejuar vlefshmerine e numrit te duhur te inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit. Ne qofte se Drejtori i Përgjithshëm vlereson se mospranimi nga ana e nje Shteti Pale i inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit te propozuar pengon caktimin e nje numri te mjaftueshëm te inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit ose vështireson përmbushjen efektive te qellimeve te inspektimit ne terren, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia paraqese per shqyrtim çështjen Keshillit Ekzekutiv.

25. Çdo inspektor i përfshire ne listen e inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit do te marrë trajnimin perkates. Ky trajnim do te pergatitet nga Sekretariati Teknik ne pajtim me procedurat e specifikuar ne Manualin Operacional per Inspektimet ne Terren. Sekretariati Teknik ne marreveshje me Shtetet Pale, do te koordinoje nje grafik per trajnimin e inspektoreve.

Privilegjet dhe imunitetet

26. Pas pranimi te listes fillestare te inspektoreve dhe asistenteve te inspektimit, siç parashikohet ne paragrafin 18 ose te ndryshuar ne perputhje me paragrafin 19, çdo Shtet Pale do te jete i detyruar te leshoje, ne perputhje me procedurat e tij kombetare dhe bazuar ne kërkesen e bere nga ana e nje inspektori ose asistenti inspektimi, viza me shume hyrje/dalje dhe/ose viza tranziti dhe dokumente te tjera perkatese qe lejon çdo inspektor dhe asistent inspektimi te hyje dhe te qendroje ne territorin e atij Shteti Pale per qellimin e vetem te kryerjes se veprimtarive te inspektimit. Çdo Shtet Pale duhet te leshoje vizat e nevojshme ose dokumentet e udhetimit per kete qellim jo me vone se 48 ore pas marrjes se kërkeses ose menjehere pas mbërritjes të skuadres se inspektimit ne piken e hyrjes ne territorin e Shtetit Pale. Keto dokumente do te jene te vlefshme per aq kohe sa te jete e nevojshme per t'i mundësuar inspektorit apo asistentit te inspektimit, qe te qendroje ne territorin e Shtetit Pale, qe inspektohet per qellimin e vetem te kryerjes se veprimtarive te inspektimit.

27. Per te ushtruar funksionet e tyre me efektivitet, anetareve te skuadres se inspektimit do t'u akordohen privilegje dhe imunitete siç përcaktohen ne nenparagrafet (a) deri (i). Privilegjet dhe imunitetet do t'u garantohen anetareve te skuadres se inspektimit per qellimet e ketij Traktati dhe jo per perfitime personale. Keto privilegje dhe imunitete do t'u akordohen atyre per tere periudhen qe nga hyrja e deri ne largimin nga territori i Shtetit Pale qe inspektohet dhe me pas, ne lidhje me veprimet e kryera me pare ne ushtrimin e funksioneve te tyre zyrtare.

a) Pjesëtareve te skuadres se inspektimit do t'u akordohet paprekshmeria qe gezojne agjentet diplomatike ne pajtim me nenin 29 te Konventes se Vjenes te 18 prillit 1961 mbi Marredheniet Diplomatike.

b) Banesave dhe zyrave te punes qe shfrytezohen nga perfaqesuesit e skuadres se inspektimit, qe kryejne aktivitate inspektimi ne pajtim me kete Traktat, do t'u akordohen paprekshmeria dhe mbrojtja qe gezojne lokalet (e agjenteve diplomatike ne pajtim me nenin 30, paragrafi 1, te Konventes se Vjenes mbi Marredheniet Diplomatike.

c) Letrat dhe korrespondencat, përfshire regjistrimet e skuadres se inspektimit do te gezojne paprekshmerine qe akordohet per te gjitha letrat dhe korrespondencat e agjenteve diplomatike ne pajtim me nenin 30, paragrafi 2 te Konventes se Vjenes mbi Marredheniet Diplomatike. Skuadrat e inspektimit do te kene te drejten te perdorin kode per komunikimin e tyre me Sekretariatit Teknik.

d) Kampionet dhe pajisjet e miratuara qe barten nga anetaret e skuadres se inspektimit do te jene te paprekshme ne baze te dispozitave qe permbahen ne kete Traktat dhe te perjashtuara nga te

gjitha detyrimet doganore. Kampionet që janë të rrezikshëm duhet të transportohen në përputhje me rregullat perkatese.

e) Pjesëtareve të skuadres së inspektimit do t'u akordohen imunitetet që u akordohen agjenteve diplomatike në pajtim me nenin 31 paragrafet 1, 2 dhe 3 të Konventes së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike.

f) Pjesëtareve të skuadres së inspektimit që kryejnë aktivitete në baze të këtij Traktati do t'u akordohet përjashtimi nga detyrimet dhe taksat që u akordohet agjenteve diplomatike në pajtim me nenin 34 të Konventes së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike.

g) Pjesëtarët e skuadres së inspektimit do të lejohen që të sjellin në territorin e Shtetit Pale që inspektohet, pa paguar ndonjë detyrim doganor ose detyrime të tjera perkatese, artikujt e përdorimit vetjak, me përjashtim të artikujve, importi ose eksporti i të cilëve është ndaluar me ligj ose kontrollohen nga rregullat karantine.

h) Pjesëtareve të skuadres së inspektimit do t'u garantohen të njëjtat lehtësi në qarkullimin dhe shkëmbimin e monedhës siç u garantohen përfaqësuesve të qeverive të huaja gjatë misioneve të tyre zyrtare të perkohshme.

i) Pjesëtarët e skuadres së inspektimit nuk duhet të merren me aktivitete profesionale ose tregëtare për përfitime personale në territorin e Shtetit Pale që inspektohet.

28. Kur behet kalimi tranzit në territorin e Shteteve Pale që nuk janë Shtete Pale që inspektohen, anëtarëve të skuadres së inspektimit do t'u akordohen të njëjtat privilegje dhe imunitete që gezojnë agjentët diplomatike në pajtim me nenin 40, paragrafi 1 të Konventes së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike. Letrave dhe korespondencave, përfshirë regjistrimet, kampionet dhe pajisjet e aprovuara që transportohen prej tyre, do t'u akordohen privilegjet dhe imunitetet e percaktuara në paragrafin 27 (c) dhe (d).

29. Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, anëtarët e skuadres së inspektimit do të jenë të detyruar të respektojnë ligjet dhe rregullat e Shtetit Pale që inspektohet dhe, në masën që është në përputhje me mandatin e inspektimit, do të jenë të detyruar që të mos nderhyjnë në punët e brendshme të atij Shteti. Nëse Shteti Pale, që inspektohet vlerëson se ka patur një abuzim me privilegjet dhe imunitetet e specifikuar në këtë protokoll, do të zhvillohen konsultime ndërmjet Shtetit Pale dhe Drejtorit të Përgjithshëm, për të percaktuar nëse ka ndodhur një abuzim i tillë dhe, nëse arrihet në këtë përfundim, për të parandaluar perseritjen e tij.

30. Imuniteti që rrjedh nga juridiksioni i anëtarëve të skuadres së inspektimit mund të terhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm në ato raste kur ai është i mendimit që ky imunitet do të pengonte zbatimin e drejtësisë, dhe se ai mund të hiqet pa cenuar zbatimin e dispozitave të këtij Traktati. Kjo heqje e imuniteteve duhet gjithmone të shprehet qartë.

31. Vezhguesve do t'u akordohen të njëjtat privilegje dhe imunitete që u akordohen pjesëtareve të skuadres së inspektimit në kuadrin e këtij seksioni, përjashtuar ato që akordohen në paragrafin 27 (d).

Pikat e Hyrjes

32. Çdo Shtet Pale do të percaktojë pikat e tij të hyrjes dhe do t'i japë informacionin e kërkuar Sekretariatit Teknik jo më vonë se 30 ditë mbas hyrjes në fuqi të këtij Traktati për të. Këto pika të hyrjes do të jenë të tilla që skuadra e inspektimit mund të arrijë një zonë inspektimi nga kjo pikë hyrjeje të paktën brenda 24 orëve. Vendndodhja e pikave të hyrjes do t'u jepet të gjitha Shteteve Pale nga Sekretariati Teknik. Pikat e hyrjes mund të shërbejnë gjithashtu dhe si pika të daljes.

33. Çdo Shtet Pale mund të ndryshojë pikat e hyrjes duke njoftuar Sekretariatin Teknik për këtë ndryshim. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi pas marrjes së këtij njoftimi nga ana e Sekretariatit Teknik, për të lejuar njoftimin perkatesë të të gjitha Shteteve Pale.

34. Nëse Sekretariati Teknik vlerëson se ekziston një numër i pamjaftueshëm i pikave të hyrjes për kryerjen në kohë të inspektimeve ose që ndryshimet e pikave të hyrjes që propozohen nga një Shtet Pale do të pengonin kryerjen në kohë të inspektimeve, ai do të konsultohet me Shtetin Pale të interesuar për të zgjidhur problemin.

Rregullat për përdorimin e avioneve të paplanifikuar

35. Në rastet kur nuk është e mundur të udhëtohet në një kohë të shpejtë për në pikën e hyrjes duke përdorur fluturimet tregtare të planifikuara, një skuadër inspektimi mund të shfrytëzojë avionet të paplanifikuar. Jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati për një Shtet Pale, ky i fundit do të informojë Sekretariatin Teknik për numrin e përhershëm të autorizimit diplomatik të një

avioni te paplanifikuar, qe transporton nje skuader inspektimi dhe pajisjet e nevojshme per inspektim. Kurset e fluturimit te avionit do te jene pergjate linjave ajrore nderkombetare te vendosura ne menyren qe eshte rene dakort midis Shtetit Pale dhe Sekretariatit Teknik, te cilat do te sherbejne si baze per dhenien e klirences diplomatike.

Pajisjet e miratuara për inspektim

36. Konferenca, ne sesionin e pare te saj, do te shqyrtoje dhe do te aprovoje nje liste te pajisjeve qe do te perdoren gjate inspektimeve ne terren. Çdo Shtet Pale mund te paraqese propozimet per perfshirjen e pajisjeve ne liste. Specifikimet per perdorimin e pajisjeve, te dhena me hollesi ne Manualin Operacional per Inspektimet ne Terren, do te marrin parasysh rrethanat e sigurise dhe fshehtesise ne te cilat kjo pajisje mund te perdoret.

37. Pajisja qe do te perdoret gjate inspektimeve ne terren duhet te perbehet nga pajisja qendrore per aktivitetet dhe teknikat e inspektimit qe specifikohen ne paragrafin 69, si dhe nga pajisja ndihmese per kryerjen ne kohe dhe me efektivitet te inspektimeve ne terren.

38. Sekretariati Teknik do te siguroje se te gjitha tipet e pajisjeve te aprovuara jane ne dispozicion per inspektimet ne terren kur kerkohet. Kur duhet te behet nje inspektim ne terren, Sekretariati Teknik do te vertetoje ne kohen e duhur se pajisja eshte e kalibruar, mirembajtur dhe e ruajtur. Per te lehtesuar kontrollimin e pajisjes ne piken e hyrjes nga Shteti Pale qe inspektohet, Sekretariati Teknik do te siguroje dokumentacionin dhe do ta vulose vertetimin.

39. Çdo pajisje qe mbahet ne menyre te perhershme do te jete nen ruajtjen e Sekretariatit Teknik. Ky i fundit do te jete pergjegjes per mirembajtjen dhe kalibrimin e kesaj pajisje.

40. Nese e shihet te arsyeshme, Sekretariati Teknik do te beje marreveshje me Shtetet Pale, per te siguruar pajisjen e permendur ne liste. Keto Shtete Pale do te jene pergjegjese per mirembajtjen dhe kalibrimin e pajisjes.

C. Kërkesa për inspektim në terren, mandati i inspektimit dhe njoftimi i inspektimit

Kërkesa per inspektim ne terren

41. Ne pajtim me nenin 4, paragrafi 37, kërkesa per inspektim ne terren do te permbaje te pakten informacionin e meposhtem:

a) Koordinatat e peraferta gjeografike dhe vertikale te vendndodhjes se ngjarjes qe solli paraqitjen e kerkeses, duke treguar kufijte e mundshem te gabimit.

b) Kufijte e propozuar te zones qe inspektohet, te specifikuara ne nje harte dhe ne perputhje me paragrafet 2 dhe 3.

c) Shtetin Pale ose Shtetet Pale qe inspektohen ose te tregojte qe zona qe inspektohet ose nje pjese e saj eshte jashte juridiksionit ose kontrollit te ndonje Shteti.

d) Mjedisin e mundshem te ngjarjes qe solli paraqitjen e kerkese per inspektim.

e) Kohen e perafert te ngjarjes qe solli kerkesen duke treguar kufirin e mundshem te gabimit.

f) Te gjitha te dhenat mbi te cilat bazohet kërkesa.

g) Detajet personale te vëzhguesit te propozuar, nese ka ndonje.

h) Rezultatet e nje procesi konsultimi dhe sqarimi ne perputhje me nenin 4 ose nje shpjegim te arsyeve pse nje proces i tille nuk eshte kryer.

Mandati i inspektimit

Mandati per nje inspektim ne terren do te permbaje:

a) Vendimin e Keshillit Ekzekutiv rreth kerkeses per inspektim ne terren.

b) Emrin e Shtetit Pale ose Shteteve Pale qe do te inspektohen ose nje tregues qe zona qe do te inspektohet ose nje pjese e saj eshte jashte juridiksionit ose kontrollit te ndonje shteti.

c) Vendndodhjen dhe kufijte e zones qe inspektohet te specifikuar ne nje harte, duke marre parasysh te gjithë informacionin mbi te cilin u bazua kërkesa dhe te gjithë informacionin tjetër te vlefshëm teknik, ne konsultim me Shtetin Pale kerkues.

d) Tipet e planifikuara te aktivitetit te skuadres se inspektimit ne zonen qe inspektohet.

e) Piken e hyrjes qe do te perdoret nga skuadra e inspektimit.

f) Pikat tranzit ose pikat baze, nese shihet e arsyeshme.

g) Emrin e kreut te skuadres se inspektimit.

h) Emrat e anetareve te skuadres se inspektimit.

i) Emrin e vëzhguesit te propozuar, nese ka.

j) Listen e pajisjeve qe do te perdoren ne zonen qe inspektohet.

Nese nje vendim i dhene nga Keshilli Ekzekutiv ne pajtim me nenin 4 paragrafet 46 deri 49, ben te nevojshem nje ndryshim te mandatit te inspektimit, Drejtori i Pergjithshem mund ta rinovojë mandatin ne lidhje me nenparagrafet (d), (h), dhe (j), nese e sheh te pershtatshme. Drejtori i Pergjithshem do te njoftoje menjehere Shtetin Pale qe inspektohet lidhur me çdo ndryshim te tille.

Njoftimi per inspektim

43. Njoftimi i bere nga Drejtori i Pergjithshem ne pajtim me nenin 4, paragrafi 55, do te perfshije informacionin e meposhtem:

a) mandatin e inspektimit;

b) daten dhe kohen e parashikuar te mberritjes se skuadres se inspektimit ne piken e hyrjes;

c) mjetet per te shkuar ne piken e hyrjes;

d) nese shihet e arsyeshme, numurin e perhershëm te klirences diplomatike per fluturimet e paplanifikuara te avioneve;

e) nje liste te pajisjeve te cilat Drejtori i Pergjithshem ia kerkon Shtetit Pale qe inspektohet per ta vene ne dispozicion te skuadres se inspektimit per perdorim ne zonen qe inspektohet.

44. Shteti Pale qe inspektohet duhet te beje te ditur marrjen e njoftimit te bere nga Drejtori i Pergjithshem jo me vone se 12 ore pasi e ka marre ate.

D. Aktivitetet parainspektimit

Hyrja ne territorin e Shtetit Pale qe inspektohet, aktivitetet ne piken e hyrjes dhe transferimi per ne zonen e inspektimit

45. Shteti Pale qe inspektohet, i cili eshte njoftuar per mberritjen e skuadres se inspektimit, duhet te siguroje hyrjen e menjehershme te saj ne territorin e tij.

46. Kur perdoret nje avion i paplanifikuar per udhetimin per ne piken e hyrjes, Sekretariati Teknik do t'i jape Shtetit Pale, qe inspektohet nje plan fluturimi nepermjet autoritetit kombetar, per fluturimin e avionit nga aerodromi i fundit perpara hyrjes ne hapësirën ajrore te atij Shteti Pale per ne piken e hyrjes, jo me pak se gjashte ore perpara kohes se planifikuar te largimit nga ai aerodrom. Ky plan fluturimi do te perpilohet ne perputhje me procedurat e Organizates Nderkombetare te Aviacionit Civil te zbatueshme per aviacionin civil. Sekretariati Teknik do te perfshije ne seksionin e verejtjeve te planit te fluturimit numrin e perhershëm te klirences diplomatike dhe simbolet perkatese qe identifikojne avionin si avion inspektimi. Ne qofte se perdoret nje avion ushtarak, Sekretariati Teknik do te kerkoje autorizimin paraprak nga Shteti Pale qe inspektohet, per te hyre ne hapësirën e tij ajrore.

47. Jo me pak se tre ore perpara largimit te planifikuar te skuadres se inspektimit nga aerodromi i fundit para hyrjes ne hapësirën ajrore te Shtetit Pale qe inspektohet, ky i fundit duhet te siguroje se plani i fluturimit, i perpiluar ne pajtim me paragrafin 46, eshte aprovuar ne menyre te tille qe skuadra e inspektimit mund te arrije ne piken e hyrjes ne kohen e parashikuar te mberritjes.

48. Aty ku eshte e nevojshme, kreu i skuadres se inspektimit dhe perfaqesuesi i Shtetit Pale qe inspektohet do te bien dakord per piken baze dhe per planin e fluturimit nga pika e hyrjes per ne piken baze dhe, nese eshte e nevojshme, per ne zonen e inspektimit.

49. Shteti Pale qe inspektohet duhet te marre masat per parkimin, sigurimin, garantimin e sherbimeve dhe furnizimin me karburant, ne menyren e kerkuar nga Sekretariati Teknik per avionin e skuadres se inspektimit ne piken e hyrjes dhe, nese eshte e nevojshme, ne piken baze dhe ne zonen e inspektimit. Ky avion nuk do te jete eshte pergjegjes per taksen e uljes se avionit, taksen e largimit dhe detyrimeve te ngjashme. Ky paragraf do te aplikohet gjithashtu ndaj avioneve te perdorur per fluturimin ne hapësirën ajrore gjate inspektimit ne terren.

50. Mbeshtetur ne paragrafin 51, nuk do te vihen kufizime nga Shteti Pale qe inspektohet per skuadren e inspektimit ne lidhje me sjelljen ne territorin e tij te pajisjeve te aprovuara, qe jane ne pajtim me mandatin e inspektimit ose per perdorimin e tyre ne perputhje me dispozitat e Traktatit dhe te ketij protokolli.

51. Pa cenuar periudhen kohore te specifikuar ne paragrafin 54, Shteti Pale qe inspektohet do te kete te drejten te verifikojë ne piken e hyrjes, ne pranine e pjesëtareve te skuadres se inspektimit, faktin qe pajisja ka qene aprovuar dhe certifikuar ne perputhje me paragrafin 38. Shteti Pale qe inspektohet mund te mos ta lejojë pajisjen qe nuk eshte ne pajtim me mandatin e inspektimit ose qe nuk eshte aprovuar dhe certifikuar ne pajtim me paragrafin 38.

52. Menjehere pas mberritjes ne piken e hyrjes dhe pa cenuar periudhen kohore te specifikuar

ne paragrafin 54, kreu i skuadres se inspektimit do t'i paraqese perfaqesuesit te Shtetit Pale qe inspektohet mandatin e inspektimit, dhe nje plan fillestar inspektimi te pergatitur nga skuadra e inspektimit duke specifikuar aktivitetet qe do te kryhen nga skuadra. Perfaqesuesit e Shtetit Pale qe inspektohet duhet t'i japin udhezime te shkurtra skuadres se inspektimit dhe duhet t'i ndihmojne me harta dhe dokumente te tjera, nese shihet e pershtatshme. Udhezimet duhet te perfshijne karakteristikat perkatese te terrenit natyror, ceshtjet e sigurise dhe konfidencialitetit dhe parapergatitjet e logjistikes per inspektimin. Shteti Pale qe inspektohet mund te tregojë vendndodhjet brenda zones se inspektimit qe nuk kane lidhje me qellimin e inspektimit sipas tij.

53. Pas udhezimeve para inspektimit, skuadra e inspektimit, nese e shihet e arsyeshme, do te modifikojë planin fillestar te inspektimit duke marre parasysh komentet e bera nga Shteti Pale qe inspektohet. Plani i modifikuar i inspektimit do t'u vihet ne dispozicion perfaqesuesve te Shtetit Pale qe inspektohet.

54. Shteti Pale qe inspektohet duhet te beje gjithçka qe ka ne kompetencat e tij per te dhene asistence dhe per te siguruar aktivitetin e skuadres se inspektimit, pajisjen e miratuar qe specifikohet ne paragrafet 50 dhe 51 dhe te bagazheve nga pika e hyrjes per ne zonen qe inspektohet, jo me vone se 36 ore pas mberritjes ne piken e hyrjes, nese nuk eshte rene dakord per ndonje afat tjeter brenda periudhes kohore te percaktuar ne paragrafin 57.

55. Per te konfirmuar se zona per ne te cilen eshte transportuar skuadra e inspektimit i korrespondon zones se inspektimit, qe percaktohet ne mandatin e inspektimit, skuadra e inspektimit do te kete te drejten te perdore pajisjet e miratuara per percaktimin e vendndodhjeve. Shteti Pale qe inspektohet do te asistojë skuadren e inspektimit per kryerjen e kesaj detyre.

E. Kryerja e inspektimeve

Rregulla te pergjithshme

56. Skuadra e inspektimit do te ushtroje funksionet e saj ne perputhje me dispozitat e Traktatit dhe ketij protokolli.

57. Skuadra e inspektimit do te filloje aktivitetet e inspektimit ne zonen qe inspektohet sa me shpejt qe te jete e mundur, por ne çdo rast jo me vone se 72 ore pas mberritjes ne piken e hyrjes.

58. Aktivitetet e skuadres se inspektimit do te rregullohen ne menyre te tille qe te sigurohet ushtrimi ne kohe dhe ne menyre efektive i funksioneve te saj dhe me sa me pak probleme qe te jete e mundur per Shtetin Pale qe inspektohet dhe sa me pak shqetesime per zonen qe inspektohet.

59. Ne rastet ku Shteti Pale qe inspektohet i eshte kerkuar, ne pajtim me paragrafin 43 (e) ose gjate inspektimit, qe te vere ne dispozicion ndonje pajisje per t'u perdorur nga skuadra e inspektimit ne zonen qe inspektohet, shteti ne fjale duhet te veproje ne perputhje me kerkesen ne ate mase qe ai mundet.

60. Gjate inspektimit ne terren skuadra e inspektimit do te kete nder te tjera:

a) Te drejten te percaktojë se si do te kryhet inspektimi, ne perputhje me mandatin e inspektimit dhe duke marre parasysh çdo hap te ndermarre nga Shteti Pale qe inspektohet ne perputhje me kushtet e hyrjes.

b) Te drejten per te ndryshuar planin e inspektimit per te siguruar kryerjen efektive te inspektimit, nese eshte e nevojshme.

c) Detyrimin per te marre parasysh rekomandimet dhe modifikimet e sugjeruara nga Shteti Pale qe inspektohet ne planin e inspektimit.

d) Te drejten te kerkoje sqarime ne lidhje me paqartesite qe mund te dalin gjate inspektimit.

e) Detyrimin te perdore vetem teknikat qe specifikohen ne paragrafin 69 dhe per te mos kryer aktivitetet qe nuk kane lidhje me qellimin e inspektimit. Skuadra e inspektimit do te grumbulloje dhe dokumentoje ato fakte qe kane lidhje me qellimin e inspektimit, por nuk duhet te kerkoje dhe te dokumentoje informacione, qe ne menyre te qarte nuk kane lidhje me qellimin e inspektimit. Çdo material i grumbulluar dhe i gjetur me pas qe nuk ka lidhje duhet t'i kthehet Shtetit Pale qe inspektohet.

f) Detyrimin per te marre parasysh dhe per te perfshire ne raportin e saj te dhenat dhe shpjegimet mbi natyren e ngjarjes qe solli nevojën e kerkeses, te siguruara nga Shteti Pale qe inspektohet nga rrjetet kombetare monitoruese te Shtetit Pale qe inspektohet dhe nga burime te tjera.

g) Detyrimin per te pajisur Shtetin Pale qe inspektohet, bazuar ne kerkesen e tij, me kopjet e informacionit dhe te dhenave te grumbulluara ne zonen e inspektimit.

h) Detyrimin për të respektuar fshehtësinë, sigurinë dhe rregullat shëndetësore të Shtetit Pale që inspektohet.

61. Gjate inspektimit në terren Shteti Pale që inspektohet do të ketë ndër të tjera:

a) Të drejtën për t'i bërë rekomandime në çdo kohë skuadres së inspektimit në lidhje me ndryshimin e mundshëm të planit të inspektimit.

b) Të drejtën dhe detyrimin për të vënë në dispozicion një përfaqësues për të shërbyer si ndërlidhës me skuadrën e inspektimit;

c) Të drejtën për të pasur përfaqësues që shoqërojnë skuadrën e inspektimit gjatë kryerjes së detyrave të saj dhe për të vezhguar të gjithë aktivitetet e inspektimit që kryhen nga skuadra e inspektimit. Kjo nuk duhet të vonojë ose të pengojë skuadrën e inspektimit në ushtrimin e funksioneve të saj.

d) Të drejtën për të dhënë informacione shtese dhe për të kërkuar mbledhjen dhe dokumentimin e fakteve shtese që ai beson se kanë lidhje me inspektimin.

e) Të drejtën për të ekzaminuar të gjitha rezultatet fotografike, të matjeve dhe kampionet, si dhe të mbajë fotografite ose pjesë të tyre, që tregojnë vendet e ndjeshme që nuk kanë lidhje me qëllimin e inspektimit. Shteti Pale që inspektohet do të ketë të drejtën që të marrë kopjet duplikate të të gjitha produkteve fotografike dhe atyre të matjeve. Shteti Pale që inspektohet do të ketë të drejtën për të mbajtur origjinalet e fotografive dhe rezultateve fotografike të dorës së parë dhe për t'i vendosur fotografite ose pjesët e tyre brenda territorit të tij, të vulosura me një vule të perbashkët. Shteti Pale që inspektohet do të ketë të drejtën të ofrojë një operator për të filmuar dhe fotografuar, sipas kërkesës së skuadres i inspektimit. Në rast të kundërt, këto funksione do të kryhen nga pjestarët e skuadres së inspektimit.

f) Të drejtën për t'i dhënë skuadres e inspektimit, nga rrjetet e tij kombëtare të monitorimit dhe nga burime të tjera, të dhëna dhe spjegime mbi natyrën e ngjarjes që shkaktoi kërkesën për inspektim.

g) Detyrimin për t'i dhënë skuadres së inspektimit sqarime të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të zgjidhur dyshimet që dalin gjatë inspektimit.

Komunikimet

62. Pjestarët e skuadres së inspektimit do të kenë të drejtën në çdo kohë gjatë inspektimit në terren për të komunikuar me njeri-tjetrin dhe me Sekretariatin Teknik. Për këtë qëllim ato mund të përdorin pajisjet e tyre të aprovuara dhe të certifikuara në mënyrën e duhur, me miratimin e Shtetit Pale që inspektohet në atë masë që ky Shtet nuk i siguron mundësinë për të përdorur telekomunikacione të llojit tjetër.

Vezhguesi

63. Në pajtim me nenin 4, paragrafi 61, Shteti Pale kerkues duhet të bashkëpunojë me Sekretariatin Teknik për të koordinuar mbërritjen e vezhguesit në të njëjtën pikë të hyrjes ose pikë baze si skuadra e inspektimit brenda një periudhe të arsyeshme nga mbërritja e skuadres së inspektimit.

64. Vezhguesi do të ketë të drejtën gjatë gjithë inspektimit për të komunikuar me ambasaden e Shtetit Pale që kërkon inspektimin që ndodhet në territorin e Shtetit Pale që inspektohet ose, në rast të mungesës së një ambasade, do të komunikojë me Shtetin Pale kerkues.

65. Vezhguesi do të ketë të drejtën që të shkojë në zonën që inspektohet dhe për të hyrë e qëndruar brenda kësaj zone në mënyrën e garantuar nga Shteti Pale, që inspektohet.

66. Vezhguesi do të ketë të drejtën që t'i bëjë rekomandime skuadres së inspektimit gjatë gjithë kohës së inspektimit.

67. Gjatë gjithë inspektimit, skuadra e inspektimit do të informojë vezhguesin rreth ecurisë së inspektimit dhe rezultateve perkatese.

68. Gjatë gjithë inspektimit, Shteti Pale që inspektohet do të sigurojë ose rregullojë lehtësitë e nevojshme për vezhguesin, të ngjashme me ato që gezon skuadra e inspektimit sipas paragrafit 11. Të gjitha shpenzimet, në lidhje me qëndrimin e vezhguesit në territorin e Shtetit Pale që inspektohet, do të perballohen nga Shteti Pale kerkues.

Aktivitetet dhe Teknikat e Inspektimit

69. Mund të kryhen aktivitetet e mëposhtme të inspektimit dhe të përdoren teknikat, në përputhje me dispozitat mbi hyrjen e administruar, mbledhjen, trajtimin dhe analizimin e provave, dhe në lidhje me fluturimet inspektuese:

a) Gjetja e pozicionit nga ajri dhe mbi sipërfaqe që konfirmon kufijtë e zonës që inspektohet

dhe qe percakton koordinatat e vendndodhjeve, ne mbeshtetje te aktiviteve te inspektimit.

b) Vezhgimi vizual, nepermjet videove dhe fotografive statike dhe imazheve multi-spektral, perfshire matjet me rreze infra te kuqe, ne, nen siperfaqe dhe nga ajri per te kerkuar per anomalite ose kampione.

c) Matja e niveleve te radioaktivitetit mbi, ne dhe nen siperfaqen e tokes duke perdorur monitorimin e rrezatimit gama dhe analizat e shperberjes se energjise nga ajri dhe ne ose nen siperfaqen e tokes, per te kerkuar dhe identifikuar anomalite e rrezatimit.

d) Marrja e kampioneve nga mjedisi dhe analizimi i substancave te ngurta, lengjeve dhe gazeve siper, ne dhe nen siperfaqen per te zbuluar anomalite.

e) Monitorimi pasiv sizmiologjik per pasgoditjet per te lokalizuar zonen qe kerkohet dhe per te lehtesuar percaktimin e natyres se nje ngjarjeje.

f) Vezhgimet e rezonances sizmike dhe aktiviteve sizmike per te kerkuar dhe lokalizuar anomalite nentokesore, duke perfshire zonat me gropa dhe me material shkembor.

g) Hartimi i fushes magnetike dhe gravitacionale, futja ne toke e pajisjeve radiolokatore dhe perdorimi i matesve te perezellshmerise elektrike ne siperfaqe dhe nga ajri, nese shihet e pershtatshme, per te zbuluar anomalite dhe kampionet.

h) Shpimet me sonde per te marre kampione radioaktive.

70. Deri ne 25 dite pas aprovimit te inspektimit ne terren ne perputhje me nenin 4 paragrafi 46, skuadra e inspektimit do te kete te drejten te kryeje çdonje prej aktiviteve dhe te perdore çdonje nga teknikat qe listohen ne paragrafin 69 (a) deri (e). Duke pasuar aprovimin e vazhimit te inspektimit ne perputhje me nenin 4 paragrafi 47, skuadra e inspektimit do te kete te drejten te ushtroje çdo aktivitetet dhe te perdore çdonje nga teknikat qe listohen ne paragrafin 69 (a) deri (e). Skuadra e inspektimit do te kete te drejten te kryeje vetem marrjen e kampioneve me sonde pas aprovimit te Keshillit Ekzekutiv ne perputhje me nenin 4 paragrafi 48. Nese skuadra e inspektimit kerkon nje zgjatje te afatit te inspektimit ne perputhje me nenin 4, paragrafi 49, ajo do te tregojte ne kerkesen e saj se cili nga aktivitetet apo teknikat qe listohen ne paragrafin 69 synon qe te kryeje per te permbushur mandatin e saj.

Fluturimet per inspektim

71. Skuadra e inspektimit do te kete te drejten per te kryer nje fluturim perreth zones qe inspektohet gjate inspektimit ne terren, me qellim qe t'i jepet skuadres se inspektimit nje orientim i pergjithshem per zonen qe inspektohet, duke ngushtuar dhe precizuar vendndodhjen e inspektimit qe kryhet ne toke dhe per te lehtesuar grumbullimin e provave faktike, duke perdorur pajisjet qe specifikohen ne paragrafin 79.

72. Fluturimet per inspektim do te kryhen sa me shpejt te jete e mundur praktikisht. Kohezgjatja e pergjithshme e ketyre fluturimeve perreth zones qe inspektohet nuk do te jete me teper se 12 ore.

73. Fluturimet shpesh, qe perdorin pajisjet qe specifikohen ne paragrafet 79 dhe 80, mund t'i nenshtrohen miratimit te Shtetit Pale qe inspektohet.

74. Zona mbi te cilen do te fluturohet nuk do te kete shtrirje me te madhe se zona qe inspektohet.

75. Shteti Pale qe inspektohet do te kete te drejten te vendose kufizime ose, ne rastet perjashtuese dhe me justifikim te arsyeshem, te ndaloje fluturimet per inspektim per zonat e ndjeshme qe nuk kane lidhje me qellimin e inspektimit. Kufizimet mund te lidhen me lartesine e fluturimit, numrin e kalimeve dhe xhirove, kohezgjatjen e qendrimit ne ajer, tipin e avionit, numrin e inspektoreve ne bord dhe tipin e matjeve ose vrojtimeve. Nese skuadra e inspektimit vlereson se kufizimet ose ndalimet e fluturimeve per inspektim rreth zonave te ndjeshme mund te pengojne permbushjen e mandatit te saj, Shteti Pale qe inspektohet duhet te beje çdo perpjekje te arsyeshme per te siguruar menyra alternative inspektimi.

76. Fluturimet per inspektim duhet te kryhen sipas nje plani fluturimi te perpiluar ne menyren e duhur dhe te aprovuar ne pajtim me rregullat e aviacionit te Shtetit Pale qe inspektohet. Rregullat e sigurise se fluturimit te Shtetit Pale qe inspektohet duhet te respektohen rreptesisht gjate gjithë operacioneve te fluturimit.

77. Gjate fluturimeve per inspektim ulja ne toke e avionit duhet te autorizohet vetem per qellime qendrimi ose furnizimi me karburant.

78. Fluturimet per inspektim duhet te kryhen ne lartesine qe kerkohen nga skuadra e

inspektimit ne perputhje me aktivitetet qe duhet te kryhen, kushtet e qartesise se atmosferes, si dhe rregullat e aviacionit dhe te sigurise se Shtetit Pale qe inspektohet dhe se drejtes se tij per te mbrojtur informacionin e rendesishem qe nuk ka lidhje me qellimet e inspektimit. Fluturimet do te kryhen deri ne nje maksimum lartesis prej 1500 metra mbi siperfaqen e tokes.

79. Per fluturimet qe kryhen sipas paragrafeve 71 dhe 72, ne bordin e avionit mund te perdoren pajisjet e meposhtme:

- a) dylbi;
- b) pajisje per lokalizimin pasiv të vendit;
- c) video kamerat;
- d) aparate fotografike portative.

80. Per çdo fluturim shtese qe kryhet sipas paragrafit 73, inspektoret ne bordin e avionit mund te perdorin gjithashtu pajisje portative, qe instalohen me lehtësi per te realizuar:

- a) imazherine multi-spektrale (perfshire ate infra te kuqe);
- b) spektroskopine gama;
- c) kartografine e fushes magnetike.

81. Fluturimet per inspektim duhet te kryhen me nje avion me shpejtesi relativisht te vogel me krahe fikse ose te rrotullueshme. Avioni duhet te jape nje pamje te gjere e te papenguar te siperfaqes poshte.

82. Shteti Pale qe inspektohet do te kete te drejten te ofroje avionin e vet, te pajisur me pare ne menyren e pershtatshme sipas kerkesave teknike te manualit perkates operacional, si dhe me ekuipazh. Perndryshe, avioni do te sigurohet nga Sekretariati Teknik.

83. Nese avioni sigurohet ose merret me qira nga Sekretariati Teknik, Shteti Pale qe inspektohet do te kete te drejten te kontrolloje avionin per t'u siguruar nese ai eshte i pajisur me pajisjet e miratuara per inspektim. Nje kontroll i tille do te kryhet brenda kohes qe specifikohet ne paragrafin 57.

84. Personeli ne bordin e avionit do te perbehet nga:

- a) numri minimal i ekuipazhit te fluturimit qe lidhet me funksionimin e sigurt te avionit;
- b) deri ne kater anetare te skuadres se inspektimit;
- c) deri ne dy perfaqesuese te Shtetit Pale qe inspektohet;
- d) nje vezhgues, nese ka, duke pasur praninë e Shtetit Pale qe inspektohet;
- e) nje perkthyes, nese eshte e nevojshme.

85. Procedurat per zbatimin e fluturimeve do te shtjellohen me hollesi ne Manualin Operacional per Inspektimet ne Terren.

Hyrja e administruar

86. Skuadra e inspektimit do te kete te drejten qe te hyje ne zonen e inspektimit ne perputhje me dispozitat e Traktatit dhe te ketij protokolli.

87. Skuadra e inspektimit do te siguroje hyrjen brenda zones se inspektimit ne perputhje me periudhen kohore qe percaktohet ne paragrafin 57.

88. Ne pajtim me nenin 4, paragrafi 57 dhe paragrafi 86 te mesiperm, te drejtat dhe detyrimet e Shtetit Pale do te perfshijne:

a) te drejten per te marre masa per te mbrojtur instalimet dhe vendet e ndjeshme ne perputhje me kete protokoll;

b) detyrimin, kur hyrja kufizohet brenda zones se inspektimit, per te bere te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te plotesuar kerkesat e mandatit te inspektimit nepermjet menyrave alternative. Zgjidhja e çeshtjeve qe kane te bejne me nje ose me teper aspekte te inspektimit nuk duhet te vonoje ose nderhyje ne ecurine e skuadres se inspektimit me aspekte te tjera te inspektimit;

c) te drejten per te dhene vendimin perfundimtar lidhur me çdo hyrje te skuadres se inspektimit, duke marre parasysh detyrimet e tij ne kuadrin e ketij Traktati dhe dispozitat mbi hyrjen e administruar.

89. Ne pajtim me neni 4, paragrafet 57 (b) dhe 88 (a) me lart, Shteti Pale qe inspektohet do te kete te drejten gjate gjithe zones se inspektimit qe te marre masat per te mbrojtur instalimet dhe vendet e ndjeshme dhe per te parandaluar zbulimin e informacionit sekret qe nuk ka lidhje me qellimin e inspektimit. Keto masa mund te perfshijne nder te tjera:

- a) fshehjen e paneleve te afishimit te te dhenave, depove dhe pajisjeve te ndjeshme;
- b) kufizimin e matjeve te aktivitetit te radio-berthamave dhe te rrezatimit berthamor, per te

percaktuar pranine ose mungesen e tipeve dhe energjive te rrezatimit qe kane lidhje me qellimin e inspektimit;

c) kufizimin ne marrjen ose analizimin e kampioneve, per te percaktuar pranine ose mungesen e produkteve radioaktive, ose te produkteve te tjera qe kane lidhje me qellimin e inspektimit;

d) rregullimin e hyrjes te ndertesat dhe strukturat e tjera ne pajtim me paragrafet 90 dhe 91;

e) deklarimin e vendeve me hyrje te kufizuar ne perputhje me paragrafet 92 deri 96.

90. Hyrja ne ndertesat dhe strukturat e tjera do te shtyhet deri pas miratimit te vazhdimet te inspektimeve ne terren ne pajtim me nenin 4, paragrafi 47, me perjashtim te hyrjes ne ndertesat dhe strukturat e tjera qe perbejne hyrjen e nje miniere, germime te tjera ose shpella qe kane volum te madh tek te cilat nuk lejohet ndryshe hyrja. Per keto ndertesat dhe struktura skuadra e inspektimit do te kete te drejten vetem te kalimit transit, nen drejtimin e Shtetit Pale qe inspektohet me qellim per te hyre ne keto miniera, shpella ose germime te tjera.

91. Nese, pas miratimit te vazhdimet te inspektimit ne pajtim me nenin 4, paragrafi 47, skuadra e inspektimit deshmon ne menyre te besueshme ndaj Shtetit Pale qe inspektohet se hyrja ne ndertesat dhe strukturat e tjera eshte e nevojshme per permbushjen e mandatit te inspektimit dhe se aktivitetet e nevojshme te autorizuar ne mandat nuk do te kryhen jashte kesaj zone, skuadra e inspektimit do te kete te drejten te hyje ne keto ndertesat dhe struktura. Kreu i skuadres se inspektimit do te kerkoje hyrjen ne nje ndertese ose strukture te vecante duke treguar qellimin e kesaj hyrjeje, numrin e sakte te inspektoreve, si dhe aktivitetet qe synohen te kryhen. Modalitetet e hyrjes do t'i nenshtrohen negociatave ndermjet skuadres se inspektimit dhe Shtetit Pale qe inspektohet. Ky i fundit do te kete te drejten te vendose kufizimet ose, ne raste perjashtimore dhe me justifikim te arsyeshem, masa penguese per hyrjen ne ndertesat dhe strukturat e tjera.

92. Kur vendet me hyrje te kufizuar deklarohen sipas paragrafit 89 (e), secili nga keto vende nuk do te jete me i madh se 4 km². Shteti Pale qe inspektohet ka te drejten te deklaroje zonat me hyrje te kufizuar me nje shtrirje deri ne 50 km². Nese deklarohet me shume se nje vend me hyrje te kufizuar, çdo vend i tille do te ndahet nga vendi tjetër me ane te nje distance minimale prej 20 metrash. Çdo vend me hyrje te kufizuar duhet t'i kete kufijte te percaktuar qarte dhe ku te jete e mundur hyrja.

93. Madhesia, vendndodhja dhe kufizimi i vendeve me hyrje te kufizuar do t'i paraqitet kreut te skuadres se inspektimit jo me vone se koha qe i duhet skuadres se inspektimit per te hyre ne truallin qe permban te gjithë ose pjese te nje vendi te tille.

94. Skuadra e inspektimit do te kete te drejten te vendose pajisje dhe te marre hapa te tjere te nevojshem per te kryer inspektimin deri ne kufijte e vendit me hyrje te kufizuar.

95. Skuadra e inspektimit do te lejohet te vezhgoje me sy te gjitha vendet e hapura brenda zones me hyrje te kufizuar nga kufijte e kesaj zone.

96. Skuadra e inspektimit do te beje çdo perpjekje te arsyeshme per te permbushur mandatin e inspektimit jashte zones me hyrje te kufizuar perpara se te kerkoje hyrjen ne keto vende. Nese skuadra e inspektimit deshmon, ne çdo kohe ne menyre te besueshme ndaj Shtetit Pale qe inspektohet se aktivitetet e nevojshme qe autorizohen ne mandat nuk mund te kryhen jashte kesaj zone dhe qe hyrja ne kete zone me hyrje te kufizuar eshte e nevojshme per te permbushur mandatin, disa prej pjesëtareve te skuadres se inspektimit do t'u garantohet hyrja per te plotesuar detyrat specifike brenda kesaj zone. Shteti Pale qe inspektohet do te kete te drejten te fshehe ose te mbroje pajisjet, objektet dhe materialet e ndjeshme qe nuk kane lidhje me qellimin e inspektimit. Numri i inspektoreve do te mbahet ne nje minimum te nevojshem per te plotesuar detyrat qe lidhen me inspektimin. Modalitetet per hyrjen do t'i nenshtrohen negociatave midis skuadres se inspektimit dhe Shtetit Pale qe inspektohet.

Mbledhja, trajtimi dhe analizimi i kampioneve

97. Mbledhjet ne paragrafet 86 deri 96 dhe 98 deri 100, skuadra e inspektimit do te kete te drejten te mbledhe dhe te largoje kampionet e marrë nga zona qe inspektohet.

98. Kurdohere qe te jete e mundur, skuadra e inspektimit do te analizoje kampionet ne terren. Perfaqesuesit e Shtetit Pale qe inspektohet do te kene te drejten te jene te pranishem kur kampionet te analizohen ne terren. Me kerkesen e skuadres se inspektimit dhe ne perputhje me procedurat e rena dakord, Shteti Pale qe inspektohet do te jape asistencë per analizimin e kampioneve ne terren. Skuadra e inspektimit do te kete te drejten te transferoje kampionet per analiza ne laboratorët e caktuar nga Organizata vetem nese ajo verteton se analizat e nevojshme te kampionit nuk mund te kryhen ne terren.

99. Shteti Pale që inspektohet do të ketë të drejtën për të mbajtur pjesë nga të gjithë kampionet e grumbulluar, pasi ato të jenë analizuar, dhe mund të marrë kampione duplikate.

100. Shteti Pale që inspektohet do të ketë të drejtën të kërkojë që kampionet e përdorur ose pjesët të tyre t'i rikthehen.

101. Laboratorët e caktuar do të kryejnë analizat kimike dhe fizike të kampioneve të transferuar jashtë zonës së marrjes për analizë laboratorike. Hollesitë e ketyre analizave do të shtjellohen në Manualin Operacional për Inspektimet në Terren.

102. Drejtori i Përgjithshëm do të ketë përgjegjësinë kryesore për sigurimin, integritetin dhe ruajtjen e kampioneve dhe për të garantuar që është i mbrojtur konfidencialiteti i kampioneve që transferohen për analizë jashtë vendit ku merren. Drejtori i Përgjithshëm do të bëjë këtë në përputhje me procedurat që përmbahen në Manualin Operacional për Inspektimet në Terren. Drejtori i Përgjithshëm në ndonjë rast do të:

a) Krijojë një regjim të rreptë që do të rregullojë mbledhjen, trajtimin, transportimin, dhe analizimin e kampioneve.

b) Certifikojë laboratorët e caktuar për të kryer tipet e ndryshme të analizave.

c) Mbikëqyrë standardizimin e pajisjeve dhe procedurave në këto laboratore të caktuara dhe të pajisjeve dhe procedurave të levizshme analitike.

d) Monitorojë kontrollin e cilësive dhe standardet e përgjithshme në lidhje me certifikimin e ketyre laboratoreve dhe në lidhje me procedurat dhe pajisjet e levizshme.

e) Zgjedhë ndërmjet laboratoreve të caktuara ato të cilët do të kryejnë funksionet analitike ose funksionet e tjera në lidhje me kerkime specifike.

103. Kur analizat duhet të kryhen jashtë terrenit, kampionet duhet të analizohen në të paktën dy laboratore të caktuara. Sekretariati Teknik do të sigurojë përpunimin e shpejtë të analizave. Sekretariati Teknik do të kujdeset për kampionet dhe kampionet e përdorur ose pjesët e tyre do t'i kthehen Sekretariatit Teknik.

104. Sekretariati Teknik do të përpilojë rezultatet e analizave laboratorike të kampioneve që lidhen me qëllimin e inspektimit. Sipas nenit 4, paragrafi 63, Drejtori i Përgjithshëm do t'i transmetojë këto rezultate menjëherë për komente Shtetit Pale që inspektohet dhe me pas Keshillit Ekzekutiv dhe të gjitha Shteteve të tjera Pale. Sekretariati do të përfshijë në këto rezultate informacionin e detajuar që ka të bëjë pajisjet dhe metodologjinë e përdorur nga laboratorët e caktuar.

Kryerja e Inspektimit në Zonat jashtë Juridiksionit ose Kontrollit të ndonjë Shteti

105. Në rastin e një inspektimi në një zonë jashtë juridiksionit ose kontrollit të ndonjë Shteti, Drejtori i Përgjithshëm do të konsultohet me Shtetet Pale përkatëse dhe do të bëjë dakord për pikat transit ose pikat baze që do të lehtësojnë mbërritjen e shpejtë të skuadrës së inspektimit në zonën që do të inspektohet.

106. Shtetet Pale, në territorin e të cilëve ndodhen pikat transit ose pikat baze, do të ndihmojnë sa më shumë të jete e mundur në lehtësimin e inspektimit, duke përfshirë transportimin e skuadrës së inspektimit, bagazhit dhe pajisjeve të saj për në zonën që inspektohet, si edhe sigurimin e lehtësive përkatëse që specifikohen në paragrafin 11. Organizata do të rimbursojë Shtetet Pale që ndihmojnë për të gjitha shpenzimet përkatëse.

107. Mbeshtetur në aprovimin e Keshillit Ekzekutiv, Drejtori i Përgjithshëm mund të negociojë rregullat e përhershme me Shtetet Pale për të lehtësuar asistencën në rastin e një inspektimi në terren në një zonë jashtë juridiksionit ose kontrollit të ndonjë Shteti.

108. Në rastet kur një ose më tepër Shtet Pale, kanë kryer kerkime rreth një ngjarje të dyshimte në një zonë jashtë juridiksionit ose kontrollit të ndonjë Shteti përpara se të jete bërë kërkesa për inspektim në terren në atë zonë, rezultatet e këtij kerkimi do të merren parasysh nga Keshilli Ekzekutiv në shqyrtimet e tij në pajtim me nenin 4.

Procedurat pas inspektimit

109. Pas përfundimit të inspektimit, skuadra e inspektimit do të takohet me përfaqësuesin e Shtetit Pale që inspektohet për të rishikuar përfundimet paraprake të skuadrës së inspektimit dhe për të saktësuar çdo paqartësi. Skuadra e inspektimit do t'i japë përfaqësuesit të Shtetit Pale që inspektohet përfundimet e saj paraprake në formë shkresore sipas një formati të standardizuar, së bashku me një listë të kampioneve dhe materialeve të tjera të marra nga zona që inspektohet në pajtim me paragrafin 98. Dokumenti do të nënshkruhet nga kreu i skuadrës së inspektimit. Me qëllimin për të vërtetuar se ai ose ajo ka marrë njoftim për përmbajtjen e dokumentit, përfaqësuesi i Shtetit Pale që inspektohet do të

kunderfirmoje dokumentin. Takimi duhet te realizohet jo me vone se 24 ore pas perfundimit te inspektimit.

Largimi

110. Me plotesimin e procedurave te pasinspektimit, skuadra e inspektimit dhe vezhguesi duhet te largohen, sa me pare te jete e mundur, nga territori i Shtetit Pale qe inspektohet. Ky i fundit do te beje gjithçka qe ka ne kompetencat e tij per te dhene asistencen dhe per te siguruar drejtimin e sigurt te skuadres se inspektimit, pajisjeve dhe bagazhit te saj per ne piken e daljes. Me perjashtim te rasteve kur vendoset ndryshe nga Shteti Pale qe inspektohet dhe nga skuadra e inspektimit, pika e daljes qe perdoret do te jete ajo qe sherben edhe si pike hyrje.

PJESA III

MASAT E KRIJIMIT TË BESUESHMËRISË

1. Ne pajtim me nenin 4, paragrafi 68 cdo Shtet Pale duhet te njoftoje vullnetarisht Sekretariatit Teknik per çdo shperthim kimik ekuivalent me shperthimin e 300 ton ose me teper TNT - te marre si nje shperthim i vetem ne nje pjese te territorit e tij ose ne ndonje vend qe eshte nen juridiksionin ose kontrollin e Shtetit Pale. Nese eshte e mundur, ky njoftim do te jepet paraprakisht. Njoftimi duhet te perfshije hollesite mbi vendndodhjen, kohen, sasine dhe tipin e eksplozivit te perdorur, ashtu si edhe mbi formen dhe qellimin e parashikuar te shperthimit.

2. Sa me shpejt te jete e mundur pas hyrjes ne fuqi te ketij Traktati, çdo Shtet Pale duhet t'i jape vullnetarisht Sekretariatit Teknik informacionin qe lidhet me perdorimin kombetar nga ana e tij te te gjitha shperthimeve kimike me te medha se ekuivalenti prej 300 ton TNT dhe ne intervalet vjetore te mevonshme do ta rinovoje kete informacion. Ne veçanti, Shteti Pale duhet te perpiqet te jape informacion per:

- a) vendndodhjet gjeografike te vendeve ku kane ndodhur shperthimet;
 - b) Natyren e aktiviteve ne kuadrin e te cilave jane kryer shperthimet, si dhe profilin e pergjithshem dhe frekuencen e ketyre shperthimeve;
 - c) çdo hollesi tjeter qe disponohet dhe qe ka lidhje me te; dhe
- Ai perpiqet gjithashtu te ndihmoje Sekretariatit Teknik ne sqarimin e origjinave te ketyre ngjarjeve te zbuluara nga Sistemi Nderkombetar Monitorues.

3. Nje Shtet Pale mund te ftoje, mbi baza vullnetare dhe reciprokisht te pranueshme, perfaqesuesit e Sekretariatit Teknik ose te Shteteve te tjera Pale per te vizituar vendet brenda territorit te tij siç permendet ne paragrafet 1 dhe 2.

4. Me qellim per te kalibruar Sistemin Nderkombetar Monitorues, Shtetet Pale mund te bashkeveprojne me Sekretariatit Teknik, per te kryer shperthime kimike te kalibruara ose per te dhene informacion mbi shperthimet kimike te planifikuara per qellime te tjera.

SHTOJCA I E PROTOKOLLIT

Tabela: Lista e stacioneve sizmike qe perfshihen ne rrjetin kryesor 1- A

Shteti pergjegjes per stacionin	Vendndodhja	Gjeresia gjeografike.	Gjatesia gjeografike.	Tipi
Argjentina	PLCA Paso Flores	40.7 S (Jug)	70.6 W (Perendim)	3-C
Australia	WRA Warramunga, NT	19.9 S	134,3 E (Lindje)	vektori
Australia	ASAR Alice Springs, NT	23.7 S	133.9 E	vektori
Australia	STKA Stephens Creek, SA	31.9 S	141.6 E	3-C
Australia	MAW Mawson, Antarctica	67.6 S	62.9 E	3-C
Bolivia	LPAZ La Paz	16.3 S	68.1 E	3-C
Brazili	BDFB Brasilia	15.6 S	48.0 E	3-C
Kanadaja	ULMC Lac du Bonnet, Man	50.2 N	95.9 E	3-C
Kanadaja	YKAC Yellowknife, N.W.T.	62.5 N	114.6 W	vektori
Kanadaja	SCH Schefferville, Quebec	54.8 N	66.8 W	3-C
Republika e Afrikes Qendrore	BGCA Bangui	05.2 N	18.4 E	3-C
Kina	HAI Hailar	49.3 N	119.7 E	3-C > vektori
Kina	LZH Lanzhou	36.1 N	103.8 E	3-C > vektori
Kolumbia	XSA El Rosal	04.9 N	74.3 W	3-C/TR >
Bregu i Fildishte	DBIC Dimbroko	06.7 N	04.9 W	3-C
Egjipti	LXEG Luxor	26.0 N	33.0 E	vektori
Finlanda	FINES Lahti	61.4 N	28.1 E	vektori
Franca	PPT Tahiti	17.6 S	149.6 W	3-C
Gjermania	GEC2 Freyung	48.9 N	13.7 E	vektori
I papercaktuar	I papercaktuar	I papercak- tuar	I papercak- tuar	I papercak- tuar
Irani (Rep. Islamike e)	THR Tehran	35.8 N	51.4 E	3-C
Japonia	MJAR Matsushiro	36.5 N	138.2 E	vektori
Kazakistani	MAK Makanchi	46.8 N	82.0 E	vektori

Kenia	KMBO Kilimambogo	01.1 S	37.2 E	3-C
Mongolia	JAVM Javhlant	48.0 N	106.8 E	3-C > vektori
Niger	New Site	Per t'u vendosur	Per t'u vendosur	Per t'u vendo
Norvegjia	NAO Hamar	06.8 N	10.8 E	vektori
Norvegjia	ARAO Karasjok	69.5 N	25.5 E	vektori
Pakistani	PRPK Pari	33.7 N	73.3 E	vektori
Paraguai	CPUP Villa Florida	26.3 S	57.3 W	3-C
Republika e Korese	KSRS Wonju	37.5 N	127.9 E	vektori
Federata Ruse	KBZ Khabaz	43.7 N	42.9 E	3-C
Federata Ruse	ZAL Zalesovo	53.9 N	84.8 E	3-C > vektori
Federata Ruse	NRI Norilsk	69.0 N	88.0 E	3-C
Federata Ruse	PDY Peleduy	59.6 N	112.6 E	3-C > vektori
Federata Ruse	PET Petropavlovsk Kamchatskiy	53.1 N	157.8 E	3-C > vektori
Federata Ruse	USK Ussuriysk	44.2 N	132.0 E	3-C > vektori
Arabia Saudite	New Site	Per t'u vendosur	Per t'u vendosur	vektori
Afrika e Jugut	BOSA Boshof	28.6 S	25.6 E	3-C
Spanja	ESD Sonseca	39.7 N	04.0 W	vektori
Tailanda	CMTO Chiang Mai	18.8 N	99.0 E	vektori
Tunizia	THA Thala	35.6 N	08.7 E	3-C
Turqia	BRTR Belbashi Shigjeta per t'u ri- vendosur ne Keskin	39.9 N	32.8 E	vektori
Turkmenistani	GEYT Alibeck	37.9 N	58.1 E	vektori
Ukraina	AKASG Malin	50.4 N	29.1 E	vektori
SH.B.A.	LJTX Lajitas, TX	29.3 N	103.7 W	vektori
SH.B.A.	MNV Mina, NV	38.4 N	118.2 W	vektori
SH.B.A.	PIWY Pinedale, WY	42.8 N	109.6 W	vektori

SH.B.A.	ELAK Eielson, AK	64.8 N	146.9 W	vektori
SH.B.A.	VNDA Vanda, Antarctica	77.5 S	161.9 E	3-C

Çelesi:

3-C > vektori: tregon se vendi mund te filloje funksionimin ne Sistemin Nderkombetar Monitoruesi si nje stacion me 3 komponente dhe mund te permiresohet ne nje kohe te mevonshme.

Tabela : Lista e stacioneve sizmologjike qe perfshijne rrjetin ndihmes 1-B

#	Shteti pergjegjes per stacionin	Vendndodhja	Gjeresia gjeogr.	Gjatesia gjeogr.	Tipi
1	Argjentina	CFA Coronel Fontana	31.6 S	68.2 W	3-C
2	Argjentina	USHA Ushuaia	55.0 S	68.0 W	3-C
3	Armenia	GNI Gorni	40.1 N	44.7 E	3-C
4	Australia	CTA Charters Towers, QLD	20.1 S	146.3 E	3-C
5	Australia	FITZ Fitzroy Crossing, WA	18.1 S	125.6 E	3-C
6	Australia	NWAO Narrogin, WA	32.9 S	117.2 E	3-C
7	Bangladeshi	CHT Chittagong	22.4 N	91.8 E	3-C
8	Bolivia	SIV San Ignacio	16.0 S	61.1 W	3-C
9	Botsvana	LBTB Lobatse	25.0 S	25.6 E	3-C
10	Brazili	PTGA Pitinga	0.7 S	60.0 W	3-C
11	Brazili	RGNB Rio Grande do Norte	6.9 S	37.0 W	3-C
12	Kanadaja	FRB Iqaluit, N.W.T.	63.7 N	68.5 W	3-C
13	Kanadaja	DLBC Dease Lake, B.C.	58.4 N	130.0 W	3-C
14	Kanadaja	SADO Sadowa, Ont.	44.8 N	79.1 W	3-C
15	Kanadaja	BBB Bella Bella, B.C.	52.2 N	128.1 W	3-C
16	Kanadaja	MBC Mould Bay, N.W.T.	76.2 N	119.4 W	3-C
17	Kanadaja	INK Inuvik, N.W.T.	68.3 N	133.5 W	3-C
18	Kili	RPN Easter Island	27.2 S	109.4 W	3-C
19	Kili	LVC Limon Verde	22.6 S	68.9 W	3-C
20	Kina	BJT Baijiatuan	40.0 N	116.2 E	3-C
21	Kina	KMI	25.2 N	102.8 E	3-C

		Kunming			
22	Kina	SSE Sheshan	31.1 N	121.2 E	3-C
23	Kina	XAN Xi'an	34.0 N	108.9 E	3-C
24	Ishujt Kuk	RAR Rarotonga	21.2 S	159.8 W	3-C
25	Kosta Rika	JTS Las Juntas de Abangares	10.3 N	85.0 W	3-C
26	Republika Ceke	VRAC Vranov	49.3 N	16.6 E	3-C
27	Danimarka	SFJ Sondre Stromfjord. Greenland	67.0 N	50.6 W	3-C
28	Xhibuti (Djibuti)	ATD Arta Tunnel	11.5 N	42.9 E	3-C
29	Egjipti	KEG Kottamya	29.9 N	31.8 E	3-C
30	Etiopia	FURI Furi	8.9 N	38.7 E	3-C
31	Fixhi	MSVF Monasavu, Viti Levu	17.8 S	178.1 E	3-C
32	Franca	NOUC Port Laguerre, New Caledonia	22.1 S	166.3 E	3-C
33	Franca	KOG Kourou, Gujana Franceze	5.2 N	52.7 W	3-C
34	Gaboni	BAMB Bambay	1.7 S	13.6 E	3-C
35	Gjermani/Afrika e Jugut	--- SANAE Station, Antartica	71.7 S	2.9 W	3-C
36	Greqia	IDI Anogia, Krete	35.3 N	24.9 E	3-C
37	Guatemala	RDG Rabir	15.0 N	90.5 W	3-C
38	Islanda	BORG Borgames	64.8 N	21.3 W	3-C
39	Per t'u vendosur	Per t'u vendosur	Per t'u vendosu	Per t'u vendosu	Per t'u vendo
40	Indonezia	PACI Cibinong, Jawa Barat	6.5 S	107.0 E	3-C
41	Indonezia	JAY Jayapura, Irian Jaya	2.5 S	140.7 E	3-C
42	Indonezia	SWI Sorong, Irian Jaya	0.9 S	131.3 E	3-C
43	Indonezia	PSI Parapat, Sumatera	2.7 N	98.9 E	3-C
44	Indonezia	KAPI Kappang, Sulawesi Selatan	5.0 S	119.8 E	3-C
45	Indonezia	KUG Kupang, Nusatenggara, Timur	10.2 S	123.6 E	3-C
46	Iran (Republika islamike e)	KRM Kerman	30.3 N	57.1 E	3-C
47	Iran (Republika islamike e)	MSN Masjed-e-Soleyman	31.9 N	49.3 E	3-C

48	Izraeli	MBH Eilath	29.8 N	34.9 E	3-C
49	Izraeli	PARD Parod	32.6 N	35.3 E	vektor i
50	Italia	ENAS Enna, Sicili	37.5 N	14.3 E	3-C
51	Japonia	JNU Ohita, Kyushu	33.1 N	130.9 E	3-C
52	Japonia	JOW Kunigami, Okinawa	26.8 N	128.3 E	3-C
53	Japonia	JHJ Hachijojima, Ishujt Izu	33.1 N	139.8 E	3-C
54	Japonia	JKA Kamikawa-asahi, Hokkaido	44.1 N	142.2 E	3-C
55	Japonia	CJC Chichijima, Ogasawara	27.1 N	142.2 E	3-C
56	Jordania	--- Ashqof	32.5 N	37.6 E	3-C
57	Kazakistani	BRVK Borovoye	53.1 N	70.3 E	vektor i
58	Kazakistani	KURK Kurchatov	50.7 N	78.6 E	vektor i
59	Kazakistani	AKTO Aktyubinsk	50.4 N	58.0 E	3-C
60	Kirgistani	AAK Ala- Archa	42.6 N	74.5 E	3-C
61	Madagaskari	TAN Antananarivo	18.9 S	47.6 E	3-C
62	Mali	KOWA Kowa	14.5 N	4.0 W	3-C
63	Meksiko	TEYM Tepich, Yucatan	20.2 N	88.3 W	3-C
64	Meksiko	TUVM Tuzandepeti, Veracruz	18.0 N	94.4 W	3-C
65	Meksiko	LPBM La Paz, Baja Kaliforni Sur	24.2 N	110.2 W	3-C
66	Maroku	MDT Midelt	32.8 N	4.6 W	3-C
67	Namibia	TSUM Tsumeb	19.1 S	17.4 E	3-C
68	Nepali	EVN Everest	28.0 N	86.8 E	3-C
69	Zelanda e Re	EWZ Erewhon, Ishulli Jugor	43.5 S	170.9 E	3-C
70	Zelanda e Re	RAO Ishulli Raoul	29.2 S	177.9 W	3-C
71	Zelanda e Re	UPZ Urewera, Ishulli Verior	38.3 S	177.1 E	3-C
72	Norvegjia	SPITS Spitsbergen	78.2 N	16.4 E	vektor i
73	Norvegjia	JMI Jan Mayen	70.9 N	8.7 W	3-C
74	Omani	WSAR Wadi Sarin	23.0 N	58.0 E	3-C

75	Papua Guinea e Re	PMG Port Moresbi	9.4 S	147.2 E	3-C
76	Papua Guinea e Re	BIAL Bialla	5.3 S	151.1 E	3-C
77	Peruja	CAJP Cajamarca	7.0 S	78.0 W	3-C
78	Peruja	NNA Nana	12.0 S	76.8 W	3-C
79	Filipinet	DAV Davao, Mindanao	7.1 N	125.6 E	3-C
80	Filipinet	TGY Tagaytay, Luzon	14.1 N	120.9 E	3-C
81	Rumania	MLR Muntele Rosu	45.5 N	25.9 E	3-C
82	Federata Ruse	KIRV Kirov	58.6 N	49.4 E	3-C
83	Federata Ruse	KIVO Kislovodsk	44.0 N	42.7 E	vektor i
84	Federata Ruse	OBN Obninsk	55.1 N	36.6 E	3-C
85	Federata Ruse	ARU Arti	56.4 N	58.6 E	3-C
86	Federata Ruse	SEY Seymchan	62.9 N	152.4 E	3-C
87	Federata Ruse	TLY Talaya	51.7 N	103.6 E	3-C
88	Federata Ruse	YAK Yakutsk	62.0 N	129.7 E	3-C
89	Federata Ruse	URG Urgal	51.1 N	132.3 E	3-C
90	Federata Ruse	BIL Bilibino	68.0 N	166.4 E	3-C
91	Federata Ruse	TIXI Tiksi	71.6 N	128.9 E	3-C
92	Federata Ruse	YSS Yuzhno-Sakhalinsk	47.0 N	142.8 E	3-C
93	Federata Ruse	MA2 Magadan	59.6 N	150.8 E	3-C
94	Federata Ruse	ZIL Zilim	53.9 N	57.0 E	3-C
95	Samoa	AFI Afiamalu	13.9 S	171.8 W	3-C
96	Arabia Saudite	RAYN Ar Rayn	23.6 N	45.6 E	3-C
97	Senegali	MBO Mbour	14.4 N	17.0 W	3-C
98	Ishujt Solomon	HNR Honiara, Guadalcanal	9.4 S	160.0 E	3-C
99	Afrika e Jugut	SUR Sutherland	32.4 S	20.8 E	3-C
100	Sri Lanka	COC Colombo	6.9 N	79.9 E	3-C
101	Suedia	HPS Hagfors	60.1 N	13.7 E	vektor i
102	Svicera	DAVOS	46.8 N	9.8 E	3-C

		Davos			
103	Uganda	MBRU Mbarara	0.4 S	30.4 E	3-C
104	Britania e Madhe	EKA Eskdalemuir	55.3 N	3.2 W	vektor i
105	SH. B. A.	GUMO Guam, Ishujt Mariane	13.6 N	144.9 E	3-C
106	SH. B. A.	PMSA Stacioni Palmer, Antartica	64.8 S	64.1 W	3-C
107	SH. B. A.	TKL Tuckaleechee Caverns, TN	35.7 N	83.8 W	3-C
108	SH. B. A.	PFCA Pinon Flat, CA	33.6 N	116.5 W	3-C
109	SH. B. A.	YBH Yreka, CA	41.7 N	122.7 W	3-C
110	SH. B. A.	KDC Ishulli Kodiak, AK	57.8 N	152.5 W	3-C
111	SH. B. A.	ALQ Albuquerque, NM	35.0 N	106.5 W	3-C
112	SH. B. A.	ATTU Ishulli Attu, AK	52.8 N	172.7 E	3-C
113	SH. B. A.	ELK Elko, NV	40.7 N	115.2 W	3-C
114	SH. B. A.	SPA Poli Jugor, Antartica	90.0 S	- -	3-C
115	SH. B. A.	NEW Newport, WA	48.3 N	117.1 W	3-C
116	SH. B. A.	SJG San Juan, PR	18.1 N	66.2 W	3-C
117	Venezuela	SDV Santo Domingo	8.9 N	70.6 W	3-C
118	Venezuela	PCR Puerto la Cruz	10.2 N	64.6 W	3-C
119	Zambia	LSZ Lusaka	15.3 S	28.2 E	3-C
120	Zimbabve	BUL Bulawayo	Per t'u keshilluar		3-C

Tabela: Lista e stacioneve per radioberthamat 2-A

	Shteti pergjegjes per stacionin	Vendndodhja	Gjeresia gjeografik	Gjatesia gjeografik
1	Argjentina	Buenos Aires	34.0 S	58.0 W
2	Argjentina	Salta	24.0 S	65.0 W
3	Argjentina	Bariloche	41.1 S	71.3 W
4	Australia	Melburn, VIC	37.5 S	144.6 E
5	Australia	Mawson, Antartica	67.6 S	62.5 E
6	Australia	Townsville, QLD	19.2 S	146.8 E
7	Australia	Ishulli Macquarie	54.0 S	159.0 E
8	Australia	Ishujt Kokos	12.0 S	97.0 E
9	Australia	Darwin, NT	12.4 S	130.7 E
10	Australia	Perth, WA	31.9 S	116.0 E
11	Brazili	Rio de Zhaneiro	22.5 S	43.1 W

12	Brazili	Recife	8.0 S	35.0 W
13	Kameruni	Douala	4.2 N	9.9 E
14	Kanadaja	Vankuver, B.C.	49.3 N	123.2 W
15	Kanadaja	Resolute, N.W.T.	74.7 N	94.9 W
16	Kanadaja	Yellowknife, N.W.T.	62.5 N	114.5 W
17	Kanadaja	Station John's, N.L.	47.0 N	53.0 W
18	Kili	Punta Arenas	53.1 S	70.6 W
19	Kili	Hanga Roa , Ishulli lindor	27.1 S	108.4 W
20	Kina	Beijing	39.8 N	116.2 E
21	Kina	Lanzhou	35.8 N	103.3 E
22	Kina	Guangzhou	23.0 N	113.3 E
23	Ishujt Kuk	Rarotonga	21.2 S	159.8 W
24	Ekuadori	Isla San Kristobal, Ishujt Galapagos	1.0 S	89.2 W
25	Etiopia	Filtu	5.5 N	42.7 E
26	Fixhi	Nadi	18.0 S	177.5 E
27	Franca	Papeete, Tahiti	17.0 S	150.0 W
28	Franca	Pointe-a-Pitre, Guadeloupe	17.0 N	62.0 W
29	Franca	Reunion	21.1 S	55.6 E
30	Franca	Port-aux-Francais, Kerguelen	49.0 S	70.0 E
31	Franca	Cayenne, Guajana Franceze	5.0 N	52.0 W
32	Franca	Dumont d'Urville, Antarctica	66.0 S	140.0 E
33	Gjermania	Schauinsland/ Freiburg	47.9 N	7.9 E
34	Islanda	Rekjavik	64.6 N	21.9 W
35	Per t'u caktuar	Per t'u caktuar	Per t'u caktuar	Per t'u caktuar
36	Irani (Rep. Islamike e)	Tehran	35.0 N	52.0 E
37	Japonia	Okinawa	26.5 N	127.9 E
38	Japonia	Takasaki, Gunma	36.3 N	139.0 E
39	Kiribati	Kiritimati	2.0 N	157.0 W
40	Kuvaiti	Kuvait City	29.0 N	48.0 E
41	Libia	Misratah	32.5 N	15.0 E
42	Malajzia	Kuala Lumpur	2.6 N	101.5 E
43	Mauritania	Nouakchott	18.0 N	17.0 W
44	Meksiko	Baja Kalifornia	28.0 N	113.0 W
45	Mongolia	Ulaanbaatar	47.5 N	107.0 E
46	Zelanda e Re	Ishulli Chatham	44.0 S	176.5 W
47	Zelanda e Re	Kaitaia	35.1 S	173.3 E
48	Nigeria	Bilma	18.0 N	13.0 E
49	Norvegjia	Spitsbergen	78.2 N	16.4 E
50	Panamaja	Panama City	8.9 N	79.6 W
51	Papua Guinea e Re	New Hanover	3.0 S	150.0 E
52	Filipinet	Quezon City	14.5 N	121.0 E
53	Portugalia	Ponta Delgada, Sao Miguel, Azores	37.4 N	25.4 W
54	Federata Ruse	Kirvov	58.6 N	49.4 E
55	Federata Ruse	Norilsk	69.0 N	88.0 E
56	Federata Ruse	Peleduy	59.6 N	112.6 E
57	Federata Ruse	Bilibino	68.0 N	166.4 E
58	Federata Ruse	Ussuriysk	43.7 N	131.9 E
59	Federata Ruse	Zalesovo	53.9 N	84.8 E
60	Federata Ruse	Petropavlovsk- Kamcatka	53.1 N	158.8 E
61	Federata Ruse	Dubna	56.7 N	37.3 E
62	Afrika e Jugut	Ishulli Marion	46.5 S	37.0 E
63	Suedia	Stokholm	59.4 N	18.0 E

64	Tanzania	Dar es Salam	6.0 S	39.0 E
65	Tailanda	Bangkok	13.8 N	100.5 E
66	Britania e Madhe	BIOT/ Arkipelagu Chagos	7.0 S	72.0 E
67	Britania e Madhe	St. Helena	16.0 S	6.0 W
68	Britania e Madhe	Tristan da Cunha	37.0 S	12.3 W
69	Britania e Madhe	Halley, Antarctica	76.0 S	28.0 W
70	SH.B.A.	Sacramento, CA	38.7 N	121.4 W
71	SH.B.A.	Sand Point, AK	55.0 N	160.0 W
72	SH.B.A.	Melbourne, FL	28.3 N	80.6 W
73	SH.B.A.	Palmer Station, Antarctica	64.5 S	64.0 W
74	SH.B.A.	Ashland, KS	37.2 N	99.8 W
75	SH.B.A.	Charlottesville, VA	38.0 N	78.0 W
76	SH.B.A.	Salchaket, AK	64.4 N	147.1 W
77	SH.B.A.	Ishulli Wake	19.3 N	166.6 E
78	SH.B.A.	Ishujt Midway	28.0 N	177.0 W
79	SH.B.A.	Oahu, HI	21.5 N	158.0 W
80	SH.B.A.	Upi, Guam	13.7 N	144.9 E

Tabela: Lista e laboreve per radioberthamat 2-B

Shteti pergjegjes per laboratorin	Emri dhe vendi i laboratorit
Argjentina	Keshilli kombetar i Rregullit Berthamor Buenos Aires
Australia	Laboratori Australian i Rrezatimit
Austria	Qendra e Kerkimeve Austriake
Brazili	Instituti i mbrojtjes nga rrezatimi dhe Dosimetri Rio de Zhaneiro
Kanadaja	Shendetit Kanada Ottava, Ont
Kina	Beijing
Finlanda	Qendra per Sigurine e rrezatimit dhe Berthamore Helsinki
Franca	Komisioni i Energjise Atomike Montlhéry
Izraeli	Qendra Soreq per Kerkimet Berthamore Yavne
Italia	Laboratori i Agjensise Kombetare per Mbrojtjen e Mjedisit, Rome
Japonia	Instituti Japonez i Kerkimeve per Energjin Atomike Tokai, Ibaraki
Zelanda e Re	Laboratori Nacional per Rrezatimin Christchurch
Federata Ruse	Laboratori Qendror i Kontrollit te Rrezatimit, Sherbimi i Posacem per Verifikimin i Ministrise se Mbrojtjes, Moske
Afrika e Jugut	Korporata e Energjise Berthamore Pelindaba
Britania e Madhe	AWE Blacknest Kilton
SH.B.A.	Labororet Qendrore McKlellan Sacramento, CA

Tabela: Lista e stacioneve per hidroakustiken 3

Shteti pergjegjes per stacionin	Vendndodhja	Gjeresia gjeografike	Gjatesia Gjeografike	Tipi
Australia	Kepi Lecuwin, WA	34.4 S	115.1 E	Hidrofon
Kanadaja	Ishujt e Mbretereshes Sharlot, B.C.	53.3 N	132.5 W	Faza-T
Kili	Ishulli Juan Fernandez	33.7 S	78.8 W	Hidrofon
Franca	Ishujt Krozet	46.5 S	52.2 E	Hidrofon
Franca	Guadeloupe	16.3 N	61.1 W	Faza-T
Meksika	Ishulli Klarion	18.2 N	114.6 W	Faza-T
Portugalia	Flores	39.3 N	31.3 W	Faza-T
Britania e Madhe	BIOT/Arqipelagu Kagos	7.3 S	72.4 E	Hidrofon
Britania e Madhe	Tristan da Cunha	37.2 S	12.5 W	Faza-T
SH.B.A.	Ascension	8.0 S	14.4 W	Hidrofon
SH.B.A.	Ishulli Wake	19.3 N	166.6 W	Hidrofon

Tabela: Lista e stacioneve per infratingujt 4

Shteti pergjegjes per stacionin	Vendndodhja	Gjeresia gjeografike	Gjatesia gjeografike
Argjentina	Paso Flores	40.7 S	70.6 W
Argjentina	Ushuaia	55.0 S	68.0 W
Australia	Baza Davis, Antarktide	68.4 S	77.6 E
Australia	Narrogin, WA	32.9 S	117.2 E
Australia	Hobart, TAS	42.1 S	147.2 E
Australia	Ishujt Kokos	12.3 S	97.0 E
Australia	Warramunga, NT	19.9 S	134.3 E
Bolivia	La Paz	16.3 S	68.1 W
Brazili	Brazilia	15.6 S	48.0 W
Kanadaja	Lac du Bonnet, Man.	52.0 N	95.9 W
Kepi i Gjëlber	Ishujt e Kepit te Gjëlber	16.0 N	24.0 W
Republika e Afrikes Qendrore	Bangui	5.2 N	18.4 E
Kili	Ishulli Lindor	27.0 S	109.2 W
Kili	Ishulli Juan Fernandez	33.8 S	80.7 W
Kina	Beijing	40.0 N	116.0 E
Kina	Kunming	25.0 N	102.8 E
Bregu i Fildishte	Dimbokro	6.7 N	4.9 W
Danimarka	Dundas, Greenland	76.5 N	68.7 W
Xhibuti	Xhibuti	11.3 N	43.5 E
Ekuadori	Ishujt Galapagos	0.0 N	91.7 W
Franca	Ishujt Marquesas	10.0 N	140.0 W
Franca	Port LaGuerre, Kaledonia e Re	22.1 S	166.3 E
Franca	Kerguelen	49.2 S	69.1 E
Franca	Tahiti	17.6 S	149.6 W
Franca	Kourou, Guajana Franceze	5.2 N	52.7 W
Gjermania	Freyung	48.9 N	13.7 E
Gjermania	Georg von Neumayer, Antarctica	70.6 S	8.4 W
Per t'u caktuar	Per t'u caktuar	Per t'u caktuar	Per t'u caktuar
Irani (Rep. Islamike e)	Tehran	35.7 N	51.4 E
Japonia	Tsukuba	36.0 N	140.1 E
Kazakistani	Aktyubinsk	50.4 N	58.0 E

Kenia	Kilimanbogo	1.3 S	36.8 E
Madagaskari	Antananarivo	18.8 S	47.5 E
Mongolia	Javhlant	48.0 N	106.8 E
Namibia	Tsumeb	19.1 S	17.4 E
Zelanda e Re	Ishuli Chatham	44.0 S	176.5 W
Norvegjia	Karasjok	69.5 N	25.5 E
Pakistani	Rahimyar Khan	28.2 N	70.3 E
Palau	Palau	7.5 N	134.5 E
Papua Guinea e Re	Rabaul	4.1 S	152.1 E
Paraguai	Villa Florida	26.3 S	57.3 W
Portugalia	Azoret	37.8 N	25.5 W
Federata Ruse	Dubna	56.7 N	37.3 E
Federata Ruse	Petropavlovsk- Kamchatskiy	53.1 N	158.8 E
Federata Ruse	Ussuriysk	43.7 N	131.9 E
Federata Ruse	Zalesovo	53.9 N	84.8 E
Afrika e Jugut	Boshof	28.6 S	25.4 E
Tunizia	Thala	35.6 N	8.7 E
Britania e Madhe	Tristan da Cunha	37.0 S	12.3 W
Britania e Madhe	Ascension	8.0 S	14.3 W
Britania e Madhe	Bermuda	32.0 N	64.5 W
Britania e Madhe	BIOT/ Arkipelagu Chagos	5.0 S	72.0 E
SH.B.A.	Eielson, AK	64.8 N	146.9 W
SH.B.A.	Stacioni Siple, Antarktide	75.5 S	83.6 W
SH.B.A.	Windless Bight, Antarktide	77.5 S	161.8 E
SH.B.A.	Newport, WA	48.3 N	117.1 W
SH.B.A.	Pinon Flat, CA	33.6 N	116.5 W
SH.B.A.	Ishujt Midway	28.1 N	177.2 W
SH.B.A.	Hawaii, HI	19.6 N	155.3 W
SH.B.A.	Ishulli Wake	19.3 N	166.6 W

SHTOJCA 2 E PROTOKOLLIT

Lista e parametrave karakterizues për filtrimin e ngjarjeve standarde në Qendrën Ndërkombëtare të të Dhënave

1. Kriteret e filtrimit të ngjarjeve standarde të Qendres Nderkombetare të të Dhenave do të bazohen në parametrat karakterizues të ngjarjeve standarde të percaktuara gjatë perpunimit të kombinuar të të dhenave nga të gjitha teknologjitë monitoruese në Sistemin Nderkombetar të Monitorimit. Filtrimi i ngjarjeve standarde do të perdore si kriteret e filtrimit në shkallë boterore, ashtu edhe kritere shtese për të marre në konsiderate ndryshimet rajonale, nese eshte e mundur.

2. Për ngjarjet e detektuara nga komponenti sizmik i Sistemit Nderkombetar Monitorues, mund të perdoren parametrat e mëposhtem, ndër të tjera:

- lokalizimi i ngjarjes,
- thellesia e ngjarjes,
- raporti i madhësisë së vëllimit të sipërfaqes ndaj vëllimit trupor,
- përmbajtja e frekuencës së sinjalit,
- raportet spektrale të fazave,
- shkallëzimi spektral,
- lëvizja e parë e vales-P,
- mekanizmi në vater,
- ngacimi relativ i fazave sizmike,
- masat krahasuese për rastet e tjera dhe grupet e rasteve,
- diferencuesit rajonale, aty ku aplikohen.

3. Për ngjarjet e detektuara nga komponenti hidroakustik i Sistemit Nderkombetar Monitorues, mund të perdoren parametrat e mëposhtem, ndër të tjera:

- përmbajtjen e frekuencës së sinjalit duke përfshirë frekuencën skajore, energjinë në brez të gjërë dhe frekuencën mesatare qendrore dhe gjërësisë së brezit;
- kohezgjatjen e frekuencës relative të sinjaleve;
- raportin spektral; dhe
- treguesit e sinjaleve sferë-pulsant dhe të vonesës sferë-pulsant.

4. Për ngjarjet e detektuara nga komponenti infratingull i Sistemit Nderkombetar Monitorues, mund të perdoren parametrat e mëposhtem, ndër të tjera:

- përmbajtja dhe përhapja e frekuencës së sinjalit;
- kohezgjatja e sinjalit;
- vlera maksimale e amplitudës.

5. Për ngjarjet e detektuara nga komponenti i radioberthamave të Sistemit Nderkombetar Monitorues, mund të perdoren ndër të tjera parametrat e mëposhtem:

- përqendrimi i radioberthamave me origjinë natyrore dhe artificiale në zhurmën e fonit;
- përqendrimi i produkteve specifike të ndarjes dhe aktivimit jashtë vërojtimeve normale;
- raporti i një produkti specifik të ndarjes dhe aktivimi me një produkt tjetër.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 22.3.2003

Doli nga shtypi më 23.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 200 lekë